



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në  
“Teknologji Informacioni në Biznes”**

**ofruar nga**

**Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “Instituti  
Kanadez i Teknologjisë”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

1. Dr. Gelina Maliqi

2. Dr. Adisa Daberdini

Two handwritten signatures in blue ink. The first signature is above the name Dr. Gelina Maliqi, and the second is above the name Dr. Adisa Daberdini.

Janar 2024

## **RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Për programin e studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni në Biznes”  
ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i  
Teknologjisë”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni në Biznes”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr.359, datë 17.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli II
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	11 PAE / 0 PAK (Viti Akademik 2022-2023) 9 PAE / 2 PAK (Viti Akademik 2021-2022)
18	Numri i studentëve:	V.A. 2021-2022, 10 (dhjetë) studentë V.A. 2022-2023, 10 (dhjetë) studentë
19	Komente / të tjera:	

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni në Biznes” që ofrohet nga Institucioni Privat i Arsimit të Lartë: Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, është licensuar me UMASR Nr.359 Prot, datë 19.09.2021 (ofrohet në gjuhën angleze), si program i studimeve universitare të Ciklit të Dytë në fushën “Teknologji Informacioni në Biznes”.

Veprimtaria akademike e këtij programi studimi filloi në vitin akademik 2021-2022 me 10 studentë të regjistruar në vit të parë, duke vijuar me 10 studentë të regjistruar në vitin akademik 2022-2023 në vit të parë, pra totali i studentëve të regjistruar aktualisht është 20 studentë.

Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Administrim Biznesi dhe Teknologji Inormacioni, njësi bazë në Fakultetin e Ekonomisë. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është licensuar me VKM Nr.781, datë 10.11.2011. Riorganizimi i Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është bërë me UMASR Nr. 536 Prot, datë 24.11.2016. Akreditimi Institucional i parë u bë me VBA Nr.116, datë 15.12.2017 me kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite deri më 14.12.2022; ndërsa Akreditimi Institucional i fundit u bë me VBA Nr.06, datë 27.01.2023 me kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite deri më 26.01.2028. Aktualisht Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” përbëhet nga 2 (dy) fakultete, 4 (katër) departamente dhe 2 (dy) njësi të kërkimit shkencot. Fakulteti i Ekonomisë përbëhet nga 2 (dy) departamente dhe 1 (një) njësi të kërkimit shkencor “CIRD Ekonomi”.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknologji Inormacioni në Biznes” është program studimi i ciklit të dytë, i përket nivelit 7 (shtatë) të kualifikimit sipas KSHK. Ky program studimi realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike që përmajnë 4 (katër) semestra, në përfundim të të cilit studentët fitojnë diplomë “Master i Shkencave në Teknologji Informacioni në Biznes”.

Ky program studimi u hap bazuar në Studimin e Tregut (Feasibility Study) realizuar në tetor 2020 nga vetë IAL, si dhe është konceptuar për të përgatitur studentët profesionalisht të integrohen në tregun e punës por edhe për tu dhënë atyre mundësinë në zhvillimin e karrierës akademike duke vazhduar studimet e doktoratës.

Ky program studimi ka për qëllim të formojë ekspertë në fushën e teknologjisë së informacionit në biznes duke ndërthurrur zbatimin e informatikës në ekonomi. Programi i aftëson studentët për një karrierë të suksesshme në tregun e punës si zhvillues të bazave të të dhënave, analistë të sistemeve të informacionit, zhvillues softuerësh, konsulentë IT, analistë biznesi, e deri themelues e drejtues të kompanive të tyre në këto fusha. Ky program studimi i zhvillon lëndët nëpërmjet zbatimeve praktike të njohurive akademike duke u fokusuar në formimin e të menduarit kritik, në aftësimin për të menduar dhe vepruar njëkohësisht, si dhe për të gjykuar situata specifike duke marrë vendimet e duhura profesionale.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Pocesi i vlerësimit të jashtëm i programit të studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni në Biznes” ka ndjekur hapat të cilat janë në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe bazës ligjore për veprimin e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).

Procesi filloi me kontaktimin e ekspertëve, të cilët u trainuan për standardet e cilësisë dhe kriteret, si dhe mbi përdorimin e sistemit elektronik në seksionin “Paneli i Ekspertit”. Gjatë fazës së parë u vendos një komunikim i mirë i grupit të punës i përbërë nga ekspertët dhe koordinatori teknik i ASCAL. Pas njohjes dhe vlerësimit të dosjes së vetëvlerësimit dorëzuar nga IAL, u hartua axhenda e vizitës në institucion.

Në fazën e dytë u zbatua axhenda 1 (një) ditore e vizitës në institucion në datën 23 qershor 2023. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mblodhi informacionet e nevojshme për një vlerësim rigoroz bazuar në takimet e zhvilluara sipas parashikimit në axhendën e vizitës. Të gjitha informacionet e mbledhura nga takimet u përdorën nga GVJ i përbërë nga Dr. Gelina Maliqi dhe Dr. Adisa Daberdini për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm. Gjatë të gjithë procesit, ky grup pune u asistua edhe nga koordinatori teknik i ASCAL Z. Erjon Xhako.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm është përgatitur pas shqyrtimit të hollësishëm të dokumentave të GVB të vëna në dispozicion në sistemin e ASCAL, si dhe bazuar në vizitën pranë Departamentit Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, Fakultetit i Ekonomisë në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.

Grupi është bazuar në kërkesat e ligjit mi Arsimin e Lartë, Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e jashtëm. Për hartimin e raportit grupi ka vepruar me detyra dhe përgjegjësi të qarta, duke vënë theksin në përmbajtjen akademike të programit, nivelin dhe performancën e personelit akademik, vlerësimin e infrastrukturës dhe mjedisit në dispozicion. Raporti i Vlerësimit të Jashtëm iu dorëzua koordinatorit teknik të ASCAL.

Më datë 13.12.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 176/12 Prot., datë 13.12.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 19.12.2023, ka dërguar përgjigje mbi draft raportin, duke u shprehur se nuk ka komente, si rrjedhojë raporti, merr formen përfundimtare, si raport i vlerësimit të jashtëm.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në  
“Teknologji Informacioni në Biznes”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni në Biznes” nuk bie ndesh me asnjë nga vlerat akademike dhe ato kulturore e kombëtare. Organizimi i tij është konform me legjislacionin shqiptar dhe përmbajtja e tij është në harmoni me interesat kombëtare. Programi i studimit ka ofruar mundësinë që studentët shqiptar të edukohen me vlera akademike sipas eksperiencës më të mirë ndërkombëtare, përmes një kurrikule të ndërtuar me kujdes dhe në përputhje me fushën e studimit. Kjo theksohet dhe shprehet qartë në misionin dhe vizionin e institucionit në Statut dhe Rregulloren Institucionale, përkatësisht neni 4 i Statutit dhe neni 7 i Rregullore Institucionale ku thuhet se Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” në misionin e vet synon në ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike “duke vlerësuar dhe respektuar diversitetin kulturor dhe vlerat e Shqipërisë”.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip, neni 4, Vizioni dhe Misioni</i>  <i>DVV-9. Rregullore Institucionale e KU IKT 2016, neni 7, Vizioni dhe Misioni.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë së tij, kjo theksohet në vizionin dhe misionin e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, të përcaktuar në nenin 4 të Statutit të këtij institucioni.</p> <p>Programi i studimit ofrohet gjithashtu në përputhje të plotë me nenet 20-25, si dhe kreun VII “Organizimi i studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë” të Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me aktet nënligjore të këtij ligji. Gjithashtu, ky program studimi plotëson profilin dhe ofertën akademike të Fakultetit të Ekonomisë dhe është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” për përgatitjen e</p>

	<p>studentëve me njohuri dhe aftësi të mbështetura në një edukim të qëndrueshëm dhe të integruar.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip, neni 4, Vizioni dhe Misioni.</i>  <i>Ligji Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", datë 22.07.2015, nenet 20-25.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës rezulton se programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të Strategjisë për Zhvillimin e Institutit Kanadez të Teknologjisë dhe Planin e Veprimit 2020-2025, ku në pikën mbi Qëllimet e Fakultetit të Ekonomisë thuhet: "Të udhëheqë programe studimi dhe kërkim shkencor në fusha si Administrim Biznesi, Administrim Biznesi dhe IT, Marketingu, Financa, Kontabiliteti, Banka etj. Kjo mund të vërehet edhe në Strategjinë e Fakultetit të publikuar në faqen e internetit.</p> <p>Programi është gjithashtu në përputhje me Statutin neni 4 dhe Rregulloren e Institucionit neni 7, si dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. Duke patur parasysh edhe qëllimet e Kolegjit Universitar "Institutit Kanadez i Teknologjisë" për t'u profilizuar në programe të ciklit të parë dhe të dytë, si dhe për të krijuar një bazë të qëndrueshme për ofrimin në të ardhmen të programeve të ciklit të tretë në fushën e Ekonomisë.</p> <p>Si një program i ciklit të dytë, ai përgatit specialistë të aftë në fushat përkatëse të cilët kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit, qoftë ky kontribut në rang specialisti ose në rang sipërmarrësi. Po kështu, si një Master i Shkencave, ky program i pajis studentët me aftësi profesionale dhe shkencore për të vazhduar me sukses studimet e ciklit të tretë në fushën e Ekonomisë.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-3.Strategjia e Zhvillimit të CIT dhe Plani i Veprimit 2020-2025", faqe 4 Qëllimi i Fakultetit të Ekonomisë.</i>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2023/04/Faculty-of-Economy-Strategy">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2023/04/Faculty-of-Economy-Strategy</a>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit (Qëllim i politikës 1 dhe Qëllim i politikës 3, Objektivi specifik 3.1, 3.6 dhe 3.7), interesin kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar dhe ofrohet në përputhje të plotë dhe mbështetje me nenet 20-25, si dhe kreun VII "Organizimi i studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë" të Ligjit Nr.80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe me aktet nënligjore të tij.</p>

	<p>Programi i studimit i përgjigjet kërkesave aktuale dhe perspektivës së tregut të punës, duke i pajisur studentët me njohuri bashkëkohore, në përputhje me zhvillimin strategjik të vendit, por edhe për të arritur sukses në tregje ndërkombëtare. Institucioni gjatë studimit të tregut, i cili ka filluar prej vitit 2014, ka marrë parasysh edhe trendet dhe kërkesat globale bazuar në raportin “The future of Jobs Report” të përgatitur nga Organizata “The World Economic Forum”.</p> <p>Masteri i Shkencave në “Teknologji Informacioni në Biznes” është dizenuar për të përgatitur studentë për një karrierë të suksesshme në punësimin e tyre si zhvillues të bazave të të dhënave, analistë të sistemeve të informacionit, zhvillues softuerësh, konsulentë për IT, analistë biznesi, etj. Përparësi është edhe përgatitja e tyre për të qenë të gatshëm që ata vetë të themelojnë kompanitë e tyre. Thelbi i programit fokusohet në formimin e të menduarit kritik tek studenti, me aftësinë për të menduar dhe vepruar njëkohësisht, si dhe për të gjykuar situata specifike, për të marrë vendime profesionale si dhe për të qenë një vlerë e shtuar për vendin dhe të ardhmen e Shqipërisë dhe më gjerë.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <a href="https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK-538-Draft-Strategjia-Kometare-per-Zhvillim-dhe-Integrim-2021--2030-.pdf">https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK-538-Draft-Strategjia-Kometare-per-Zhvillim-dhe-Integrim-2021--2030-.pdf</a> (faqe 150-151).          Ligji Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, datë 22.07.2015, nenet 20-25.          Organizata “The World Economic Forum”.</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni në Biznes” nuk bie ndesh me asnjë nga vlerat akademike dhe ato kulturore e kombëtare. Organizimi i tij është konform me legjislacionin shqiptar dhe përmbajtja e tij është në harmoni me interesat kombëtare. Është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me fushën e veprimtarisë së tij. Programi i përgjigjet kërkesave aktuale dhe perspektivës së tregut të punës, duke i pajisur studentët me njohuri bashkëkohore, në përputhje me zhvillimin strategjik të vendit, por edhe për të arritur sukses në tregje ndërkombëtare. Institucioni gjatë studimit të tregut ka marrë parasysh edhe trendet dhe kërkesat globale bazuar në raportin “The future of Jobs Report” të përgatitur nga Organizata “The World Economic Forum”. Ky program është dizenuar për të përgatitur studentë për një karrierë të suksesshme në punësimin e tyre si zhvillues të bazave të të dhënave, analistë të sistemeve të informacionit, zhvillues softuerësh, konsulentë për IT, analistë biznesi, etj.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi I.2**

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit është krijuar që në fillim së bashku me licensimin e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” me Vendim Nr.781, datë 19.11.2011. Në vitin akademik 2021-2022 ky departament përbëhej nga 9 personel akademik efektiv (PAE) dhe 2 personel akademik me kontratë (PAK). Në vitin akademik 2022-2023 ky departament përbëhet nga 11 personel akademik efektiv (PAE) dhe 0 personel akademik me kontratë (PAK). I gjithë personeli akademik është me tituj dhe grada shkencore. Referuar CV të ngarkuar në sistem konstatohet që personeli akademik është me përvojë në mësimdhënie dhe ekspertiza e tyre bazë është në përputhje me fushën specifike të programit për pjesën e ekonomisë dhe e plotësuar me kualifikime postuniversitare për pjesën e teknologjisë së informacionit.</p> <p>Personeli akademik i përfshirë në programin e studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni në Biznes” është me nivel kualifikimi më të lartë se ai i ciklit të studimit.</p> <p>Nga shqyrtimi i CV të stafit akademik rezultoi se stafi akademik ushtron aktivitetin e mësimdhënës brenda fushës së kualifikimit të tij akademik. Raporti i personelit akademik efektiv me atë të personelit akademik me kontratë është 9/2 për vitin akademik 2021-2022 dhe 11 PAE për vitin akademik 2022-2023.</p> <p>Për realizimin e planit mësimor, Departamenti Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni shfrytëzon auditorët e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” të cilët janë me kapacitet të bollshëm për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, si dhe nga sa i vizituar ambientet e institucionit rezultoi se ka në dispozicion 5 laboratorë, 1 zyrë IT, ku 1 laborator përdoret edhe si server, me kapacitet të mjaftueshëm për këtë program studimi.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>Tabelat përmbledhëse RVB.</i>  <i>DVV-22 “CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit – MSc në Teknologji Informacioni në Biznes.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni. Ky fakultet përmban fushat e studimit Ekonomi (Bsc në Administrim Biznesi, Bsc në Financë-Kontabilitet, MSc në Administrim Biznesi, MSc në Kontabilitet dhe Auditim, MSc në Financë-Bankë, si pjesë e Departamentit Administrim Biznesi) dhe Teknologji Informacioni (Bsc në Administrim</p>



<p>klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Biznesi dhe IT dhe MSc në Teknologji Inormacioni në Biznes, si pjesë e Departamentit Adiministrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni). Shohim se emërtimi i departamentit të këtij programi studimi ka përmbledhur të gjithë fushat e përgjithshme të studimit në të cilat ofrohen programet specifike të studimit.</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore që është Fakulteti i Ekonomisë, i cili është përgjegjës për programin e studimit, sipas klasifikimit / kodifikimit të programeve të studimit sipas VKM 310, datë 11.05.2022, “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe ka kodin: 72MS04I9A kjo edhe sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit përfshihet në mënyrë të plotë në njësinë bazë që është Departamenti Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, pjesë e njësisë kryesore të Fakultetit të Ekonomisë, të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”. Programi është licensuar në vitin 2021, me Urdhër Nr.359 të Ministrit të Arsimit, datë 17/09/2021 si kurrikul e ofruar prej Departamentit Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni.</p> <p><b>Evidenca:</b> <i>DVV-1.4 Urdher nr 359 Hapje e programit Master ne Teknologji Informacioni ne Biznes.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.</p>	<p>N / A: Ky institucion nuk ofron program “Master Profesional”.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” në përgjithësi dhe Fakulteti i Ekonomisë në veçanti organizojnë tryeza të përvitshme dhe sesione përkatëse me bizneset në konferencat e përvitshme me qëllim përshatjen e programit me tregun e punës dhe ofrimin e certifikimeve profesionale sa herë që është e nevojshme. Gjithashtu, institucioni ofron trajnime profesionale të mtejshme për studentët dhe stafin e tij si atë akademik ashtu edhe atë administrativ. Trajnimet janë ofruar në forma të ndryshme tradicionale dhe jo vetëm, si workshop-e, tryeza të rumbullakëta, etj.</p>
	<p>Prej trajnimeve kryesore mund të përmenden:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- “Introduction into Machine Learni ng Engineering and MLOps”.</li> <li>- “Web development Master Class”</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• “Database Master Class”</li> <li>• “Devops Culture”</li> <li>• “Financa 5”</li> <li>• “Si të pergatisësh një CV”</li> <li>• Etj.</li> </ul> <p>Gjithashtu, institucioni ka nënshkruar një numër marrëveshjesh të konsiderueshme përmes të cilave u garanton studentëve përveç praktikave mësimore edhe trajnime të mbajtura në bashkëpunim me biznesin, leksione të hapura më përfaqësues të biznesit, sipërmarrës, qeverisjes apo politikëbërës të ndryshëm.</p> <p><b>Evidenca:</b>  Tabelat përmbledhëse RVB  <a href="https://cit.edu.al/moments-from-introduction-into-machine-learning-engineering-mlops-workshop/">https://cit.edu.al/moments-from-introduction-into-machine-learning-engineering-mlops-workshop/</a>  <a href="https://cit.edu.al/web-development-master-class-first-session/">https://cit.edu.al/web-development-master-class-first-session/</a>  <a href="https://cit.edu.al/database-master/">https://cit.edu.al/database-master/</a> ]  <a href="https://cit.edu.al/professional-training-cloud-computing-and-devops-training-competitive-advantage-and-faster-time-to-market/">https://cit.edu.al/professional-training-cloud-computing-and-devops-training-competitive-advantage-and-faster-time-to-market/</a>  <a href="http://cit.visualminds.be/nes/training-courses-financa5-alpha-business/">http://cit.visualminds.be/nes/training-courses-financa5-alpha-business/</a></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstanton se në Departamentin Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, numri i personelit akademik efektiv me ekspertizë të afërt me atë të fushës akademike të programit të studimit, referuar stafit të deklaruar për të dy vitet akademike 2021-2022 dhe 2022-2023 është i plotësuar përgjithësisht, por pedagogët është më mirë të jenë me arsimin univesitar bazë sipas fushes së lëndëve që lektrojnë. Rekomandohet që Diploma bazë (Diploma Universitare) e stafit akademik të jetë e lidhur drejtpërdrejt me lëndët që i ka ngarkesë mësimore, sepse edhe njohuritë më të thelluara të fushës përkatëse merren gjatë studimeve universitare, ndërsa në studimet e niveleve më të larta plotësohen këto njohuri me zhvillimet më të fundit.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se Departamenti Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni i ka plotësisht burimet e nevojshme për realizimin e këtij programi studimi. Nga verifikimi i të dhënave, konkludojmë se programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe asaj bazë.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” në përgjithësi dhe Fakulteti i Ekonomisë – Departamenti Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni në veçanti, ofrojnë për studentët në përgjithësi duke përfshirë edhe studentët e diplomuar, trajnime të ndryshme profesionale në formën e tryezave të përvitshme, sesioneve përkatëse dhe workshop-eve me bizneset dhe partnerë të</i></p>

	<i>ndryshëm, si dhe u akordojnë atyre çmime dhe certifikime profesionale sa herë që është e nevojshme. Zyra e Karrierës ka krijuar një database me studentët ALUMNI të studimeve BSc (janë rreth 600 studentë), me të cilët mbajnë komunikime të shpeshta dhe organizojnë aktivitete të ndryshme sociale e profesionale, ndërmjet të tjerave edhe trajnime të formave të ndryshme.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Bazuar në dokumentacionet themelore të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”: Statuti, Rregullorja Institucionale, Libri i Rregulloreve Institucionale, Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë, Rregullorja e Departamentit Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, Manuali i Stafit Akademik, në mbështetje të këtij programi studimi por edhe për mbarëvajtjen e marrëdhënieve brenda institucionit, pasqyrohen qartë: organet dhe struktura drejtuese e menaxhuese institucionale; struktura drejtuese dhe ato mbështetëse në njësinë kryesore; struktura bashkëpunuese që bën ndarjen e detyrave e përgjegjësisve dhe menaxhon njësinë bazë; organet kolegjiale dhe ato vendimmarrëse në rang institucioni; si dhe këshillat dhe komisionet.</p> <p>Në mbështetje të mirëfunksionimit dhe mbarëvajtjes të këtij programi studimi që kryehet më së shumti nga Departamenti Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, është hartuar dhe zbatohet Manuali i Stafit Akademik ku shpjegohen dhe përcaktohen qartë detyrat dhe të drejtat e stafit. Raportimi për përmbushjen e detyrave bëhet në mënyrë periodike, ku mbi bazën e tyre bëhet analiza e departamentit për përmbushjen e objektivave formuese për këtë program studimi, si dhe mbi përfitimet e departamentit nga marrëveshjet e bashkëpunimit me kompani të ndryshme në tregun e punës.</p> <p><b>Evidencë:</b>  <i>DVV-1. Statuti i KU IKT 2016, Pjesa e Dytë, Neni 8.</i>  <i>DVV-11. Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, Pjesa III, nenet 5 – 20.</i>  <i>DVV-17. Manuali i Stafit Akademik</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni	Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” ka krijuar bashkëpunime dhe marrëdhënie institucionale me universitete homologe, kompani, sipërmarrje, banka, organizata kombëtare dhe

<p>vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>ndërkombëtare, me qëllim që t'u ofrojë studentëve dhe stafit mundësitë më të mira për zhvillimin e tyre.</p> <p>Në nivel institucional Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" ka lidhur 61 marrëveshje bashkëpunimi kombëtare dhe ndërkombëtare, në rang programesh studimi për praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës, si dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë. Gjithashtu, këto marrëveshje bashkëpunimi fokusohen në projekte të përbashkëta ndërkombëtare, ngritje kapacitetesh laboratorikë, realizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare në mbështetje të studentëve, njohjen e ndërsjelltë të programeve mësimore dhe krediteve, si dhe realizimin e konferencave të përbashkëta shkencore si për stafin akademik ashtu edhe për studentët.</p> <p>Gjithashtu, institucioni ka lidhur edhe marrëveshje bashkëpunimi, në mbështetje të procesit mësimor, në kuadër të programeve ERASMUS+ (16 marrëveshje) dhe programit CEMPUS (7 marrëveshje).</p> <p><b>Evidenca:</b> <i>Tabelat përmbledhëse RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë ka nënshkruar 22 marrëveshje bashkëpunimi me institucione kërkimore, sipërmarrje, kompani të fushës për realizimin e praktikave mësimore. Referuar marrëveshjeve, studentëve u ofrohet mundësia që të zhvillojnë praktikat mësimore pranë këtyre institucioneve përgjatë periudhës së përcaktuar në programin e studimit. Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" ka përcaktuar rregulla mbi organizimin, kontrollin dhe raportimin në lidhje me realizimin e praktikave mësimore. Fakulteti i Ekonomisë, bazuar në planin mësimor, i cili saktëson kohën e zhvillimit të praktikës mësimore, ngarkesën dhe kreditet që duhet të fitojë studenti, ndjek zbatimin e tij prej njësisë CIRD, e cila është përgjegjëse për organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e praktikës mësimore, në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Shërbimit ndaj Studentëve. Për mbarëvajtjen e procesit kontribuojnë edhe njësitë e tjera bazë të Fakultetit. Në përfundim të praktikës mësimore, studentët dorëzojnë një vlerësim nga institucioni ku realizuan praktikën dhe më pas kjo praktikë vlerësohet me notë nga një komision i posaçëm i fakultetit. Gjithashtu, nga ana tjetër praktika mësimore vlerësohet edhe nga vetë studentët me anë të një pyetësoi, nëpërmjet të cilit merret një feedback për efektshmërinë e realizimit të tyre dhe se si mund të punohet për përmirësimin e praktikave në rastet kur është e nevojshme.</p> <p>Për të siguruar zhvillimin e rregullt dhe cilësor të praktikave</p>

	<p>profesionale institucioni ka krijuar Zyrën e Shërbimit të Studentëve dhe Karrierës (Students Affair &amp; Career Office), e cila ka si qëllim parapërgatitjen e studentëve për procesin e praktikave profesionale dhe dhënien e informacionit dhe asistencës së nevojshme studentëve për gjetjen e mundësive për kryerjen e praktikave profesionale / stazheve / internshipeve të ofruara nga institucione partnere e më gjerë. Krahas rolit të kësaj zyre, studentëve u caktohet një pedagog mbikëqyrës, i cili ndjek zhvillimin korrekt të praktikës mësimore në institucionin pritës.</p> <p>Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” synon përfshirjen në sa më shumë projekte zhvilluese akademike e shkencore në kuadrin e projekteve europiane të arsimit të lartë që targetojë zhvillimin e stafit akademik, mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve, aplikimin e standardeve europiane të cilësisë, organizimin e konferencave shkencore të përbashketa ndërkombëtare, pajisjen e mjediseve mësimore dhe laboratorëve, etj.</p> <p>Gjithashtu, Zyra e Shërbimit të Studentëve dhe Karrierës në bashkëpunim me Zyrën e Kërkimit Shkencor mbështesin Fakultetin e Ekonomisë në zhvillimin e projekteve ndërkombëtare, në krijimin e partneriteteve strategjike dhe lehtësimin e aplikimit për grante kërkimore. Sipas marrëveshjeve të lidhura është bërë e mundur shkëmbimi i stafit dhe i studentëve në universitetet homologe nëpërmjet programeve ERASMUS+ dhe CEMPUS. Studentët me punimet e tyre më të mira përfshihen në konferenca ndërkombëtare ndërmjet studjuesish e partnerësh të ndrrshëm, në konferenca studentore, si dhe në projekte të ndryshme shkencore.</p> <p><b>Evidenca:</b>  Tabelat përmbledhëse RVB  <a href="https://cit.edu.al/save-the-date-virtual-workshop-today-27th-of-may-2021-from-1330-to-1430/">https://cit.edu.al/save-the-date-virtual-workshop-today-27th-of-may-2021-from-1330-to-1430/</a>  <a href="https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-in-tirana-albania-paid-an-academic-visit-to-digital-headquarters/">https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-in-tirana-albania-paid-an-academic-visit-to-digital-headquarters/</a>  DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf Kreu IV Praktika Profesionale, fq.56 .</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, të gjitha të dhënat e mbledhura përpunohen prej fakulteteve, njësive bazë (në rastin konkret edhe Departamenti Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni), NjSBC dhe zyrave përkatëse si Kryesekretaria dhe koordinatorët specifike, si dhe publikohen në raportet vjetore të Fakulteteve dhe në Raportin Vjetor që institucioni përgatit për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Veçanërisht, Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamentet e tij përpunojnë të dhëna të ndryshme lidhur me marrëveshjet e nënshkruara, praktikat studentore, me konferencat e organizuara, seminarët, leksionet e hapura, mobilitetet akademike dhe</p>

	<p>studentore në kuadër të programeve ERASMUS+ dhe CEMPUS, punimet shkencore të stafit akademik dhe të studentëve etj., të cilat mbliidhen dhe përpunohen prej Qendrës CIRD Ekonomi dhe më pas përshtaten në Raportin Vjetor të Fakultetit Ekonomik.</p> <p><b>Evidencë:</b>  <i>DVV-30. Raporti Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022.</i>  <i>DVV-31. Raporti CIRD Ekonomi 2021-2022, Marrëveshjet fq. 24-35 dhe fq. 23-35.</i>  <i>Tabela përmbledhëse RVB.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se për realizimin e objektivave dhe procesit mësimor e formues të studentëve, Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen e praktikave profesionale është zyrtarizuar përmes marrëveshjeve të shkruara. Procedura e zhvillimit të praktikave profesionale është e rregulluar nëpërmjet akteve të brendshme institucionale, ku janë parashikuar edhe detyrat dhe roli i aktorëve dhe njërive të ndryshme të përfshira në këtë proces, brenda apo jashtë KU IKT.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se është në nivel të kënaqshëm numri i bashkëpunimeve me institucionet homologe që ofrojnë programe studimi në këtë fushë, duke mundësuar mobilitetin e stafit dhe të studentëve. Inkurajohen, mbështeten dhe përfshihen studentët në pjesëmarrjen e tyre në konferenca ndërkombëtare të përgjithshme dhe në konferenca studentore, si dhe përfshihen studentët në projekte të ndryshme shkencore.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>GVJ konstaton se struktura e programit të studimit është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi, dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje 2 vite dhe në total 120 kredite dhe përmban të shprehura shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj, të cilat rezultojnë të paraqitura në përputhje me akte ligjore e nënligjore.</p> <p>GVJ konstaton qe ky program eshte ofruar ne perputhje te plote me Ligjin Nr80/2015, “Per arsimin e larte dhe Kerkimin shkencor ne institucionet e Arsimit te Larte ne Republiken e Shqiperise” si dhe me aktet nenligjore.</p> <p>Nga shqyrtimi i programit mesimor, rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara në VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018, dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh. Përqindja sipas secilit tip të komponentit mesimor është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• lëndët bazë 5%;</li> <li>• lëndët karakterizuese 55%;</li> <li>• lëndët ndërdisiplinore 15%;</li> <li>• lëndët plotesuese 10%;</li> <li>• detyrimet përmbyllëse 15 %.</li> </ul> <p>Studenti që ndjek këtë program studimi duhet të marrë së paku 120 kredite. Teza e diplomës ka 18 kredite dhe praktika mesimore ka 12 kredite. Kreditet fitohen vetëm nëse studenti është vlerësuar me një notë kaluese. Programi ofrohet në gjuhën angleze dhe është në përputhje dhe harmoni me kriteret dhe proceset e kartës së Bolonjës dhe legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-9. Rregullore Institucionale e KU IKT 2016 shqip.pdf</i>  <i>DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b>Programi i studimit</p>	<p>Programi i studimit synon t'i përgatisë dhe formojë studentët me</p>

<p>synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>njohuri të thelluara akademike, kompetenca dhe njohuri të aplikuara në fushën e teknologjise se informacionit, analizimit të të dhënave në mënyrë inteligjente dhe elementëve të sistemeve të informacionit, në mënyrë që të arrijnë përmbushje profesionale në një treg kombëtar, rajonal dhe botëror. si dhe të përgatisë specialistë me kualifikim të lartë me njohuri nga fusha e programimit në objekte dhe programimit në Web, menaxhimit të bazave të të dhënave, programimit inteligjent, sigurisë kibernetike, përpunimit të informacionit në sasi të mëdha dhe gjithashtu për të gjitha aplikimet e TI ne Biznes. Ndër synimet kryesore të programit është edhe përgatitja e studentëve me aftësi teorike dhe praktike, të gatshëm për t'u përballur me kushtet e një tregu të hapur global në fushën e shkencave kompjuterike, përmes kombinimit të teorisë me praktikën. Disa nga mundesite e karrieres jane: zhvillues i bazeve të dhënave, specialist i tregut të komunikimeve elektronike, specialist i tregut të mediave elektronike,menaxher projekti, zhvillues Web-i dhe zhvillues software etj. GVJ konstaton se ky objektivi përmbushet mjaft mirë dhe kjo rezulton e shprehur qartë në rregulloren e programit dhe në syllabuset e lëndëve.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i>  <a href="https://cit.edu.sl/wp-content/uploads/2022/06/masterBIT.pdf">https://cit.edu.sl/wp-content/uploads/2022/06/masterBIT.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit ka përcaktuar ngarkesën 12 kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe 18 kredite të detyrimit përmbyllës të punimit të diplomës. Keto janë të dhëna në dokumentacionin për programin e studimit dhe tek ngarkesa e programit. Në rregulloren “Për punimin e Diplomës” përcaktohen të gjithë elementet që duhet të dijë studenti për punimin e një diplome.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i>  <i>DVV-19. Plani mesimor i programit te studimit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësimi i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave</p>	<p>Nuk aplikohet në këtë program studimi.</p>



përkatëse të formimit.	
<b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk aplikohet në këtë program studimi.
<b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	GVJ konstaton se programi i studimit ka të përcaktuar formën e organizimit, pranimin e studentëve dhe financimin në aktet rregullatore, në zbatim dhe në përputhje me aktet ligjore dhe rregullatore.  <i>Evidenca:</i> <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i> <i>DVV-1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip.pdf</i>
<b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	GVJ konstaton se programi i studimit ka një plan mësuesor të ngjashëm me programet e studimit në të njëjtën fushë mbi masën 70 %, pasi dhe hapja e këtij programi është mbështetur në eksperiencat më të sukseshme ndërkombëtare të fushës. Por Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologji Informacioni nuk ofron program studimi me të njëjtën emërtesë.  <i>Evidenca:</i> <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i> <i>DVV-1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip.pdf</i> <i>21. programet e lendeve 2021 - 2022.pdf</i>
<b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	GVJ konstanton qe programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, mbështetur në klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas VKM nr. 310, datë 11.05.2022, “Per specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe ka kodin 72MS0419A. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit që janë bërë sipas standarteve kombëtare të kodifikimit.  <i>Evidenca:</i> <i>DVV-19. Plani mesimor i programit te studimit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes.pdf</i> <i>DVV-25. Rregullorja per Kodifikimin e Lendeve.pdf</i>

<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Institucioni KU IKT, Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni nuk ofrojnë programe të përbashkëta me institucionet e tjera. Por në vitin 2020-2021 kanë nënshkruar një marrëveshje të përbashkët me <i>Georgian College, Canada</i>, për njohjen e krediteve të ndërsjellta kryesisht për programin e ciklit të parë Administrim Biznesi. Gjithashtu institucioni ka paraqitur që ka bërë përpjekje për Seneca College në Kanada.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <a href="https://cit.edu.al/georgian-college-collaboration-meeting-informative-session/">https://cit.edu.al/georgian-college-collaboration-meeting-informative-session/</a>  <a href="https://cit.edu.al/seneca-college-informative-session-and-collaboration-meeting/">https://cit.edu.al/seneca-college-informative-session-and-collaboration-meeting/</a></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se struktura e programit të studimit është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi, dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje 2 vite dhe në total 120 kredite dhe përmban të shprehura shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj, të cilat rezultojnë të paraqitura në përputhje me akte ligjore e nënligjore. GVJ konstaton që programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, mbështetur në klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas VKM nr. 310, datë 11.05.2022, "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe ka kodin 72MS0419A.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi II.2</b>  <b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>GVJ është i mendimit se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike bazuar kjo tek dokumentat e shqyrtuara të vëna në dispozicion: Rregullorja Institucionale e Kolegjit Universitar IKT, Statuti i IKT, Rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë, Rregullorja e Departamentit BA &amp; IT, Rregullorja e programit të studimit, etj.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Administrim Biznesit &amp; Teknologjisë së Informacionit përmbushin detyrimet ligjore, referuar nenit 20 dhe 23 të Ligjit për Arsimin e Lartë nr. 80/2015. Fakulteti i</p>

	<p>Ekonomisë është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura dhe ofron programe të studimeve në ciklin e parë dhe të dytë në përputhje me statusin e tij.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë (referuar nenit 4 të Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë) është i organizuar në dy departamente dhe një njësi e kërkimit shkencor, si vijon: Departamenti i Administrim Biznesit; Departamenti i Administrim Biznesit dhe IT; dhe Njësia e Kërkimit Shkencor CIRDI Ekonomi.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-1.1 Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip.pdf</i>  <i>DVV-1.6 Vendim i Bordit të Akreditimit nr.06, date 27.01.2023.pdf</i>  <i>DVV-1.5 Certifikata e Akreditimit leshuar nga Bordi i Akreditimit 2017.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Administrim Biznesit &amp; Teknologjisë së Informacionit përmbushin detyrimet ligjore, referuar nenit 20 dhe 23 të Ligjit për Arsimin e Lartë nr. 80/2015.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe vizita në IAL, GVJ konstaton se njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, në plotësim të detyrimeve të përcaktuara ligjore ka të angazhuar për programin e studimit, personel akademik dhe ndihmës akademik për realizimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-22. CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit - MSc në Tekn Info në Biznes.pdf</i>  <i>DVV-23. CV e stafit akademik të Fakultetit të Ekonomisë.pdf</i>  <i>DVV-24. Prezantimi i stafit të Fakultetit të Ekonomisë.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe vizita në IAL, GVJ konstaton se Departamenti BA&amp;IT si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit ka caktuar këshilltarin akademik të programit të studimit, që është dhe koordinatori i programit të studimit me vendim të Keshillit të Fakultetit të Ekonomisë. Ai kryen detyrat e ngarkuara dhe merr masat e nevojshme në funksion të mbarëvajtjes së programit të studimit. Në dokumentacionin e paraqitur dhe në RVB janë paraqitur të dhënat për koordinatorët për secilin nga programet.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-Shtojca Vendimi i keshillit të Fakultetit të Ekonomisë Nr.1 date 29.09.2022.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe vizita në IAL, GVJ evidenton se kriteret e këtij standarti për programin e studimit përmbushen, pasi kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për njësinë kryesore dhe bazë përgjegjëse përmbushen</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi II.3</b>																																		
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të ciklit të dytë.</b>																																		
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>																																	
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ konstaton se Departamenti i BA&IT, si njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ky informacion publikohet dhe në faqen kryesore të KU IKT duke përfshirë plan programin e studimit. Departamenti i BA&IT, disponon informacionet dhe ka vënë në dispozicion dokumentacionin për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: rregulloren, programin mësimor, syllabuset e lëndëve, stafin akademik të programit etj. Të gjitha këto ruhen në pranë Fakultetit të BA&IT dhe në sekretarinë mësimore.																																	
	<i>Evidenca:</i> DVV-Shtojca Vendimi i keshillit të Fakultetit të Ekonomisë Nr.1 date 29.09.2022																																	
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	GVJ konstaton se veprimtaritë formuese janë shpërndarë në përputhje me VKM nr. 41, dt.24.01.2018. Veprimtaritë formuese kanë një shpërndarje si në tabelën mëposhtë:																																	
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Pershkrimi</th> <th>% sipas VKM 41</th> <th>Kredite/ ECTS</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>Lëndë bazë</td> <td>5%-10%</td> <td>6</td> <td>5%</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>Lëndë karakterizuese</td> <td>50% - 60%</td> <td>66</td> <td>55%</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>Lëndë ndërdisiplinore/ integruese</td> <td>12%-20%</td> <td>18</td> <td>15%</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>Lëndë plotësuese (praktika profesionale)</td> <td>10%</td> <td>12</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>Detyrime përmbyllëse (punimi u diplomës)</td> <td>10%- 15%</td> <td>18</td> <td>15%</td> </tr> </tbody> </table>				Kategoria	Pershkrimi	% sipas VKM 41	Kredite/ ECTS	%	A	Lëndë bazë	5%-10%	6	5%	B	Lëndë karakterizuese	50% - 60%	66	55%	C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12%-20%	18	15%	D	Lëndë plotësuese (praktika profesionale)	10%	12	10%	E	Detyrime përmbyllëse (punimi u diplomës)	10%- 15%	18	15%
Kategoria	Pershkrimi	% sipas VKM 41	Kredite/ ECTS	%																														
A	Lëndë bazë	5%-10%	6	5%																														
B	Lëndë karakterizuese	50% - 60%	66	55%																														
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	12%-20%	18	15%																														
D	Lëndë plotësuese (praktika profesionale)	10%	12	10%																														
E	Detyrime përmbyllëse (punimi u diplomës)	10%- 15%	18	15%																														
	Nga shqyrtimi i rregullores së programit, planit mësimor dhe syllabuseve, GVJ konstaton se programi përmban 15 lëndë + praktikën profesionale + punimin e diplomës. Në syllabuset e lëndëve paraqitet qartë ndarja e elementëve të lëndës (leksion, seminar, laborator, detyrë apo project kursi). Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet																																	

	<p>informacion i nevojshëm për:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>ngarkesën mësimore, sipas veprimtarive mësimore: leksion, seminar, laborator, detyre kursi etj;</li> <li>orët në auditor/ jashtë auditorit, që studenti kryen për secilën lëndë dhe për çdo element të saj, gjatë një semestri;</li> <li>Grupin e lëndëve që studenti kryen çdo semester dhe çdo vit akademik;</li> <li>Numrin total të krediteve që fiton studenti si dhe numrin e krediteve për secilën lëndë.</li> </ol> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-19. Plani mesimor i programit te studimit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes.pdf</i>  <i>Tabelat përmbledhëse RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se rregullorja e programit të studimit dhe rregullorja e transferimit të studimeve, përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me pranimin, regjistrimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. GVJ citon nga rregullorja e programit: “Kriteret e pranimit të studentëve propozohen nga Departamenti i BA&amp;IT dhe miratohen nga Senati Akademik brenda periudhës së përcaktuar nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe dërgohen në institucionet e MASR, QSHA dhe RASH: Kriteret publikohen dhe janë të aksesueshme në portalin U-Albania dhe në faqen zyrtare të KU “IKT”.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-9. Rregullore Institucionale e KU IKT 2016 shqip.pdf</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i>  <i>DVV-96. Guida e Studentit.pdf</i>  <a href="https://cit.edu.al">https://cit.edu.al</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në rregulloren e programit të studimit, si dhe në modelin e syllabusit të lëndëve, paraqitet informacion i hollësishëm mbi detyrimin e frekuentimit / ndjekjes së programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, etj. Syllabuset e lëndëve janë hartuar sipas formatit të miratuar sipas VKM nr. 41, dt. 24. 01. 2018 dhe informojnë në lidhje me detyrimin për frekuentimin/ ndjekjen e programit nga studenti, mënyrën e vlerësimit të dijeve, literaturën, sasia e orëve mësimore për çdo tematikë të lëndës, pedagogun e lëndës etj. GVJ evidenton se institucioni ka paraqitur të gjitha syllabuset e lendeve per vitet akademike 2021-2022 dhe 2022-2023. Programet e lëndëve përmbajnë informacion për: titullarin, ngarkesën, tipologjia e lëndës, lloji i lëndës, programi i studimit, kodi i lëndës, adresa elektronike e</p>

	<p>titullarit, përshkrimi i lëndës, temat e lëndës, literature, forma e kontrollit dhe rregullore për frekuentimin e kursit. Shpërndarja e orëve në seminare dhe leksione jepet në tabelen 13 në shtojcën e RVB.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-19. Plani mesimor i programit të studimit MSc në Teknologji Informacioni në Biznes.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2021 - 2022.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2022 - 2023.pdf</i>  <i>Tabelat përmbledhëse RVB</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur për programin e studimit, GVJ konstaton se në IAL janë të mirëpërcaktuara procedurat që ndiqen për përmirësimet dhe ndryshimet në përmbajtjen e programit të studimit, në fillim të çdo viti akademik. Kjo realizohet duke zgjedhur literaturë sa më cilësore për çdo lëndë që zhvillohet në programin e studimit. Institucioni, duke qënë se programet i zhvillon në gjuhën angleze përdor librarite online në të cilat ka abonim dhe përdor literaturë të përditësuar.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-19. Plani mesimor i programit të studimit MSc në Teknologji Informacioni në Biznes.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2021 - 2022.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2022 - 2023.pdf</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton se njësisia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ky informacion publikohet dhe në faqen web të institucionit duke përfshirë planin e studimit, në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi II.4**

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, GVJ konstaton se emërtimi i programit të studimit është në përputhje me fushën akademike të tij. Shpërndarja e lëndëve dhe përmbajtja e veprimtarive mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe</p>

<p>studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>praktike. Praktikantët lëndore dhe aktivitetet për aftësimin e tyre profesional në institucione dhe kompani të ndryshme u kanë mundësuar studentëve aftësimin dhe në disa raste punësimin e studentëve. Mësimdhënia në gjuhën angleze, literatura më e fundit e përdorur nga libreria McGraw-Hill, stafi i huaj dhe stafi i diplomuar në universitetet ndërkombëtare dhe brenda vendit me eksperiencë shumë të mirë akademike i japin mundësi studentëve të përgatiten për karrierë akademike ose për tregun e punës.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- 19. Plani mesimor i programit te studimit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2021 - 2022.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2022 - 2023.pdf</i>  <i>Shtojca RVB Marrveshja McGraw-Hill Education</i>  <i>DVV 13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf(Qellimi, Objektivat)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se mundësohet arritja e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Programi i studimit ka 120 kredite, 30 kredite në çdo semester dhe çdo kredit është llogaritur me 25 orë mësimore. Në vitin e parë studentët ndjekin 10 module të ndara në dy semestra me nga 15 javë, ku njëra lëndë është me zgjedhje në semestrin e dytë. Ndërsa në vitin e dytë ata ndjekin 5 lëndë në semestrin e parë dhe praktikën mësimore në semestrin e dytë. Të gjitha modulet janë nga 6 ECTS, praktika mësimore ka 12 ECTS dhe Diploma 18 ECTS.</p> <p>Programi plotëson të gjitha normat e përcaktuara sipas akteve ligjore dhe atyre nënligjore për organizimin e tij, shpërndarjen e krediteve, orëve brenda dhe atyre jashtë klase për praktikën mësimore dhe mbrojtjen e temës së diplomës.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-19. Plani mesimor i programit te studimit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2021 - 2022.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2022 - 2023.pdf</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur raporti ndërmjet orëve teorike dhe praktike është 456 orë leksioni në klasë me 458 orë në klase për seminare, ushtrime, laboratore dhe projekte. Raporti teori/praktikë në auditor është afërsisht 50% me 50 %. Ky program studimi është i përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare, pasi dhe hapja e këtij programi është mbështetur në eksperiencat më të sukseshme dhe</p>

<p>Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>ndërkombëtare të fushës duke mundësuar arritjen e objektivave formues, kërkimin shkencor dhe formimin e specialistëve të aftë në fushën e teknologjisë së informacionit të profilizuar në biznes.</p> <p>Studentë të këtij programi studimi kanë marrë pjesë në konferenca shkencore me mentorimin e stafit akademik që mbulon programin e studimit. Insitucioni ka organizuar dy konferenca shkencore këtë vit akademik 2022-2023.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-19. Plani mesimor i programit te studimit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes.pdf</i>  <i>Aneksi nr 1. tabela 13</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i>  <i>DVV-67. Evidenca mbi konferencat.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Gjatë intervistave më personelin akademik dhe me studentët si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet se raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve dhe mobilitet gjatë studimit, si dhe aftësimin e tyre për tregun e punës në fushën e teknologjisë së informacionit të profilizuar në biznes.</p> <p>Insitucioni ka paraqitur në dokumentacion të dhëna për mobilitetet e studentëve dhe të stafit akademik.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-19. Plani mesimor i programit te studimit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes.pdf</i>  <i>Tabelat përmbledhëse RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në IAL janë të mirëpërcaktuara procedurat që ndiqen për përmirësimet dhe ndryshimet në planin mesimor të programit të studimit dhe syllabuset e programit të studimit. Në fillim të çdo viti akademik, syllabuset ngarkohen në sistemin e brendshëm UMS të institucionit bashkë me përditesimet e nevojshme duke përcaktuar edhe literaturën e detyruar dhe literaturën ndihmëse. Për literaturën perdoret libraria online e McGraw-Hill dhe O'REILLY-t me të cilin kanë abonim sipas marrëveshjes së paraqitur.</p> <p>Institucioni ka paraqitur që ka literaturë bashkëkohore për lëndët e veta pasi punon direkt në librarinë McGrawHill në të cilën ka abonim për stafin dhe për studentët.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-19. Plani mesimor i programit te studimit MSc ne Teknologji</i></p>



	<p><i>Informacioni ne Biznes.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2021 - 2022.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2022 - 2023.pdf</i>  <i>DVV-54. Marreveshje CIT - McGrawHill Education.pdf</i>  <i>DVV-52. Te dhena mbi biblioteken OREILLY-TEXO per CIT.pdf</i>  <i>Tabelat përmbledhëse RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>GVJ bazuar në të dhënat e marra nga dokumentacioni i dorëzuar dhe nga vizita në institucion konstanton se përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Në përputhje dhe me rregulloret përkatëse, qëllimi kryesor i programit të studimit është të pajisi të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike dhe aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar siç është teknologjia e informacionit e aplikuar në biznes. Ky program studimi është hapur e mbështetur në eksperiencë të sukseshme dhe ndërkombëtare të fushës duke mundësuar arritjen e objektivave formues dhe përfitim të njohurive, formimin e specialistëve të aftë në fushën e shkencave kompjuterike. Studentët e programit të studimit kanë marrë pjesë në konferenca në fushën e teknologjise se informacionit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i>  <i>DVV-12. Rregullore e departamentit BAIT shqip.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2021 - 2022.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2022 - 2023.pdf</i>  <i>DVV-19. Plani mesimor i programit te studimit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes.pdf</i>  <i>DVV-5. Studim i Tregut dhe plani financiar per programin Msc. Teknologji Informacioni ne Biznes - Tetor 2020.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ bazuar në të dhënat e marra nga dokumentacioni i dorëzuar dhe nga vizita në institucion konstanton se përmbajtja e programit të studimit jep mundësi të mëtejshme studimi dhe punësimi të studentëve në përputhje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. Këtë e tregon shkalla e lartë e punësimit të studentëve të programit të studimit, në institucione dhe kompani të njohura të fushës.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i>  <i>DVV-20. Gjurmimi i studenteve ALUMNI prej institucionit.pdf</i>  <i>DVV-5. Studim i Tregut dhe plani financiar per programin Msc. Teknologji Informacioni ne Biznes - Tetor 2020.pdf</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ bazuar në të dhënat e marra nga dokumentacioni i dorëzuar dhe</p>

	nga vizita në institucion konstanton se struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, e në përputhje me nivelin 7 të KSHK-së, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës në fushën e teknologjise se informacionit. Përmbajtja e programit të studimit jep mundësi të mëtejshme studimi dhe punësimi të studentëve në përputhje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar konstaton se në IAL janë hartuar politika për përmirësimin e programeve të studimit. Vlerësimi i programeve të studimit dhe i mësimdhënies realizohet me mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore duke marrë parasysh mendimet dhe reagimet e personelit të institucionit, studentëve të programit të studimit, të diplomuarve si dhe ekspertëve të jashtëm, që bashkëpunojnë me IAL. Vlerësimi ka për qëllim identifikimin e pikave të forta dhe atyre që kanë nevojë për përmirësim dhe kjo vlen për të gjitha programet e studimit që ofron IAL.</p> <p>Gjatë takimeve në IAL, GVJ konstatoi se departamenti dhe këshilltari i karrierës, në bashkëpunim me zyrën e planifikimit të karrierës organizojnë takime dhe aktivitete të stafit akademik dhe studentëve me të ftuar nga bashkëpunëtorë dhe partnerë të ndryshëm nga institucione partnere dhe tregu i punës. Gjate vitit janë organizuar disa takime me biznese të ndryshme për informacionet e tregut të punës në formatin e "Round Table" ku janë ftuar biznese të ndryshme. Institucioni ka organizuar gjatë këtij viti akademik dy konferenca shkencore ku kanë marrë pjesë studentët e tij dhe disa herë tavolina të rumbullakëta me bizneset. Këto takime kanë në fokus përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit, në përputhje me komentet dhe sugjerimet e marra nga punëdhënësit, që përfaqësojnë një kontribut të vlefshëm në procesin e rishikimit vjetor të programit të studimit me zhvillimet teknologjike, kërkesat dhe pritshmëritë e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Gjithashtu u konstatua një bashkëpunim shumë i ngushtë me bashkëpunëtorë dhe partnerë të ndryshëm nga tregu i punës të cilët ftohen të japin idetë e tyre për preferencet aktuale të tregut të punës në fushën e teknologjisë së informacionit.</p>

	<p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-28. Marreveshjeve me biznesin, siper marrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022.pdf</i>  <i>DVV-8. Vleresim i programit te studimit MSc. Teknologji Informacioni ne Biznes nga fakulteti dhe departamenti..pdf</i>  <i>DVV-18. Manuali i Keshillimit te Karrieres.pdf</i>  <i>DVV-45. Permbledhje Aktiviteti Shkencor ne Fakultetin e Ekonomise - 5 vitet e fundit.pdf</i>  <i>DVV-59. Informim mbi mundesite e punesimit dhe zhvillimit te praktikave mesimore ne kompani te ndryshme.pdf</i>  <i>DVV-81. Strategjia e Angazhimit te ALUMNI.pdf</i>  5. Studim i Tregut dhe plani financiar per programin Msc. Teknologji Informacioni ne Biznes - Tetor 2020.pdf  <i>DVV-20. Gjurmimi i studenteve ALUMNI prej institucionit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacioni e dorëzuar dhe nga vizita në insitucioni GVJ konstanton se institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p> <p>Institucioni ka paraqitur që në kuadër të përmirësimit të programit, nxit dhe përfshin në diskutime studentët nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Anketimit për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit nga studentët e regjistruar që realizohet në semestrin e fundit me studentët në prag diplomimi. Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit nga studentët e diplomuar realizohet pas diplomimit.</li> <li>2. Përshirjen në strukturat e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë</li> <li>3. Pjesëmarrjen në këshillin e Departamentit te BA&amp;IT.</li> <li>4. Perfshirja ne Senatin Akademik.</li> </ol> <p>Studentët e parë të këtij program studimi diplomohen në vitin akademik 2022-2023.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-33. Vlerësimi i programit të studimit MSc në Teknologji Informacioni ne Biznes nga studentët..pdf</i>  <i>RVB e MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes - (skanuar, shqip).pdf Ankesi 2 tabela 2-3</i>  <i>DVV-81. Strategjia e Angazhimit te ALUMNI.pdf</i>  <i>DVV-20. Gjurmimi i studenteve ALUMNI prej institucionit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra</p>	<p>Bazuar në dokumentacioni e dorëzuar dhe nga vizita në insitucion GVJ konstanton se institucioni përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit.</p> <p>Insitucioni në zbatim të marrëveshjeve, bashkëpunon me ekspërtët në fushën e shkencave kompjuterike, kompanitë e sukseshme që operojnë</p>

(veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<p>në vend, si dhe më institucionet partnere kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë vitit janë organizuar disa takime me biznese të ndryshme për informacionet e tregut të punës në formatin e "Round Table" ku janë ftuar biznese të ndryshme. Institucioni ka organizuar gjatë këtij viti akademik dy konferenca shkencore ku kanë marrë pjesë studentët e tij dhe disa herë tavolinë të rumbullaket me bizneset. Këto takime kanë në fokus përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit, në përputhje me komentet dhe sugjerimet e marra nga punëdhënësit, që përfaqësojnë një kontribut të vlefshëm në procesin e rishikimit vjetor të programit të studimit me zhvillimet teknologjike, kërkesat dhe pritshmëritë e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Të gjitha këto reflektohen në nevojat për përmirësim dhe azhurnim të kurrikulave të programit të studimit. Gjithashtu institucioni ka përfshirë në këtë program studimi dhe pedagogë të huaj të cilët kanë dhënë dhe eksperiencat e tyre. Megjithatë përmirësimi duket dhe në përdorimin e literaturës së huaj bashkëkohore të bibliotekave të McGraw-Hill dhe O'REILLY në të cilat pedagogët dhe studentët kanë mundësinë që të punojnë me literaturat e fundit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-33. Vlerësimi i programit të studimit MSc në Teknologji Informacioni ne Biznes nga studentët..pdf</i>  <i>Tabelat përmbledhëse RVB</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, GVJ konstaton se në IAL janë hartuar politika për përmirësimin e programeve të studimit. Vlerësimi i programeve të studimit dhe i mësimdhënies realizohet me mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore duke marrë parasysh mendimet dhe reagimet e personelit të institucionit, studentëve të programit të studimit, të diplomuarëve si dhe ekspertëve të jashtëm, që bashkëpunojnë me IAL. GVJ evidenton se në IAL, njësitë përgjegjëse angazhohen në përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, bashkëpunëtorëve në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat dhe kërkesat në fushë.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b> <b>X</b>

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe</b>	<b>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar GVJ konstanton se statuti I institucionit përcakton prioritetet dhe objektivat kryesorë të programeve të studimit që ofron. Prioriteti kryesor është kërkimi shkencor në</b>

<p>kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>përputhje me objektivat madhorë të institucionit. Këto prioritete dhe objektiva janë të përcaktuara më qartë e me detaje në rregulloret e veçanta. Programi i studimit është në përputhje me Strategjinë e zhvillimit të Insitucionit 2017-2024 me kreun 3 te saj “Misionin, Vizioni dhe Objektivat Institucionale”. Mund të përmendim këtu angazhimet për: Ofrimin e programeve të studimit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe ekonomisë; zhvillimi dhe avancimi i njohurive nëpërmjet veprimtarive mësimore dhe akademike të kryera brenda dhe jashtë vendit, trajnimi i studiuesve të rinj në fushat e vlerësimit teorik të teknologjisë së informacionit dhe ekonomisë; zgjerimi i kualifikimeve profesionale dhe shkencore për zhvillimin e mëtejshëm të aplikaionit dhe ekonomisë etj. Qëllimet kryesore janë: të jenë nje urë për arsimin në Amerikën e Veriut dhe Evropën; të jetë një urë lidhëse me universitetet e tjera të njohura ndërkombetarisht; të jetë një institucion efikas dhe të diplomuar të përgatitur për tregun e punës etj.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-1. Statuti i KU IKT 2016 shqip.pdf</i>  <i>DVV-Statuti i KU IKT 2019 i amenduar shqip.pdf</i>  <i>DVV-9. Rregullore Institucionale e KU IKT 2016 shqip.pdf</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti BA&amp;IT si njësitë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, synojnë rritjen e cilësisë së programeve të studimit dhe nxisin, mbështesin, bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore të departamentit dhe programit të studimit. Për maksimizim të arritjeve, duhet që stafi të mbulojë dhe pëfshihet në fushën e ekspertizës, pra duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit të tyre. Ky kujdes fillon që në momentin e rekrutimit të stafit të ri. Disa nga veprimtaritë e Fakultetit të Ekonomisë janë të vendosura në tabelat 1-6 në Aneksin 2. Ku jepet përmbledhje e aktivitetit kërkimor-shkencor përmes konferencave të organizuara, trajnimeve të ndryshme, seminareve, leksioneve të hapura, workshop-eve etj.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV Evidencë: Takimi me stafin akademik</i>  <i>DVV -22. CV e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit - MSc ne Tekn Info ne Biznes.pdf</i>  <i>DVV -24. Prezantimi i stafit të Fakultetit të Ekonomisë.pdf</i>  <i>Tabelat përmbledhëse RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti BA&amp;IT si njësitë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, nxit dhe motivon studentët të</p>

<p>studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>angazhohen në studime, trajnime, projekte dhe aktivitete kërkimore me mbështetjen dhe mentorimin e stafit akademik dhe IAL, në intershipet lëndore, pjesëmarrjet në konferenca dhe aktivitete të promovimit të arritjeve në fushën e shkencave kompjuterike dhe trajnime të ndryshme të ofruara nga kompanitë e fushës, që bashkëpunojnë me Departamentin e BA&amp;IT ose lektorët e ftuar nga institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Nga ana e tyre studentët synojnë të kenë sa më shumë eksperiencë pune në portofolet e tyre, si rrjedhim interesi është i përbashkët në pjesëmarrjen e tyre në projekte të kërkimit shkencor.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-28. Marreveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022.pdf</i>  <i>DVV-28. Marreveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022.pdf</i>  <i>DVV-RVB e MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes - (skanuar, shqip).pdf</i>  <i>Tabelat përmbledhëse RVB</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Institucioni ka përcaktuar në rregulloren e projekteve kërkimore shkencore, mbështetjen ndaj stafit akademik për botimet dhe pjesëmarrjet në aktivitete shkencore. Në këtë rregullore përcaktohet se veprimtaria kërkimore-shkencore financohet nga buxheti i universitetit. Buxheti për kërkimin shkencor mbulon shpenzimet për konferencat, revistat shkencore, publikimet, projektet dhe aktivitete të tjera kërkimore”. Njësi bazë mbështetet financiarisht nga IAL për realizimin e aktiviteteve të parashikuara të saj. Veçoria e programit të studimit ka të bëjë me kërkesën e vazhdueshme për nevojën e përdorimit të teknologjive bashkëkohore për realizimin e aktiviteteve mësimore, studimore, kërkimore e shkencore. Institucioni mbështet stafin akademik të njësi kryesore të Fakultetit të Ekonomisë për: publikimet e tyre falas në revistat shkencore të institucionit, pjesëmarrjen falas në konferencat e organizuara nga institucioni, sponsorizimin e artikujve shkencore të publikuar në revista shkencore ose konferenca. Në planin financiar në mbështetje të Fakultetit të Ekonomisë 2021-2025 janë të përfshira edhe zërat: kërkimi shkencor, konferencat që janë të dedikuara për stafin akademik të këtij fakulteti mbi bazën e të cilave mbështetet kërkimi shkencor i stafit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- 89 Politika për Publikimin dhe Vizibilitetin e Kërkimit shqip.pdf</i>  <i>DVV- 72. Vendim BA nr. 4 Rregullore Financiare 29.05. 2020.pdf</i>  <i>DVV- 88. Miratimi i sponsorizimit për publikimin e studimeve shkencore për Jona Puci, Ditila Ekmekçi eng.pdf</i>  <i>DVV- 55. Plani i financimit të Fakultetit të Ekonomisë dhe</i></p>

	<i>departamenteve 2019-2025.pdf</i> <i>Tabelat përmbledhëse RVB</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti BA&amp;IT si njësitë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, synon rritjen e cilësisë së programeve të studimit dhe nxit, mbështet, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore të departamentit dhe programit të studimit. Në statutin e IAL, është përcaktuar si prioritet kryesor kërkimi shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. Këto prioritete dhe objektiva janë të përcaktuara më qartë në rregulloret e veçanta të programit të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	<p>Institucioni mbështet kërkimin shkencor dhe synon lidhjen e ngushtë midis programit të studimit dhe produktit për tregun e punës. Prandaj institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore përmes mbështetjes financiare por edhe në bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore në tij dhe universitetet partnere, në aktivitete të ndryshme të kërkimit shkencor në mbështetje dhe të programit të studimit.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë në fillim të çdo viti akademik miraton grupet lëndore dhe ato të kërkimit shkencor që lidhen dhe me aplikimet në projekte. Këto grupe të miratuara bashkëpunojnë me njësinë e kërkimit shkencor CIRD dhe me zyrën e marrëdhënieve me jashtë për projekte. Stafi ka aplikuar për një numër të konsiderueshëm projektesh të cilat janë përmendur dhe në raportin vjetor insitucional për MAS. Janë fituar dy projekte dhe një ka kaluar në "short list".</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- 45. Permbledhje Aktiviteti Shkencor ne Fakultetin e Ekonomise - 5 vitet e fundit.pdf</i>  <i>DVV- 88. Miratimi i sponsorizimit për publikimin e studimeve shkencore për Jona Puci, Ditila Ekmekçi eng..pdf</i>  <i>Aneksi 2 Tabela 11</i>  <i>DVV- 88. Miratimi i sponsorizimit për publikimin e studimeve shkencore për Jona Puci, Ditila Ekmekçi eng.pdf</i>  <i>Tabelat përmbledhëse RVB</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e	Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore e programit të studimit, angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për studime e projekte me

projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik me ekspertizën e duhur dhe studentët më të mirë për realizimin e këtyre aktiviteteve kërkimore e shkencore. Institucioni ka organizuar aktivitete të ndryshme shkencore, si konferenca, kompeticione, seminare, leksione të hapura, takime dhe vizita në institucione të ndryshme, të cilat kanë ndihmuar studentet për të përfituar së më shumë prej stafit akademik, aktiviteteve, të ftuarve dhe personaliteteve të ndryshme etj.
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	<p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Aneksi 2 Tabela 11</i>  <i>DVV- 88. Miratimi i sponsorizimit për publikimin e studimeve shkencore për Jona Puci, Ditila Ekmekçi eng..pdf</i>  <i>Tabelat përmbledhëse RVB</i>  <a href="https://cit-hub.al/about-us/">https://cit-hub.al/about-us/</a></p>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	<p>Objektivat e mësimdhënies në këtë program studimi fokusohen në përgatitjen e individëve me aftësi profesionale dhe që janë të aftë të adoptohen me sukses në tregun e punës. Aktivitetete të ndryshme të organizuara nga IAL dhe Departamenti i BA&amp;IT në bashkëpunim me universitetet dhe kompanitë apo agjencitë partnere, ku përfitojnë dhe studentët e këtij program studimi, praktikat lëndore dhe praktika profesionale, lehtësojnë arritjen e objektivave të mësimdhënies, si dhe aftësimin profesional konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës, të studentëve në përfundim të programit të studimit. Pjesa më e madhe e studentëve janë të punësuar në fushën e programit të studimit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-28. Marreveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022.pdf</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i>  <i>DVV-5. Studim i Tregut dhe plani financiar per programin Msc. Teknologji Informacioni ne Biznes - Tetor 2020.pdf</i>  <i>DVV-33. Vlerësimi i programit të studimit MSc në Teknologji Informacioni ne Biznes nga studentët..pdf</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti BA&amp;IT, zbatojnë rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p> <p>Fusha e programit të studimit nuk është një profesion i rregulluar me ligj dhe si rrjedhojë me detyrimin ligjor për tu licensuar. Departamenti i BA&amp;IT në zbatim të marrëveshjeve dhe bashkëpunimit me ekspertët në fushën e shkencave kompjuterike, kompanitë e sukseshme që operojnë në vend, më institucionet partnere ndërkombëtare dhe agjencitë shtetërore në vend, bashkëpunon duke ftuar si lektor i ftuar, duke</p>



	<p>organizuar aktivitete specifike të përbashkëta apo në bashkëpunimet në kuadër të praktikave dhe intershipeve lëndore apo dhe projekteve të përbashkëta. Të gjitha këto reflektohen në nevoja për përmirësim dhe azhurnim të kurrikulave të programit të studimit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-28. Marreveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022.pdf</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i>  <i>DVV-5. Studim i Tregut dhe plani financiar per programin Msc. Teknologji Informacioni ne Biznes - Tetor 2020.pdf</i>  <i>DVV-33. Vlerësimi i programit të studimit MSc në Teknologji Informacioni ne Biznes nga studentët.pdf</i></p>			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> ).	Fusha e programit të studimit nuk është një profesion i rregulluar me ligj.			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Institucioni mbështet kërkimin shkencor dhe synon lidhjen e ngushtë midis programit të studimit dhe produktit për tregun e punës përmes mbështetjes financiare por edhe në bashkëpunim me struktura të tjera kërkimore të tij dhe universitetet partnere. Objektivat e mësimdhënies në këtë program fokusohen në përgatitjen e individëve me aftësi profesionale dhe me nivel të lartë të të menduarit kritik, të edukojë profesionistë që janë të aftë të adoptohen me sukses në tregun e punës kombëtar e ndërkombëtar. Fusha e programit të studimit nuk është një profesion i rregulluar me ligj.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1

**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me**

<b>metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale të miratuara nga IAL bazuar në rregullore specifike. Në mënyrë specifike personeli akademik është trajnuar dhe udhëzuar mbi metodat e reja të mësimdhënies innovative. Gjithashtu në program janë përfshirë në mësimdhënie staf i huaj i përgatitur dhe me ide innovative në fushën e teknologjisë.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik i programit të studimit merr në konsideratë nevojat e studentëve dhe bashkëpunon me ta për të ofruar një eksperiencë mësimdhënie-mësimnxënie sa më të mirë.</p> <p>Personeli akademik synon të respektojë dhe t'i përgjigjet nevojave dhe kërkesave të ndryshme të studentëve, duke ofruar:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit;</li> <li>2) në përputhje me aktivitetet formuese;</li> <li>3) praktika lëndore në kompani dhe institucione;</li> <li>4) në përgjigje të nevojave të studentëve dhe atyre me aftësi ndryshe;</li> <li>5) është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</li> </ol> <p>Duke pasur parasysh natyrën unike të çdo lënde, kriteret e vlerësimit ndryshojnë nga një lëndë në tjetrën. Është një kombinim i mësimdhënies tradicionale me metodat inovative si: miniprojekt në laborator, provimet e aplikimit, analiza kritike e punimeve kërkimore etj.</p> <p>Institucioni ofron bursat e ekselencës, të përshkallëzuar në varësi të rezultateve;</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i>  <i>DVV-Evidenca shtesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2021 - 2022.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2022 - 2023.pdf</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni angazhohet në mbështetjen e personelit akademik për përmirësimin e kompetencave të tyre didaktike. Ai inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnuese, leksione të hapura dhe workshope me profesorë të ftuar nga universitete të dalluara. GVJ pas vizitës në institucion konstaton se mjediset ku zhvillohet mësimi i programit i mundësojnë personelit akademik përdorimin e metodave të shumëllojshme të mësimdhënies.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i>  <i>DVV-Evidenca shtesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV-60. Certifikatat e trajnimeve te stafit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Institucioni ka siguruar që personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Procesi i kompetencës së mësimdhënies mbështetet në këto etapa:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fillon nga faza e rekrutimit të PAE dhe PAK. Staf i akademik që aplikon për t'u angazhuar në mësimdhënie rekrutohet nëpërmjet një procesi dinamik vlerësimi.</li> <li>2. Përveç kriterëve dhe dokumentacionit përkatës ekspertiza dhe përvoja e aplikantit vlerësohet përmes një leksioni të hapur demo që teston njohuritë e tij/saj për konceptet, analizat teorike si dhe aftësia dhe metodat e mësimdhënies.</li> <li>3. Verifikohet nëse stafi akademik është i specializuar në nëndisiplinën specifike në të cilën ata janë të angazhuar në mësimdhënie dhe janë kompetentë në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, duke përdorur metoda të ndryshme mesimore sipas temave dhe profileve.</li> <li>4. Në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënit Komisioni i Përhershëm dhe NJSBC organizon trajnime e seminare të ndryshme.</li> </ol> <p>Për të mundësuar një metodologji mesimore më efektive të bazuar në TIK dhe në Ekonomi, kompjuterët e klasës dhe kompjuterët e vendosur në laboratorë përmbajnë paketat e nevojshme për lëndët e këtij programi studimi. Duke iu referuar CV-ve të personelit akademik, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në "Teknologji e Informacionit ne Biznes" posedon përgatitje dhe kompetenca profesionale në mësimdhënie dhe në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Pjesë e personelit akademik të programit të studimit janë edhe ekspertë me eksperiencë në industri dhe</p>



	<p>administratë publike, me njohuri që lidhen dhe me kurrikulën e programit. Eksperienca e tyre është me vlerë në mbështetjen dhe demonstrimin në auditor të rasteve reale të zbatimit të lidhura me fushën e studimit të shkencave kompjuterike.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i>  <i>DVV-Evidenca shtesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV-60. Certifikatat e trajnimeve te stafit.pdf</i>  <i>DVV-46. Burimet Njerezore - Check Lista e dosjes personelit.pdf</i>  <i>DVV-22. CV e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit - MSc ne Tekn Info ne Biznes.pdf</i>  <i>DVV-23. CV e stafit akademik te Fakultetit te Ekonomise.pdf</i>  <i>DVV-24. Prezantimi i stafit të Fakultetit të Ekonomisë.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Personeli akademik plotëson formularin e anketave vetëvlerësuese që kontrollohet nga përgjegjësi i departamentit përkatës. Këto janë të paraqitura si procedura dhe në librin e rregulloreve institucionale. Gjithashtu rezultatet e anketimeve dhe vlerësimeve periodike të anketës vlerësuese të studentit për personelin akademik, ku përfshihen dhe format dhe metodat e mësimdhënies, i komunikohen çdo pedagogu në zarf të mbyllur. Stafit akademik përditëson syllabuset në fillim të vitit akademik ku reflekton dhe përmirësimin e formave e metodave të mësimdhënies. Ofrimi i ambienteve online ose fizike, si dhe intershipeve lëndore në lëndë specifike, që lejojnë realizimin e laboratorëve, detyrave, projekteve dhe punëve të ndryshme të pavarura inkurajojnë autonominë të studentit. Mësimdhënësit janë të pranishëm gjatë laboratorëve detyrave, projekteve dhe punëve të ndryshme të pavarura të cilat realizohen në vijim të pjesës teorike. GVJ konstatoi respekt të ndërsjelltë ndërmjet mësimdhënësve dhe studentëve gjatë vizitave në institucion.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i>  <i>DVV-34. Vlerësimi i stafit akademik prej strukturave përgjegjëse drejtuese.pdf</i>  <i>DVV-35. Vleresim i stafit akademik prej studenteve (disa vleresime).pdf</i>  <i>DVV-33. Vlerësimi i programit të studimit MSc në Teknologji Informacioni ne Biznes nga studentët..pdf</i>  <i>DVV-38. Model "Vetëvlerësimi" i stafit akademik eng.pdf</i>  <i>DVV-39. Pyetesori mbi kenaqesine e stafit ne pune ( Staff Satisfaction Survey).pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel</p>	<p>Institucioni në bashkëpunim me njësitë kryesore dhe me zyrat e NJSBC,</p>



<p>institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Zyra IT, Burimet njerëzore, Zyra Mardhenieve me jashtë dhe Projektet apo dhe me komitetet si ai për programet dhe Kurrikulat, Për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin, ka organizuar herë pas here trajnime ose takime që i kanë shërbyer jo vetëm zhvillimit personal të stafit akademik dhe administrative. NJSBC ka rregulloren e saj, ku përcaktohet edhe mënyra e organizimit dhe detyrat që kanë njësitë kryesore dhe bazë. Rezultatet e pyetësorit, të paraqitura të përmbledhura në raport dhe që i komunikohen individualisht personelit akademik, shërbejnë si bazë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Stafi akademik plotëson formularin e vetëvlerësimit i cili dorëzohet në njësinë bazë, përpara se të vlerësohen më tej nga eprorët e tyre. Dep BA&amp;IT realizon monitorimin e cilësisë për lëndët e ofruara nga programi edhe nëpërmjet anketës së lëndëve që plotësohet nga studentët. Kjo anketë mundëson gjithashtu rritjen e vetëdijes së personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në mësimdhënie. Institucioni inkurajon bashkëpunimin dhe ndarjen e eksperiencës të personelit të tij akademik dhe më gjerë. KPGSCI dhe NJSBC organizojnë seminare dhe trajnime të ndryshme në kuadër të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-78. Fakulteti i Ekonomise - Komiteti i Kurrikulave Studim i tregut te punes dhe vleresimi i programeve te studimit Fakulteti i Ekonomise - shtator 2021.pdf</i>  <i>DVV-90. Procesverbale takimesh te NJSBC.pdf</i>  <i>DVV-34. Vlerësimi i stafit akademik prej strukturave përgjegjëse drejtuese.pdf</i>  <i>DVV-35. Vleresim i stafit akademik prej studenteve (disa vleresime).pdf</i>  <i>DVV-33. Vlerësimi i programit të studimit MSc në Teknologji Informacioni ne Biznes nga studentët..pdf</i>  <i>DVV-38. Model "Vetëvlerësimi" i stafit akademik eng.pdf</i>  <i>DVV-39. Pyetesori mbi kenaqesine e stafit ne pune ( Staff Satisfaction Survey).pdf</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale të miratuara nga IAL nëpërmjet rregulloreve specifike. Institucioni angazhohet në mbështetjen e personelit akademik për përmirësimin e kompetencave të tyre didaktike. Departamenti vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë dhe reflektuar mendimin e studentëve. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) organizon dhe monitoron përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në nivel institucional dhe gjithashtu organizon seminare dhe trajnime të ndryshme në kuadër të</i></p>

	<i>përmirësimi të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimore.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore, janë të përcaktuara në rregulloren themelore të institucionit dhe rregulloren e programit të studimit. Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat u bëhen të njohura studentëve nëpërmjet sistemit UMS.  <i>Evidenca:</i> <i>DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i> <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i> <i>DVV-21. programet e lendeve 2021 - 2022.pdf</i> <i>DVV-21. programet e lendeve 2022 - 2023.pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstanton gjatë takimeve me personelin akademik dhe studentët e programit të studimit se syllabuset e lëndëve ruhen nga titullari i lëndës/modulit në sistemin UMS dhe studentët mund t'i shohin ato pas logimit në sistem, ku mund të marrin informacion mbi metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Këto informacione ju komunikohen gjithashtu studentëve në fillim të semestrit nga pedagogu i lëndës dhe janë të publikuara në faqen e Departamentit.  <i>Evidenca:</i> <i>DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i> <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i> <i>DVV-21. programet e lendeve 2021 - 2022.pdf</i> <i>DVV-21. programet e lendeve 2022 - 2023.pdf</i> <i>DVV Evidenca shtesë: Minutat gjate vizites ne IAL.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive, plotësimi i detyrimeve, si laborator, detyrë apo projekt kursi, testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar.

	<b>Evidenca:</b> DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf DVV-21. programet e lendeve 2021 - 2022.pdf DVV-21. programet e lendeve 2022 - 2023.pdf			
<b>Konkluzione</b>	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore, janë të përcaktuara në rregulloren themelore të institucionit dhe rregulloren e programit të studimit. Syllabuset e lëndëve ju vihen në dispozicion studentëve nga pedagogu i lëndës/modulit në sistemin UMS. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive, plotësimi i detyrimeve, si laborator, detyrë apo projekt kursi, testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Insitucioni ka paraqitur rregullore në të cilat përcaktohen mënyrat e vlerësimit të njohurive dhe pesha që zë secili prej elementëve të vlerësimit në bazë të së cilës stafi përgjegjës për programin e studimit dhe mësimdhënien ka hartuar programet e lëndëve. Testimi dhe vlerësimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale realizohet përgjatë vitit akademik me qëllim që studentët të jenë të angazhuar përgjatë semestrit dhe të vlerësohen sipas disa kriterëve të parashikuara në rregulloren themelore, në procedurat e vlerësimit të studentëve në funksion të përmbushjes së detyrimeve akademike dhe rritjes së cilësisë në mësimdhënie të udhëzimit dhe sipas kriterëve të parashikuara në syllabuset e lëndëve. Në përgjithësi, ka dy afate kohore të dedikuara për provimet afatmesme (java e 8-të e semestrit) dhe provimet përfundimtare (java 15 dhe 16-dy javët e fundit të semestrit). Midis provimeve studentëve u kërkohet të punojnë në projekte ose të bëjnë një prezantim, sipas çdo kursi, ose detyrat përkatëse siç janë përcaktuar në planprogramin e çdo lënde të ofruar në kurrikulat e programit të studimit. Ndërkohë sipas rregullores themelore të IAL, në vlerësimin përfundimtar të çdo lënde përfshihet minimumi një testim gjysmëfinal dhe ai final.
	<b>Evidenca:</b>

	<p><i>DVV-9. Rregullore Institucionale e KU IKT 2016 shqip.pdf</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2021 - 2022.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2022 - 2023.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Insitucioni nuk përdor sistem elektronik të testimit dhe vlerësimit por e sheh të arsyeshme të vijojë sipas metodologjisë së përcaktuar në rregulloret aktuale. Testimi elektronik mund të vlerësohet në të ardhmen si forme vlerësimi në bazë të numrit të studentëve.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-9. Rregullore Institucionale e KU IKT 2016 shqip.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar bëhet në përputhje me rregulloren themelore dhe atë të provimeve të IAL dhe sipas disa kritereve të parashikuara në syllabuset e lëndëve, ku në vlerësimin përfundimtar të çdo lënde përfshihet minimumi një testim gjysmëfinal dhe ai final.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-9. Rregullore Institucionale e KU IKT 2016 shqip.pdf</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2021 - 2022.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2022 - 2023.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i komponentëve të vlerësimit përfundimtar shoqërohet me komente nga pedagogu/pedagogët e lëndës, ku qartësohen të gjitha kriteret e përdorura në vlerësim dhe studentët ballafaqohen me vlerësimin dhe cilësinë e punimeve të tyre. Shpallja e rezultateve shoqërohet me shpjegimet përkatëse të përgjigjeve të sakta dhe me çelësin e tezës së provimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit u konstatua që në rastet e nevojshme, pedagogu/pedagogët e lëndës janë të gatshëm të japin mbështetjen dhe sqarimet shtesë të nevojshme për studentët që e kërkojnë këtë.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-9. Rregullore Institucionale e KU IKT 2016 shqip.pdf</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i>  <i>DVV-91. Foto evidenca te sistemit UMS.pdf</i>  <i>DVV-83. Raport i gjeneruar prej sistemit UMS per programet e studimit, nr. e studenteve, kalueshmerine, ngeljen etj..pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në rregulloret përkatëse të institucionit si ajo themelore dhe e disiplinës të studentëve është e përcaktuar moslejimi dhe janë përcaktuar masat që merren nga njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik që të shmangin plagjiaturën, kopjimin në provime dhe</p>



	<p>detyra. Detyrat e kursit dhe projektet kontrollohen për plagjiaturë me anë të platformave falas dhe pa pagesë. Testet e ndërmjetme dhe ai final administrohen nga prania në auditor e dy pedagogëve, të cilët janë përgjegjës për moslejimin e kopjimit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-9. Rregullore Institucionale e KU IKT 2016 shqip.pdf</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i>  <i>DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar bëhet në përputhje me rregulloren themelore dhe atë të provimeve të IAL dhe sipas disa kriterëve të parashikuara për komponentët e vlerësimit në syllabuset e lëndëve, ku në vlerësimin përfundimtar të çdo lënde përfshihet minimumi një testim gjysmëfinal dhe ai final.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf(pika 5.2.3fq7)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Institucioni ia komunikon rezultatet studentëve në sistemin UMS në të cilin njihen me vlerësimet në të gjitha lëndët. Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik u informuam se nëse studentët kishin paqartësi në lidhje me vlerësimin komunikonin në fillim me pedagogun/pedagogët e lëndës. Studenti në zbatim të rregullores së programit të studimit, në rast se ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi semestral, ai ka të drejtë që brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve, të paraqesë një ankesë me shkrim sipas formularit përkatës të miratuar tek zyra e sekretarisë mësimore për rivlerësim.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2021 - 2022.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2022 - 2023.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Ankimimi shqyrtohet nga një komision i cili ngrihet me vendim të Drejtuesit të Departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre anëtarësh. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo me shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim. Kjo procedurë dokumentohet dhe arkivohet pranë departamentit. Gjatë vizitës në institucion GVB u shpreh se ka</p>

	<p>pasur raste ankimimi nga studentët për vlerësimin dhe këto raste janë trajtuar duke ngritur komisione rivlerësimi.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstatoi se IAL siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në rregullore, procedura dhe kritere specifike, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit në çdo rast të kërkuar, të cilat u bëhen të njohura studentëve.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se program i studimit ka si objektivi të zhvillojë tek studentët një botëkuptim të thellë të teknologjise se informacionit dhe ekonomise, duke i gërshetuar me sa më tepër mbështetje praktike, si intershipet lëndore dhe praktika profesionale, në mënyrë që të përgatisë dhe aftësojë për tregun e punës individë të përgatitur profesionalisht për t'u përballur me kushtet e një tregu të hapur global në fushën e shkencave kompjuterike. Njohuritë që ofrohen nga ky program dhe kompetencat që studentët fitojnë përmes tij, u japin mundësinë të ndjekin edhe një karrierë kërkimore e akademike në një cikël më të lartë, për të rritur statusin e tyre profesional dhe përmbushjen e objektivave personale, të cilët angazhohen dhe në punën kërkimore të stafit të departamentit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-19. Plani mesimor i programit te studimit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2021 - 2022.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2022 - 2023.pdf</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Ky program studimi synon krijimin dhe zhvillimin e aftësive specifike dhe në fushën e teknologjisë së informacionit, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë gjuhën e huaj) dhe aftësi të tjera të veçanta kurrikulare si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Metodat e kërkimit shkencor të avancuar;</li> <li>• Digital and internet marketing;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Foundation of data analytics and data science;</li> <li>• Database Administration and Design;</li> <li>• Data Vizualisation;</li> <li>• Advance Data Mining;</li> <li>• Planing and control system; etj.</li> </ul> <p>Këto lëndë së bashku me të tjerat zhvillojnë aftësitë profesionale, të vecanta të studenteve që ndjekin kete program studimi dhe janë lëndë të kurikulave bashkëkohore.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-19. Plani mesimor i programit te studimit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2021 - 2022.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2022 - 2023.pdf</i>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit, rezulton se në fillim të semestrit, studentëve iu ofrohet informacion rreth mënyrës së organizimit të lëndës, objektivat e lëndës dhe rezultatet e pritshme. Metodot e testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale ju bëhen të njohura studentëve, analizohen dhe vlerësohen në përfundim të lëndës. Në këtë mënyrë u vihen në vëmendje konceptet dhe çështjet më të rëndësishme, si dhe të orientohen studentët për aplikimin e tyre, si dhe detyrimet përmbyllëse dhe vlerësimi i tyre sipas kriterëve të parashikuara dhe prezantuara në syllabuset e lëndëve. Një nga praktikatat e aplikuar në IAL janë praktikatat intershipet lëndore dhe ato profesionale në kompani dhe intitucione të ndryshme, të cilat janë mënyra më efektive për të zbatuar praktikisht njohuritë e marra gjatë zhvillimit të lëndëve. Nëpërmjet pyetësorëve të realizuar në fund të semestrit, IAL siguron informacion mbi cilësinë e aftësive që ata fitojnë. Gjithashtu vetë IAL realizon një analizë të provimeve përfundimtare dhe të rezultateve të studentëve, për të monitoruar kalueshmërinë, cilësinë, frekuentimin etj.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2021 - 2022.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2022 - 2023.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe</p>	<p>GVJ vlerëson se personeli akademik i programit të studimit transmeton dijet e tyre tek studentët duke demonstruar njohuritë dhe duke kryer praktika dhe testime laboratorike së bashku me studentët. Gjatë zhvillimit të orëve mësimore, studentët realizojnë prezantime apo detyra kursi dhe projekte të ndryshme të parashikuara dhe në syllabuset</p>

<p>punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>e të gjitha lëndëve. Studentët aplikojnë njohuritë e marra gjatë lëndëve në praktikat lëndore dhe profesionale.</p> <p>Gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët, GVJ evidentoi se personeli akademik i programit të studimit në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukturon studentët në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. Detyrat/projektet e kursit në lëndët përkatëse janë një mundësi reale për zhvillimin e punës në grup për raste hulumtimi shkencor apo zbatim real, në të cilat personeli akademik nxit studentët që ta trajtojnë studimin dhe gjetjen e zgjidhjes së problemeve duke u organizuar në skuadër. Në planin strategjik të institucionit një zë të veçantë ka rritja e mundësive dhe e përvojave ndërkombëtare për studentët duke synuar kështu rritjen e vetëdijes kulturore të studentëve dhe duke mbështetur idetë inovative profesionale dhe kërkimore shkencore.</p> <p>Institucioni ka ndërtuar ura komunikimi dhe bashkëpunimi me disa universitete në kuadër të marrëveshjeve ekzistuese për rritjen e kapaciteteve të stafit akademik dhe studentëve. Gjithashtu një pjesë e stafit akademik është me profesor të huaj.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV- 11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise (shqip).pdf</i>  <i>DVV- 12. Rregullore e departamentit BAIT shqip.pdf</i>  <i>DVV- 10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i>  <i>DVV- 30. Raporti Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022 shqip.pdf</i>  <i>DVV- 45. Permbledhje Aktiviteti Shkencor ne Fakultetin e Ekonomise - 5 vitet e fundit.pdf</i>  <i>DVV- 53. Marreveshja CIT - Agjencia e Abonimit te Shtypit 15.09.2021.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. Për vitin 2021-2022 e në vazhdim, Departamenti i BA&amp;IT ka hartuar dhe organizuar një plan aktivitetesh, ndër të cilat leksione të hapura, workshope dhe seminare mbi zhvillimet në fushë dhe jashtë strukturës së programit të studimit të personelit akademik të programit të studimit dhe lektorë të ftuar nga universitete partnere apo ekspertë në industri, si dhe seanca demonstruese mbi aplikime teknologjike.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-30. Raporti Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022 shqip.pdf</i>  <i>DVV-45. Permbledhje Aktiviteti Shkencor ne Fakultetin e Ekonomise -</i></p>

	<i>5 vitet e fundit.pdf</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	<p>Në planin strategjik të institucionit një zë të veçantë ka rritja e mundësive dhe e përvojave ndërkombëtare për studentët duke synuar kështu rritjen e vetëdijes kulturore të studentëve dhe duke mbështetur idetë inovative profesionale dhe kërkimore shkencore. Dep. BA&amp;IT si njësi përgjegjëse nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve kërkimore dhe angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për studime e projekte me karakter kërkimor shkencor duke angazhuar personelin akademik me ekspertizën e duhur. Në mënyrë specifike Dep. BA&amp;IT ka angazhuar stafin akademik dhe studentët në lidhje me realizimin e konferencës shkencore dhe revistës periodike të KU "IKT", pjesëmarrjen në konferenca dhe organizon aktivitete të ndryshme në funksion të kërkimit shkencor dhe realizimit të objektivave të programit të studimit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-30. Raporti Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022 shqip.pdf</i>  <i>DVV-45. Permbledhje Aktiviteti Shkencor ne Fakultetin e Ekonomise - 5 vitet e fundit.pdf</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se njohuritë që ofrohen nga ky program dhe kompetencat që studentët fitojnë përmes tij, u japin mundësinë të ndjekin edhe një karrierë kërkimore e akademike në një cikël më të lartë, për të rritur statusin e tyre profesional dhe përmbushjen e objektivave personale. Institucioni ka ndërtuar ura komunikimi dhe bashkëpunimi me disa universitete në kuadër të marrëveshjeve ekzistuese për rritjen e kapaciteteve të stafit akademik dhe studentëve. Departamenti i BA&amp;IT ka organizuar leksione të hapura, workshope dhe seminare mbi zhvillimet e fundit në fushë dhe jashtë strukturës së programit të studimit të personelit akademik të programit të studimit dhe lektorë të ftuar nga universitete partnere apo ekespertë në industri, si dhe seanca demonstruese mbi aplikime teknologjike. Gjithashtu ka angazhuar studentët në lidhje me realizimin e konferencës shkencore dhe revistës periodike të institucionit, pjesëmarrjen në konferenca dhe organizon aktivitete të ndryshme në funksion të kërkimit shkencor dhe realizimit të objektivave të programit të studimit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.5

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

45

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmblyëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Institucioni ka parashikuar në rregulloren themelore të tij, një procedurë të posaçme ku përcaktohen detyrimet që duhet të përmblyë studentit deri në diplomimin e tij. Për mbrojtjen e diplomës institucioni ka hartuar rregullore, manual dhe procedura të posaçme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mbi punimin e diplomës- Libri i rregulloreve insitucionale;</li> <li>• Manuali i punimit të diplomes</li> <li>• procedurat-rregullorja e programit të studimit dhe rregullorja e sekretarisë mësimore;</li> </ul> <p>Punimi i diplomës zë 18 kredite dhe është lënda përmblyëse e semestrit të katërt në këtë program studimi, që këtë vit akademik nxjerr të diplomuarit e parë. Institucioni ka hartuar kërkesat e diplomimit që i bëhen të ditura studentit nga Departamenti nëpërmjet kalendarit akademik dhe ky informacion publikohet në faqen e internetit të IAL, së bashku me udhëzimet e përgatitjes së tezës, që publikohet në faqen e internetit të Departamentit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-1. Statuti i KU IKT 2016 shqip.pdf</i>  <i>DVV-12. Rregullore e departamentit BAIT shqip.pdf</i>  <i>DVV-16. Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes shqip.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>Institucioni, ka hartuar një manual për përgatitjen e punimit të diplomës dhe kriteret e vlerësimit të punimit të diplomës. Studentët e programit të studimit diplomohen me punimin dhe mbrojtjen e një teze. Informacioni dhe udhëzimet për punimin e diplomës ofrohen në faqen zyrtare të internetit të departamentit dhe përcillen nga këshilltari akademik. Departamenti përcakton stafin akademik për udhëheqjen e diplomave, të cilët kanë rol kyç në mentorimin, kontrollin dhe vlerësimin e ecurisë së punimit deri në diplomim të studentit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-16. Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes shqip.pdf</i>  <i>DVV-79. Model i percaktimit te temes se diplomes.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Programi i studimit nuk aplikon provim final për studentët që diplomohen.</p> <p>Pas përgatitjes, vlerësimit dhe aprovimit të diplomës nga udhëheqësi dhe departamenti, studentit duhet të prezantojë punimin në juri, e përbërë nga 3 lektorë, e cila vepron si komision që vlerëson punimin e diplomës me notë, minimumi kaluese. Në këtë program studimi të diplomuarit e parë dalin këtë vit akademik.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-16. Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes shqip.pdf</i>  <i>DVV-79. Model i percaktimit te temes se diplomes.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton</p>	<p>Departamenti ka përcaktuar stafin akademik për udhëheqjen e</p>

<p>dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>diplomave këtë vit akademik. Personeli akademik përgjegjës për mbikëqyrjen dhe udhëzimin e studentëve gjatë procesit të përgatitjes së punimit të diplomës janë këshilltari akademik dhe udhëheqësi i diplomës, të përcaktuar për këtë program studimi. Caktimi i udhëheqësve të diplomës përfshin edhe asistencën e tyre në analiza, teste, matje, etj, në fushën e punimit të temës së diplomës, në ambientet e IAL apo jashtë tyre.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-16. Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes shqip.pdf</i>  <i>DVV-79. Model i percaktimit te temes se diplomes.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Insitucioni udhëzon studentët në procesin e kryerjes së hulumtimit dhe shkrimit të punimit, garantimin e cilësisë së punimit dhe rezultateve, si dhe miratimin e punimit final të diplomës për tu prezantuar para komisionit të diplomimit. Institucioni ka hartuar një udhëzues të miratuar për shkrimin dhe formatin e punimit të diplomës. Ky është viti i parë kur diplomohen studentët në këtë program studimi.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-16. Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes shqip.pdf</i>  <i>DVV-79. Model i percaktimit te temes se diplomes.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Studentët vlerësohen sipas një sistemi pikëzimi në përfundim të mbrojtjes së diplomës. Vlerësimi i tezës bazohet në një sistem pikëzimi, i cili kthehet në notë që pasqyron performancën e tyre kërkimore e shkencore në punimin e diplomës.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-16. Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes shqip.pdf</i>  <i>DVV-79. Model i percaktimit te temes se diplomes.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, IAL pajis studentin me diplomën dhe suplementin e saj. Ky është viti i parë kur diplomohen studentët në këtë program studimi. Institucioni ka aplikuar për regjistrimin e formatit të diplomës pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA).</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Insitucioni i ka të ruajtura të gjitha informacionet për studentët në sekretarinë mësimore, ku gjendet dosja me të gjithë informacionin e kërkuar. Zyrat përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentët dhe lëshohet diploma dhe suplementi i diplomës për studentët e diplomuar sipas afateve dhe rregulloreve. Institucioni përcakton në rregulloren e arkivës ruajtjen për një periudhë të pacaktuar të një kopje të dokumentacionit të studentit, që sipas</p>

	<p>kërkesës mund të marrë informacione në vazhdim.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV- 11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise (shqip).pdf</i>  <i>DVV- 12. Rregullore e departamentit BAIT shqip.pdf</i>  <i>DVV- 10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i>  <i>DVV- 30. Raporti Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022 shqip.pdf</i>  <i>DVV- 83. Raport i gjeneruar prej sistemit UMS per programet e studimit, nr. e studenteve, kalueshmerine, ngeljen etj..pdf</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimit përmbyllëse të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin e nevojshëm pas diplomimit, i cili arkivohet sipas rregullores së IAL.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<p><b>Standardi III.6</b>  <b>Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	Nuk aplikohet në këtë program studimi.
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfutimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	Nuk aplikohet në këtë program studimi.
<p><b>Kriteri 3.</b> Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	Nuk aplikohet në këtë program studimi.
<b>Konkluzione</b>	Nuk aplikohet në këtë program studimi.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

48



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në institucion, GVJ konstaton se nga zyra e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse janë mbledhur dhe ruajtur të dhënat e personelit akademik (me kohë të plotë apo të pjesshme) dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi dhe janë krijuar dosje personeli për secilin prej tyre, nga kjo zyrë janë mbajtur dhe ruajtur të dhëna për angazhimin e personelit akademik në programin e studimit. GVJ konstanton se personeli akademik efektiv dhe personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit.</p> <p>Institucioni i paraqet të gjithë kriteret e vlerësimit të stafik akademik në lidhje me nivelin e kualifikimit dhe në përputhje me strukturën e moduleve dhe përmbajtjen e programeve të studimit. Kjo është parë dhe nga kualifikimet që ka stafi akademik i angazhuar në programin e studimit. Nga zyra e burimeve njerëzore janë paraqitur dhe lista e personelit akademik, procedurat për hapjen e një pozicioni pune, vlerësimi i kandidatëve, caktimi i një anëtari të ri.</p> <p>Elementë të rëndësishëm në procesin e vlerësimit të kandidatëve janë si më poshtë: 1. Përvoja në mësimdhënie, me prioritet vlerësohet mësimdhënia në universitete e huaja në gjuhën angleze; 2. Grada shkencore PhD ose Doktor, si dhe tituj Profesor, Profesor i Asociuar, Akademik; 3. Cilësia dhe standardet e universitetit ku është diplomuar kandidati, ku prioritet u jepet personave me grada shkencore të marrë</p>

	<p>pranë institucioneve të arsimit të lartë me kredenciale të larta. 4. Përputhja e fushës së studimit me lëndët. GVJ bazuar ne dokumentacion konstanton qe personeli akademik ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij dhe nje pjese e stafit jane profesore te huaj qe kane sjelle dhe eksperince nga universitetet nderkombetare.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV- 10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i>  <i>DVV-11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise (shqip).pdf</i>  <i>DVV-22. CV e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit - MSc ne Tekn Info ne Biznes.pdf</i>  <i>DVV-23. CV e stafit akademik te Fakultetit te Ekonomise.pdf</i>  <i>DVV-24. Prezantimi i stafit të Fakultetit të Ekonomisë.pdf</i>  <a href="https://cit.edu.al/faculty-of-economy-vacancies/">https://cit.edu.al/faculty-of-economy-vacancies/</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Institucioni i paraqet të gjithë kriteret e vlerësimit të stafik akademik në lidhje me nivelin e kualifikimit dhe në përputhje me strukturën e moduleve dhe përmbajtjen e programeve të studimit. Kjo është parë dhe nga kualifikimet që ka stafi akademik i angazhuar në programin e studimit.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vendosur në fuqi nga institucioni u konstantua se personeli akademik efektive mbulon ngarkesën mësimore të programit të studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Personeli akademik efektive mbulon të gjithë ngrkesen e orëve në auditor. Këto të dhëna janë paraqitur në tabelën e ngarkesës por dhe u konstantuan gjatë vizitës me stafin akademik dhe gjithashtu dhe drejtuesin e departamentit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV- 10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i>  <i>DVV-11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise (shqip).pdf</i>  <i>DVV-22. CV e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit - MSc ne Tekn Info ne Biznes.pdf</i>  <i>DVV-23. CV e stafit akademik te Fakultetit te Ekonomise.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në zyrën e burimeve njerezore dhe gjithashtu nga dokumentacionet e vendosura ne dispozicion tregon që ka qëndrueshmeri të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Në zyrën e burimeve njerëzore u panë dokumentacionet e stafik akademik dhe gjithashtu u konstantuan dosjet për stafin e jashtëm dhe të brendshëm. Pjesë e dosjeve ishin CV e stafit akademik, vërtetim diplomash, kontratat e punësimit, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore etj.</p>

	<p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV- 10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i>  <i>DVV-11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise (shqip).pdf</i>  <i>DVV-22. CV e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit - MSc ne Tekn Info ne Biznes.pdf</i>  <i>DVV-23. CV e stafit akademik te Fakultetit te Ekonomise.pdf</i>  <i>DVV-19. Plani mesimor i programit te studimit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në një procedurë normale të publikuar punësimi për staf akademik gjenden këto specifikime: Përshkrimi i institucionit dhe fushave të studimit, Njësia që hap pozicionin (Fakulteti i Ekonomisë), pozicionet vakante, kurset ku mund të angazhohet stafi i ri, kualifikimet e kërkuara, dokumentacioni i aplikimit: letër interesi dhe CV.</p> <p>Kriteret shpallen publikisht ne faqen e web-it të institucionit dhe përzgjedhja bëhet me konkurim të hapur. Ngrihet nje komision rekrutimi që përbëhet nga përgjegjësi i zyrës së burimeve njerëzore dhe përgjegjës të njësisë bazë ose kryesore. Procesi i rekrutimit është i hapur dhe Komisioni i Rekrutimit analizon kandidaturat, i interviston; u jep dhe mundësinë për një orë të hapur leksioni dhe më pas kandidaturat listohen sipas vlerësimit që japin anëtarët e komisionit. Vlerësimi i performancës së personelit akademik bazohet në procedura të saktësuara në rregulloret e brendshme institucionale (Libri i Rregulloreve Institucionale). Elementë të rëndësishëm në procesin e vlerësimit të kandidatëve janë si më poshtë: 1. Përvoja në mësimdhënie, me prioritet vlerësohet mësimdhënia në universitete e huaja në gjuhën angleze; 2. Grada shkencore PhD ose Doktor, si dhe tituj Profesor, Profesor i Asociuar, Akademik; 3. Cilësia dhe standardet e universitetit ku është diplomuar kandidati, ku prioritet u jepet personave me grada shkencore të marrë pranë institucioneve të arsimit të lartë me kredenciale të larta. 4. Përputhja e fushës së studimit me lëndët.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV- 10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i>  <i>DVV-11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise (shqip).pdf</i>  <i>DVV-22. CV e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit - MSc ne Tekn Info ne Biznes.pdf</i>  <i>DVV-23. CV e stafit akademik te Fakultetit te Ekonomise.pdf</i>  <i>DVV-19. Plani mesimor i programit te studimit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes.pdf</i>  <i>DVV-46. Burimet Njerezore - Check Lista e dosjes personelit.pdf</i>  <i>DVV-47. Burimet Njerezore - Hapja e nje pozicioni pune.pdf</i></p>

	<p><i>DVV-48. Burimet Njerezore - Vleresimi i Kandidateve.pdf</i>  <i>DVV-49. Burimet Njerezore - Caktimi i nje anetari te ri.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka paraqitur në dokumentacion që ndjek procedura të rekrutimit dhe të vlerësimit transparent në stafin akademik. Këto procedura janë paraqitur në statutin e tij ku kriteret e punësimit përcaktohen nga njësia bazë, kurse me pas kalojnë të miratohen nga dekani dhe rektori.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në institucion, GVJ konstaton se në procedurën e ndjekur për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit akademik janë plotësisht të përfshirë Departamenti dhe Fakulteti përgjegjës për programin e studimit nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• paraqitjes së kërkesës dhe kriterëve të përgjithshme dhe të posaçme për plotësimin e vakancës/vakancave në perputhje me modulet dhe përmbajtjen e programit dhe kualifikimin e personelit të kërkuar;</li> <li>• përfaqësimit në shumicë të departamentit që mbulon programin në komisionin ad-hoc për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve fitues të vakancës/vakancave</li> </ul> <p>Institucioni me dokumentacionin e dorezuar siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV- 10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i>  <i>DVV-11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise (shqip).pdf</i>  <i>DVV-22. CV e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit - MSc ne Tekn Info ne Biznes.pdf</i>  <i>DVV-23. CV e stafit akademik te Fakultetit te Ekonomise.pdf</i>  <i>DVV-24. Prezantimi i stafit të Fakultetit të Ekonomisë.pdf</i>  <a href="https://cit.edu.al/faculty-of-economy-vacancies/">https://cit.edu.al/faculty-of-economy-vacancies/</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës</p>	<p>GVJ konstantoi që institucioni ka siguruar angazhimin maksimal të personelit akademik të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike, mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera mësimore.</p> <p>Institucioni ka paraqitur të përditësuara çdo vit të dhënat për personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi. Këto të dhëna janë të dokumentuara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Departamentin e Administrim Biznesi dhe Teknologjisë Informacioni</li> </ul> <p>(Departamenti ka listën e personelit akademik të angazhuar dhe të dhënat e ngarkesës mësimore të tyre.)</p>

<p>dhe administrativ.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në zyrën e burimeve njerëzore (Dosjet e stafi akademik ruhen ne vite ne zyren e burimeve njerëzore.Nga vizita e bërë në zyrën e burimeve njerëzore u panë dosjet e personelit akademik të njësisë dhe gjithashtu dhe përditësimi i tyre.)</li> <li>• Sekretarinë e Fakultetit (Jane regjistrat e mungesave të përdorur nga pedagogët për secilën nga lëndët, gjithashtu dhe procesverbalet e lendeve që kanë dorëzuar.)</li> <li>• Në sistemin ASCAL (Gjithashtu në sistemin Ascal janë paraqitur dokumentet e hedhura prej Koordinatorit të Institucionit në sistemin AMS.)</li> </ul> <p>Të dhënat e paraqitura përfshijnë të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës-akademik të institucion.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore për programin e studimit disponon: të dhëna të plota dhe të hollësishme në lidhje me personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie; listën e plotë të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme të angazhuar në mësimdhënie për çdo semestër dhe vit akademik. Lista e stafit me kohë të pjesshme aprovohet në senat, sipas propozimeve të fakulteteve përkatëse çdo vit akademik.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV- 10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i>  <i>DVV-11. Rregullore e Fakultetit te Ekonomise (shqip).pdf</i>  <i>DVV-22. CV e stafit akademik te angazhuar ne programin e studimit - MSc ne Tekn Info ne Biznes.pdf</i>  <i>DVV-23. CV e stafit akademik te Fakultetit te Ekonomise.pdf</i>  <i>DVV-19. Plani mesimor i programit te studimit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione dhe kompani të cilat i ka paraqitur dhe në dokumentacionin në dispozicion të GVJ. Gjithashtu i ka vendosur rëndësi të veçantë praktikave profesionale të cilat janë vendosur në dispozicion nga kompanitë që kanë bashkëpunim dhe stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie.</p> <p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi për organizimin e konferencave ndërkombëtare të përbashkëta, projekteve të përbashkëta kërkimore, trajnimet profesionale etj. dhe me universitete në disa vende të Europës. Në dokumentacion janë paraqitur dhe zhvillimi i leksioneve të hapura apo trajnimeve. Zyra e Karrierës informon studentët për mundësitë e ndryshme që kanë studentët për punësim pas diplomimit dhe gjithashtu dhe trajnimet e ndryshme që mund ti ofrohen.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i></p>

	<p><i>DVV- 26. Marreveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022.pdf</i>  <i>DVV- 27. Marreveshjet me universitetet 2016 - 2022.pdf</i>  <i>DVV- 28. Marreveshjeve me biznesin, siper marrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022.pdf</i>  <i>DVV- 29. Anetaresimi i IKT ne Cisco Academy.pdf</i></p>			
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Institucioni ka zyrën e karrierës e cila informon studentët për mundësitë e ndryshme që kanë studentët për punësim pas diplomimit dhe gjithashtu dhe trajnimet e ndryshme që mund ti ofrohen në kuader dhe të praktikave profesionale. Institucioni ka caktuar dhe një staf përfaqësues që ndërlihd zyrën e karrierës me studentët dhe u mundëson atyre vendin ku mund të bëhen praktikat profesionale.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV- 26. Marreveshjet ne kuader te Erasmus+ 2016-2022.pdf</i>  <i>DVV- 27. Marreveshjet me universitetet 2016 - 2022.pdf</i>  <i>DVV- 28. Marreveshjeve me biznesin, siper marrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022.pdf</i>  <i>DVV- 29. Anetaresimi i IKT ne Cisco Academy.pdf</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se nga zyra e Burimeve Njerëzore, si njësia përgjegjëse janë mbledhur dhe ruajtur të dhënat e personelit akademik (me kohë të plotë apo të pjesshme) dhe administrativ të angazhuar në programin e studimit dhe janë krijuar dosje personeli për secilin prej tyre. Institucioni ka paraqitur në dokumentacion që ndjek procedura të rekrutimit dhe të vlerësimit transparent në stafin akademik. Ka zyrën e karrierës e cila informon studentet për mundesite e ndryshme që kanë studentët për punësim pas diplomimit dhe gjithashtu dhe trajnimet e ndryshme që mund ti ofrohen në kuader dhe të praktikave profesionale.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Institucioni aktualisht është pozicionuar me adresë në Rrugën Khanfize Keko, Kompleksi Xhura, nr 12. Ka një sipërfaqe totale 2715m<sup>2</sup> në të cilat futen ambientet e parkimit 330 m<sup>2</sup> dhe 2385 m<sup>2</sup> janë ambiente në shërbim të procesit mësimor. Në shërbim të Fakultetit të Ekonomisë ku përfshihet dhe programi i studimit janë 994 m<sup>2</sup>.  Në dispozicion të programi të studimit janë 3 klasa me sipërfaqe 163m<sup>2</sup> për zhvillimi e orëve teorike për leksione, seminare dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

54

	<p>ushtrime. Institucioni ambientet e veta i ka paraqitur dhe të dokumentuara dhe me planimetri dhe gjithashtu u panë dhe gjatë vizitës në institucion. Në dokumentacion institucioni ka paraqitur dhe një raport të grupit të punës për verifikimin e standarteve dhe normativave të infrastrukturës nga MASR datë 28.07.2020.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV- 40. Planimetritë.pdf</i>  <i>DVV- 41. Kontrata e Qirase.pdf</i>  <i>DVV- 42. Raporti i Grupit te Punes per Verifikimin e Standardeve dhe Normativave te Infrastruktures nga MASR 28.07.2020.pdf</i>  <i>DVV- 43. Akti kunder Zjarrit Nr. Prot. C-10325.1, 24.05.2021.pdf</i>  <i>DVV- 44. Akti Higjiene Sanitar 171, date 24.05.2021.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore si klasat, laboratorët dhe mjediset e tjera janë të një standarti të lartë dhe janë të pajisura me të gjitha mjetet elektronike dhe mjetet e teknologjisë së informacionit të nevojshme. Sallat e leksioneve dhe seminareve kanë projektor dhe të gjitha mjetet e tjera për zhvillimin e mësimdhënies.</p> <p>Gjithashtu në shërbim të studenteve janë 5 laboratorë në dispozicion dhe të këtij programi të studimit dhe një laborator praktik për zhvillimin e lëndëve të ndryshme aplikative në të cilin kishin pajisje të ndryshme matëse etj.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV- 40. Planimetritë.pdf</i>  <i>DVV- 41. Kontrata e Qirase.pdf</i>  <i>DVV- 42. Raporti i Grupit te Punes per Verifikimin e Standardeve dhe Normativave te Infrastruktures nga MASR 28.07.2020.pdf</i>  <i>DVV- 43. Akti kunder Zjarrit Nr. Prot. C-10325.1, 24.05.2021.pdf</i>  <i>DVV- 44. Akti Higjiene Sanitar 171, date 24.05.2021.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Institucioni ka në dispozicion të programit të studimit mjedise të nevojshme dhe me standartë të larta për plotësimin e kërkesave të programit të studimit, ka 5 laboratore informatik të pajisur plotësisht me kompjutera, projektor, pajisjet për rrjetet kompjuterike, aparatura matëse të cilat ndodhën në laboratorin praktik (fizike, kimi, elektrike dhe telekomunikacioni), sallë konferencash, salla leksionesh dhe seminaresh të pajisura plotësisht me projektor dhe me kompjuter. Organizimi i ambienteve është paraqitur dhe në planimetrinë e dorëzuar nga institucioni.</p>
	<p>Gjatë vizitës në institucion u vizituan të gjitha ambientet dhe ishin plotësisht të kompletuar dhe në kushte optimale.</p>

	<p><b>Evidenca:</b>  DVV- Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;  DVV- 40. Planimetritë.pdf  DVV- 41. Kontrata e Qirase.pdf  DVV- 42. Raporti i Grupit te Punes per Verifikimin e Standardeve dhe Normativave te Infrastruktures nga MASR 28.07.2020.pdf  DVV- 43. Akti kunder Zjarrit Nr. Prot. C-10325.1, 24.05.2021.pdf  DVV- 44. Akti Higjiene Sanitar 171, date 24.05.2021.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në laboratorët e informatikës janë instaluar të gjithë software-t e nevojshëm që mund të përdoren në modulet përkatëse të procesit mësimor. Software-t që janë të instaluar janë: paketa Libre Office dhe gjithashtu programet profesionale që përdoren kryesisht dhe që janë të listuar janë: MS SQL Server, Microsoft Visual Studio, Netbeans, Wireshar, Programe të virtualizimit dhe të database-ve etj. Gjithashtu në fillim të çdo semestri stafi akademik i moduleve përkatëse për pjesën praktike të lëndëve të tyre mund të bëjë kërkesë që të shtohen software të tjerë në laboratore. Këtë kërkesë mund tia bëjë departamentit dhe tek stafi IT që merret me rregullimin dhe mbarvajtjen e laboratorëve.</p> <p>Organizimi i laboratorëve është paraqitur dhe në planimetrinë e dorëzuar nga institucioni. Në katin përdhës janë të pozicionuar 3 laboratorë të cilët kanë mundësi për akomodimin e rreth 50 studentëve secili.</p> <p>Gjate vizitës në institucion u vizituan dhe sallat e laboratorëve dhe ishin plotësisht të kompletuar dhe në kushte optimale.</p> <p><b>Evidenca:</b>  DVV- Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;  DVV- 40. Planimetritë.pdf  DVV- 41. Kontrata e Qirase.pdf  DVV- 42. Raporti i Grupit te Punes per Verifikimin e Standardeve dhe Normativave te Infrastruktures nga MASR 28.07.2020.pdf  DVV- 43. Akti kunder Zjarrit Nr. Prot. C-10325.1, 24.05.2021.pdf  DVV- 44. Akti Higjiene Sanitar 171, date 24.05.2021.pdf</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën</p>	<p>Institucioni me kapacitetin që zotëron vetë ka mjedise të mjaftueshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale që mund të merren nga pjesa praktike dhe laboratorët e moduleve përkatës të lëndëve të përfshira në programin e studimit. Gjithashtu ka dhe bashkëpunime me institucionet e tjera për zhvillimin e praktikave të studentëve. Në dokumentacion janë paraqitur dhe çertifikata të studenteve të marra nga organizimet e workshop-et ose trajnimet e bëra nga vetë institucioni.</p> <p>Institucioni është anëtarësuar dhe në Cisco Academy e cila mund ti japë studentëve dhe më shumë mundësi për praktika profesionale.</p>



<p>mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV- 40. Planimetritë.pdf</i>  <i>DVV- 41. Kontrata e Qirase.pdf</i>  <i>DVV- 42. Raporti i Grupit te Punes per Verifikimin e Standardeve dhe Normativave te Infrastruktures nga MASR 28.07.2020.pdf</i>  <i>DVV- 43. Akti kunder Zjarrit Nr. Prot. C-10325.1, 24.05.2021.pdf</i>  <i>DVV- 44. Akti Higjiene Sanitar 171, date 24.05.2021.pdf</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni ambientet e veta i ka paraqitur të dokumentuara dhe me planimetri dhe gjithashtu u panë dhe gjatë vizitës në institucion. Në dokumentacion institucioni ka paraqitur dhe një raport të grupit të punës për verifikimin e standarteve dhe normativave të infrastrukturës nga MASR datë 28.07.2020.</i>  <i>Institucioni me kapacitetin që zotëron vetë ka mjedise të mjaftueshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale që mund të merren nga pjesa praktike dhe laboratorët e moduleve përkatës të lëndëve të përfshira në programin e studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.3</b></p>	
<p><b>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka vendosur në dispozicion të studentëve një bibliotekë shumë të pasur. Biblioteka është e ndarë në dy pjesë në bibliotekën me librat e printuar dhe në bibliotekën online.          Biblioteka online ka marrëveshje me “McGrawHill Education” dhe në Platformën O’Reilly.          Studentët mund ti shfrytëzojnë bibliotekat plotësisht falas dhe nga ana institucionit janë bërë marrëveshje vjetore të cilat janë të paraqitura dhe në dokumentacionin e dorëzuar. Mjediset e bibliotekës u panë dhe gjatë vizitës në institucion dhe kryesisht librat në bibliotekë janë lënë të gjitha në literaturë angleze dhe vihet re mungesa e librave në shqip. Biblioteka ofron mundësi shfrytëzimi të barabartë nga studentët të cilët mund të futen online ose mund të kërkojnë tituj të ndryshëm për ta lexuar të printuar. Për menaxhimin e librave fizikë përdoret një sistem i menaxhimit të bibliotekës “Koha”. Studentet ose stafi mund të futen dhe të gjejnë librat dhe vendosjen e tyre në bibliotekë.          Në bibliotekë studentët mund të gjejnë literatura kryesore në fushat e ekonomisë dhe të teknologjisë së informacionit që janë dhe drejtimet kryesore që janë ofruar nga fakulteti. Literaturat janë bashkëkohore dhe</p>

	<p>pothuajse të gjitha botimet e fundit që është një nga aspektet më pozitive që mund të merret për institucionin.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shtesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV-51. Te dhena mbeshetese per biblioteken, blerjen e librave ne vitet e fundit.pdf</i>  <i>DVV-52. Te dhena mbi biblioteken OREILLY-TEXO per CIT.pdf</i>  <i>DVV-53. Marreveshja CIT - Agjencia e Abonimit te Shtypit 15.09.2021.pdf</i>  <i>DVV-54. Marreveshje CIT - McGrawHill Education.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Institucioni, përsa i perket bibliotekës ka një procedurë të posaçme. Në fund të vitit akademik biblioteka i dërgon stafit akademik një formular dixhital “Formular për kërkesë librash” dhe stafi ka kohë dy muaj që ta plotësojë dhe të zgjedhë librat që do të shtojë në bibliotekë dhe që mund ti perdorë për vitin e ardhshëm akademik.</p> <p>Gjithashtu biblioteka online dërgon të gjitha njoftimet për literaturat e fundit të botuara. Institucioni ka mundësuar që studentët e vetë të punojnë me bibliotekën online McGrawHill me të cilën ka abonim dhe përdor literaturat më të reja.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shtesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV-51. Te dhena mbeshetese per biblioteken, blerjen e librave ne vitet e fundit.pdf</i>  <i>DVV-52. Te dhena mbi biblioteken OREILLY-TEXO per CIT.pdf</i>  <i>DVV-53. Marreveshja CIT - Agjencia e Abonimit te Shtypit 15.09.2021.pdf</i>  <i>DVV-54. Marreveshje CIT - McGrawHill Education.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka krijuar akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët në bibliotekat online të cilat ata mund ti hapin kudo nga telefoni ose laptopi. Gjithashtu në të gjitha mjediset e tij të jepet mundësia që të futesh në wireless dhe studentët kanë mundësi që ta aksesojnë bibliotekën online.</p> <p>Studentët mund të futen dhe në bibliotekën e O’Reilly në kompjuterat e vendosur në bibliotekë. Ata kanë mundësi që të aksesojnë të gjitha mjediset e bibliotekës në oraret e caktuara gjatë gjithë kohës që janë në institucion.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shtesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV-51. Te dhena mbeshetese per biblioteken, blerjen e librave ne vitet e fundit.pdf</i>  <i>DVV-52. Te dhena mbi biblioteken OREILLY-TEXO per CIT.pdf</i></p>



	<p><i>DVV-53. Marreveshja CIT - Agjencia e Abonimit te Shtypit 15.09.2021.pdf</i></p> <p><i>DVV-54. Marreveshje CIT - McGrawHill Education.pdf</i></p> <p><i>DVV-53. Marreveshja CIT - Agjencia e Abonimit te Shtypit 15.09.2021.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me disa kopje fizike të literaturave dhe teksteve mësimore që zhvillohen në programin e studimit, gjithashtu dhe me literaturën ndihmëse përkatëse. Për gjetjen e kopjeve të librave është në dispozicion një program për menaxhimin e bibliotekës.</p> <p>Kurse në bibliotekën online më të cilën punohet më tepër dhe studentët kane mundësi që ta hapin nga telefoni dhe në laptop janë të gjitha materialet mesimore për lëndët përkatëse të modulit. Gjithashtu rregullat e bibliotekës janë të publikuara dhe online në faqen e web-it të institucionit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>DVV- Evidenca shtesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i></p> <p><i>DVV-51. Te dhena mbeshtetese per biblioteken, blerjen e librave ne vitet e fundit.pdf</i></p> <p><i>DVV-52. Te dhena mbi biblioteken OREILLY-TEXO per CIT.pdf</i></p> <p><i>DVV-53. Marreveshja CIT - Agjencia e Abonimit te Shtypit 15.09.2021.pdf</i></p> <p><i>DVV-54. Marreveshje CIT - McGrawHill Education.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka krijuar mundësinë që studentët të mos paguajnë për bibliotekën kryesore që përmban literaturat e librave në anglisht dhe literaturat e kërkua nga modulet përkatëse. Biblioteka e McGrawHill është plotësisht e përdorshme nga stafi dhe nga studentët. Institucioni ka bërë abonim në bibliotekë me të cilën ka dhe një marreveshje që e ka paraqitur në dokumentacionin e vet.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>DVV- Evidenca shtesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i></p> <p><i>DVV-51. Te dhena mbeshtetese per biblioteken, blerjen e librave ne vitet e fundit.pdf</i></p> <p><i>DVV-52. Te dhena mbi biblioteken OREILLY-TEXO per CIT.pdf</i></p> <p><i>DVV-53. Marreveshja CIT - Agjencia e Abonimit te Shtypit 15.09.2021.pdf</i></p> <p><i>DVV-54. Marreveshje CIT - McGrawHill Education.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike të librave online ose në formatin pdf të cilat janë në dispozicion të studentëve. Gjithashtu në dispozicion të studentëve është vendosur dhe platforma OReilly me të cilën kishin një marrveshje bashkepunimi për libra. Biblioteka menaxhohet nga sistemi Koha që është një sistem Open Source. Në bibliotekë zhvillohen dhe takime në formën e workshop-it.</p>

	<p>Biblioteka ka një kapacitet prej 20 vendesh ku 6 vende janë për përdorim kompjuteri dhe internet.</p> <p>GVJ rekomandon shtimin e hapësirave në bibliotekë për studentët e këtij programi studimi.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV-51. Te dhena mbeshetese per biblioteken, blerjen e librave ne vitet e fundit.pdf</i>  <i>DVV-52. Te dhena mbi biblioteken OREILLY-TEXO per CIT.pdf</i>  <i>DVV-53. Marreveshja CIT - Agjencia e Abonimit te Shtypit 15.09.2021.pdf</i>  <i>DVV-54. Marreveshje CIT - McGrawHill Education.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është në dispozicion të studenteve dhe ka orarë të përshtatura me nevojat e studentëve. Ajo qëndron e hapur për studentët dhe stafin akademik gjatë gjithë javës.</p> <p>Oraret e bibliotekës janë E henë-E premte 09:00- 13:00 dhe 14:00-18:00 dhe te shtunën 08:00-15:00. Studentët kanë mundësi të futen online në bibliotekën virtuale të McGrawHill në çdo kohë.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV-51. Te dhena mbeshetese per biblioteken, blerjen e librave ne vitet e fundit.pdf</i>  <i>DVV-52. Te dhena mbi biblioteken OREILLY-TEXO per CIT.pdf</i>  <i>DVV-53. Marreveshja CIT - Agjencia e Abonimit te Shtypit 15.09.2021.pdf</i>  <i>DVV-54. Marreveshje CIT - McGrawHill Education.pdf</i>  <a href="https://cit.edu.al/library-2/library-policies/opening-hours">https://cit.edu.al/library-2/library-policies/opening-hours</a></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Institucioni, përsa i perket bibliotekës ka një procedurë të posaçme. Në fund të vitit akademik biblioteka i dërgon stafit akademik një formular dixhital “Formular për kërkesë librash” dhe stafi ka kohë dy muaj që ta plotësojë dhe të zgjedhë librat që do të shtojë në bibliotekë dhe që mund ti perdorë për vitin e ardhshëm akademik.</p> <p>Gjithashtu biblioteka online dërgon të gjitha njoftimet për literaturat e fundit të botuara.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- Evidenca shitesë: Minutat gjate vizites ne IAL;</i>  <i>DVV-51. Te dhena mbeshetese per biblioteken, blerjen e librave ne vitet e fundit.pdf</i>  <i>DVV-52. Te dhena mbi biblioteken OREILLY-TEXO per CIT.pdf</i>  <i>DVV-53. Marreveshja CIT - Agjencia e Abonimit te Shtypit 15.09.2021.pdf</i></p>

	<i>DVV-54. Marreveshje CIT - McGrawHill Education.pdf</i> <a href="https://cit.edu.al/library-2/McGrawHill-Education-Textbook/">https://cit.edu.al/library-2/McGrawHill-Education-Textbook/</a>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Institucioni ka vendosur në dispozicion të studentëve një bibliotekë të pasur. Biblioteka është e ndarë në dy pjesë në bibliotekën me librat e printuar dhe në bibliotekën online.</i></p> <p><i>Biblioteka online ka marrëveshje me "McGrawHill Education" dhe në Platformën O'Reilly.</i></p> <p><i>Studentët mund ti shfrytëzojnë bibliotekat plotësisht falas dhe nga ana institucionit janë bërë marrëveshje vjetore të cilat janë të paraqitura dhe në dokumentacionin e dorëzuar.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon shtimin e hapësirave në bibliotekë për studentet e institucionit e veçanërisht këtij programi studimi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Institucioni disponon një sistem të menaxhimit në të cilin administron të gjithë informacionin që lidhet me studentet.</p> <p>Sistemi është i njohur me emertimin UMS (University Management System) dhe është i bazuar në një platformë online, i aksesueshëm nga të gjithë studentet, stafi administrative dhe stafi akademik.</p> <p>Secili mund të futet me një username dhe password që jepet nga stafi IT. Sistemi gjendet në faqen online të institucionit.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>DVV- 91. Foto evidenca te sistemit UMS.pdf</i></p> <p><i>DVV- 83. Raport i gjeneruar prej sistemit UMS per programet e studimit, nr. e studenteve, kalueshmerine, ngeljen etj..pdf</i></p> <p><a href="https://cit.edu.al/my-cit-2/">https://cit.edu.al/my-cit-2/</a></p>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>Sistemi i menaxhimit UMS bën administrimin e informacioneve që janë të lidhura me aktivitetet akademike me programet e studimit. U mundëson studentëve informacion mbi mungesat, vlerësimet, provimet.</p> <p>Sistemi ka të integruar platformën google classroom dhe modulet që mundësojnë komunikimin midis studenteve dhe pedagogëve. Duke patur parasysh integrimin e sistemit të google classroom studentët mund të aksesojnë materialet e dërguara nga pedagogët si slidet, detyrat, projektet lëndës (të dhëna në afatate të caktuara), mund të kenë komunikime direkte me klasën ose me stafin akademik (pra mund të jepen njoftime etj.) Studenti nga UMS merr vlerësimin e</p>

	<p>vazhdueshëm që i bëhet nga pedagogu i lëndës dhe mund të komunikojë direkt me pedagogun në rast se ka paqartësi.</p> <p>Mënyra se si janë të aksesueshme këto sisteme online është dhënë dhe në rregulloren e menaxhimit të mësimdhënies online.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- 91. Foto evidenca te sistemit UMS.pdf</i>  <i>DVV- 83. Raport i gjeneruar prej sistemit UMS per programet e studimit, nr. e studenteve, kalueshmerine, ngeljen etj..pdf</i>  <a href="https://cit.edu.al/my-cit-2/">https://cit.edu.al/my-cit-2/</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit UMS bën të mundur aksesimin e të gjitha informacioneve dhe dokumenteve për personelin akademik dhe për studentët në programin e studimit.</p> <p>Siguron akses në dokumentet e paraqitura nga sekretaria për studentët, gjithashtu në komunikimin direkt me departamentin dhe më pedagogët e lëndëve, ose njoftime të bëra nga departamenti.</p> <p>Studentët janë të lidhur në sistem me adresat e tyre të email-it, kanë mundësinë të aksesojnë google classroom etj</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- 91. Foto evidenca te sistemit UMS.pdf</i>  <i>DVV- 83. Raport i gjeneruar prej sistemit UMS per programet e studimit, nr. e studenteve, kalueshmerine, ngeljen etj..pdf</i>  <a href="https://cit.edu.al/my-cit-2/">https://cit.edu.al/my-cit-2/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi UMS ka të integruar google classroom për komunikimin me perdagogët dhe marrjen e materialeve të tjera ndihmëse për lëndën, ka të dhëna për aktivitetin akademik, vlerësimet, mungesat, provimet dhe mund të aksesohet online. Gjithashtu është i lidhur dhe me sistemin e sekretarisë.</p> <p>Studenti mund të komunikojë online nëpërmjet email-it të fakultetit me stafin akademik dhe stafin administrative, ose ndërmjet studentëve të tjerë.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- 91. Foto evidenca te sistemit UMS.pdf</i>  <i>DVV- 83. Raport i gjeneruar prej sistemit UMS per programet e studimit, nr. e studenteve, kalueshmerine, ngeljen etj..pdf</i>  <a href="https://cit.edu.al/my-cit-2/">https://cit.edu.al/my-cit-2/</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Sistemi është online dhe mund të aksesohet nga faqja e web-it e institucionit. Në sistem futen të gjitha organet drejtuese dhe kontrolluese të komunikimit të stafit dhe studentëve. Ky sistem i lidhur dhe me classroom-in është përdorur dhe gjatë periudhës së pandemisë.</p>

	<p>Sistemi mundeson raportime individuale për të dhënat e stafit akademik të cilat në fund të vitit akademik ruhen në kopje në sekretari ose në njësitë drejtuese të institucionit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- 91. Foto evidenca te sistemit UMS.pdf</i>  <i>DVV- 83. Raport i gjeneruar prej sistemit UMS per programet e studimit, nr. e studenteve, kalueshmerine, ngeljen etj..pdf</i>  <a href="https://cit.edu.al/my-cit-2/">https://cit.edu.al/my-cit-2/</a></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Institucioni ka të publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit çdo informacion që ka të bëjë me programet e studimit, stafin akademik, informacion mbi kriteret e pranimit, tarifat e studimit, përfitimet e bursave të studimit.</p> <p>Informacionet që hidhen e në faqen e internetit zakonisht janë në gjuhën angleze meqënëse është dhe gjuha që zhvillohen programet e studimit. GVJ sugjeron që informacionet në faqen e web-it të vendosen në të dyja gjuhët në shqip dhe në anglisht. Kjo për shkak se informacionet që janë të lidhura me programin e studimit mund të shikohen dhe nga prindërit e studentëve të cilet mbase nuk e kanë të përvetësuar plotësisht gjuhën angleze. Pasi për stafin akademik dhe për studentet është në formatin e institucionit që komunikimi dhe informacioni do të behet i gjithi në gjuhën angleze.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <a href="https://cit.edu.al/my-cit-2/">https://cit.edu.al/my-cit-2/</a>  <a href="https://cit.edu.al/student">https://cit.edu.al/student</a>  <a href="https://cit.edu.al/admissions-3/">https://cit.edu.al/admissions-3/</a>  <a href="https://cit.edu.al/research-2/">https://cit.edu.al/research-2/</a>  <a href="https://cit.edu.al/academics-2/">https://cit.edu.al/academics-2/</a></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Institucioni disponon një sistem të menaxhimit në të cilin administron të gjithë informacionin që lidhet me studentet.</i></p> <p><i>Sistemi është i njohur me emertimin UMS (University Management System) dhe është i bazuar në një platformë online, i aksesueshëm nga të gjithë studentet, stafi administrative dhe stafi akademik.</i></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Institucioni harton një

Institucioni është një institucion jo publik që operon si një shoqëri me

<p>raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>përgjegjësi të kufizuara. Institucioni financohet nga tarifat e studimit që paguhen nga ana e studentëve, financim nga ana e ortakut dhe donacione të ndryshme. Institucioni ka paraqitur raporte financiare të kostove të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të cilat janë bashkangjitur dhe me dokumentacionet përkatëse. Gjithashtu është bërë dhe raport i Auditimit të jashtëm rezultati i të cilit është paraqitur në dokumentacion.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- 55. Plani i financimit të Fakultetit të Ekonomisë dhe departamenteve 2019-2025.pdf</i>  <i>DVV- 56. Raport i Auditit të Jashtëm për institucionin - i pavarur.PDF</i>  <i>DVV- 57. CIT Prospektus - Programet Master - cikli i dyte 2020-2021 (Eng).pdf</i>  <i>DVV- 30. Raporti Institucional Vjetor i KU IKT për vitin akademik 2021-2022 shqip.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b>Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit. <b>proiektet dhe zëra të</b></p>	<p>Në planin e financimit janë përfshirë të dhëna të financimit për pagat dhe kontributet e sigurimeve, shpenzime operative dhe te mirembajtjes, shpenzime të tjera, investime, kërkimi shkencor dhe konferencash. Këto të dhëna janë dokumentuar në listen të cilën kanë paraqitur tek anekset të dhënë në raportin financiar dhe planin e financimit të institucionit dhe të përfshira dhe te programit të studimit. Në raportin vjetor të institucionit janë paraqitur në faqen 55 të gjitha të dhenat financiare për MAS.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- 55. Plani i financimit të Fakultetit të Ekonomisë dhe departamenteve 2019-2025.pdf</i>  <i>DVV- 56. Raport i Auditit të Jashtëm për institucionin - i pavarur.PDF</i>  <i>DVV- 57. CIT Prospektus - Programet Master - cikli i dyte 2020-2021 (Eng).pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni ka paraqitur auditim financiar të çdo viti dhe gjithashtu dhe autitim financiar nga auditor i pavarur. Të gjitha të dhënat financiare janë të dokumentuara dhe transparente. Deri tani është financuar nga te ardhurat nga programet e studimit, nga Ortaku dhe nuk ka përfituar nga grante të jashtme përveç donacioneve të cilat janë të paraqitura dhe në pasqyrën financiare. Ne raportet financiare te dhenat jane paraqitur te pergjithshme. Sugjerojmë që institucioni duhet të shtojë gamën e burimeve financiare të veta pasi nuk mund t;ia leri peshën më të madhe të të ardhurave vetëm tarifave të studentëve. Raportet financiare që janë paraqitur nga institucioni mund ti shikojmë dhe të përmbledhura tek shtojcat e RVB ku të ardhurat me kryesore të institucionit janë tarifat e shkollimit, shërbimet trajnuese, donacionet aktivite siguroese, donacione dhe përpara dy vitesh përfshihen dhe të</p>



	<p>ardhura nga aktivitete tregtare.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- 55. Plani i financimit të Fakultetit të Ekonomisë dhe departamenteve 2019-2025.pdf</i>  <i>DVV- 56. Raport i Auditit të Jashtëm për institucionin - i pavarur.PDF</i>  <i>DVV- 57. CIT Prospektus - Programet Master - cikli i dyte 2020-2021 (Eng).pdf</i>  <i>DVV- 30. Raporti Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022 shqip.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Institucioni ka paraqitur raporte vjetore financiare në mbyllje të çdo programi studimi. Gjithashtu kryhet një analizë financiare permanente tek zyra e financës në fund të çdo programi.</p> <p>Auditimi i pavarur kryen pasqyrën financiare në çdo vit në CIT shpk. Të gjitha shpenzimet financiare janë të dokumentuara në lëvizjet bankare të institucionit dhe në raportet e dorëzuara janë paraqitur të përmbledhura. Shikohet që në vazhdimësi për tre vitet e fundit nga të ardhurat në total të paraqitura në Aneks i RVB, institucioni ka paraqitur një rritje të të ardhurave në total nga tarifat e shkollimit. Kurse nga donacionet, aktivitetet siguroese, fondacionet të ardhurat kanë qënë më të mëdha përpara tre viteve dhe në dy vitet e fundit kanë qënë në rënie. Shërbimet trajnuese vitin e kaluar kanë qënë me mire kurse për këte vit akademik mendoj se akoma nuk është bërë një përmbledhje e plotë.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- 55. Plani i financimit të Fakultetit të Ekonomisë dhe departamenteve 2019-2025.pdf</i>  <i>DVV- 56. Raport i Auditit të Jashtëm për institucionin - i pavarur.PDF</i>  <i>DVV- 57. CIT Prospektus - Programet Master - cikli i dyte 2020-2021 (Eng).pdf</i>  <i>DVV- 30. Raporti Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022 shqip.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka paraqitur qëndrueshmëri financiare gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit gjithashtu dhe gjate periudhes se pandemise qe mesimi u zhvillua online. Raportet financiare që ka paraqitur e tregojne këtë. Auditimi i pavarur ka paraqitur paqëndrueshmëri megjithatë deri tani në të ardhurat e paraqitura në tek Shtojca e RVB. Institucioni ka paraqitur një situatë financiare të qëndrueshme. Në faqen 2 të Raportit të Auditimit të pavarur është paraqitur situata e pasigurisë financiare në të cilin shkruhet që shoqëria ka një humbje të akumuluar dhe një kapital negative. Këto kushte tregojnë dhe ekzistencën e një pasigurie materiale. Gjithashtu citohet se aftësia e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi është e varur nga mbështetja e vazhdueshme financiare e aksionerëve të saj të cilët kanë</p>



	<p>konfirmuar se ata kanë burime të mjaftueshme për të siguruar mbështetjen e nevojshme financiare për shoqërinë për të paktën dhe 12 muajt e ardhshëm.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- 55. Plani i financimit të Fakultetit të Ekonomisë dhe departamenteve 2019-2025.pdf</i>  <i>DVV- 56. Raport i Auditit të Jashtëm për institucionin - i pavarur.PDF</i>  <i>DVV- 57. CIT Prospektus - Programet Master - cikli i dytë 2020-2021 (Eng).pdf</i>  <i>DVV- 30. Raporti Institucional Vjetor i KU IKT për vitin akademik 2021-2022 shqip.pdf</i></p>		
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Institucioni ka paraqitur qëndrueshmëri financiare gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit gjithashtu dhe gjatë periudhës së pandemisë që mesimi u zhvillua online. Raportet financiare që ka paraqitur e tregojnë këtë. Auditimi i pavarur ka paraqitur paqëndrueshmëri megjithatë deri tani në të ardhurat e paraqitura në tek Shtojca e RVB. Institucioni ka paraqitur një situatë financiare të qëndrueshme. Në faqen 2 të Raportit të Auditimit të pavarur është paraqitur situata e pasigurisë financiare në të cilin shkruhet që shoqëria ka një humbje të akumuluar dhe një kapital negative. GVJ rekomandon që institucioni duhet të shtojë gamën e burimeve financiare të veta pasi nuk mund t'ia leri peshën më të madhe të të ardhurave vetëm tarifave të studentëve.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje,	Procedura dhe kriteret e pranimit në programin e studimit janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe në përputhje me politikat e institucionit. Pranimi i studentëve në këtë program mbështetet në Ligjin Nr.80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Nr. 219, Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

66

<p>në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” (neni 74), në udhëzimet e përvitshme të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në kriteret e pëcaktuara të rregullores së institucionit, si dhe në kriteret të propozuara nga Departamenti.</p> <p>Pranimi në programin e studimit është i mundur për çdo student që zotëron një Diplomë Bachelor të shoqëruar me suplementin e diplomës në Ekonomik ose Informatikë / Shkenca Kompjuterike, shqiptarë ose të huaj, sipas standardit dhe rregullave të vendosura nga MAS, si dhe për studentët me transferim.</p> <p>Nga vizita që GVJ bëri në Sekretarinë e Fakultetit konstatuam se në këtë program studimi janë të regjistruar gjithsej 20 studentë respektivisht 10 studentë në vitin e parë dhe 10 studentë në vitin e dytë, nuk ka studentë të larguar, si dhe nuk ka studentë të transferuar. Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar me kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Studenti në përfundim të programit të studimit duhet të ketë grumbulluar 120 kredite. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online në faqen e web-it të institucionit, në fushatat informuese mediatike, si edhe gjatë këshillimit në institucion. Institucioni kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura përkatëse.</p> <p><b>Evidenca:</b> <i>DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni, zbaton procedura për pranimin dhe ndjekjen e programit të studimit të cilat i referohen dhe respektojnë barazinë dhe të drejtat për çdo student, duke nxitur konkurrencën dhe përmirësimin e cilësisë së edukimit në shërbim të vlerave. Të gjitha procedurat e shoqërojnë studentin përgjatë gjithë programit.</p> <p>Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloren e institucionit, si dhe në rregulloren e programit të studimit dhe procesi ndiqet në të gjitha njësitë përkatëse. Regjistrimi i studentëve në këtë program studimi kryhet pranë sekretarisë së Departamentit Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni.</p> <p>Institucioni përpiqet që të jetë transparent me studentët, i paanshëm dhe të përdorë parime e kriteret si barazia, ndershmëria, informimi zyrtar dhe publik, njoftimet duke ruajtur ekuilibrin ndërmjet aktorëve kryesorë brenda e jashtë institucionit, ku në mbështetje të kësaj është edhe Kodi i Etikës në nenin 4, pika 4.</p> <p><b>Evidenca:</b> <i>DVV-1. Statuti i KU IKT.pdf, neni 4 .</i> <i>DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Në takimin që GVJ pati me Drejtuesin e Departamentit me studentët e këtij programi studimi, si dhe nga dokumentacionet që pamë në Zyrën e Sekretarisë Mësimore u konstatua se institucioni harton, miraton me Vendim Senati dhe publikon kriteret e regjistrimit të studentëve për vitin pasardhës, edhe sipas kriterëve të MAS. Pas miratimit ato publikohen zyrtarisht edhe në faqen e web-it të institucionit: <a href="https://cit.edu.al/admissions-3/">https://cit.edu.al/admissions-3/</a></p> <p>Pranimi në programet e studimit të ciklit të dytë është i mundur për çdo student që plotëson kriteret dhe dorëzon dokumentat e mëposhtme pranë Zyrës së Pranimi të Fakultetit Ekonomik:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Të ketë përfunduar me sukses studimet në Republikën e Shqipërisë dhe të jetë pajisur me Diplomën përkatëse, në një program të ciklit të parë të studimit "Bachelor", ose një program të integruar të ciklit të dytë të studimit, që akreditohet në momentin e diplomimit të studentit (ose në një program të ciklit të parë jashtë vendit dhe të ekuivalentuar e njohur në RSH).</li> <li>✓ Diploma Bachelor duhet të jetë në degët: Administrim Biznesi, Menaxhim, Ekonomiks, Financë, Kontabilitet, Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, ose në fusha të përafërta.</li> <li>✓ Të ketë mbrojtur gjuhën angleze në përputhje me Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.</li> <li>✓ Preferohet të ketë mesataren të paktën 7.5 .</li> <li>✓ Në rastet kur studenti kërkon njohje të krediteve, procesi i njohjes dhe vlerësimit të programit të studimit bëhet nga Departamenti përgjegjës për programin.</li> <li>✓ Kryejnë pagimin e tarifës së caktuar vjetore dhe/ose totale sipas kushteve dhe përcaktimeve të kontratës përkatëse.</li> </ul> <p>Programi i studimit pranon kandidatët në varësi të kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike të institucionit dhe sipas kriterëve specifike që mund të propozohen nga Departamenti dhe miratohen në Senatin Akademik.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>Vendimin e Senatit Akademik Nr.1/1, datë 12.01.2020 për "Miratimin e Kriterëve të Pranimi 2021-2022".</i>  <i>Vendimin e Senatit Akademik Nr.1/1, datë 12.01.2021 për "Miratimin e Kriterëve të Pranimi për pranimet e ciklit të dytë në KU IKT 2022-2023".</i>  <i>DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të</p>	<p>Para fillimit të vitit akademik, IAL i dërgon për miratim MAS kuotat dhe kriteret për programin e studimit. Kriteret e pranimit miratohen me vendim të Senatit Akademik. Ky institucion ka të miratuara një sërë rregullash dhe politikash për zbatimin e këtyre procedurave, të cilat janë lehtësisht të aksesueshme dhe të kuptueshme nga studentët.</p>

<p>mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-13. Rregullore Mesimore e Programit MSc ne Teknologji Informacioni ne Biznes shqip.pdf</i>  <i>DVV-15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023 shqip.pdf.</i>  <i>DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i>  <i>16. Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes shqip.pdf.</i>  <i>87. Manuali i Praktikes Mesimore Master FE shqip.pdf</i>  <i>Vendim i Senatit Akademik Nr.1/1, datë 12.01.2021 për "Miratimin e Kriterëve të Pranimit për pranimet e ciklit të dytë në KU IKT 2022-2023".</i>  <i>Vendim i Bordit Administrativ Nr.3, datë 10.05.2021.</i>  <a href="https://cit.edu.al/wip-content/uploads/2023/04/Thesis-manual-23.pdf">https://cit.edu.al/wip-content/uploads/2023/04/Thesis-manual-23.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, bazuar në Vendimin e Senatit Akademik, mbi kriteret e regjistrimit të studentëve, përgatitet prospekti i institucionit me këto informacione dhe publikohet online dhe i printuar.</p> <p>Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Zyra e Pranimeve dhe Zyra e Marketingut bashkëpunojnë me njëra-tjetrën duke organizuar aktivitete të ndryshme informuese sikurse janë: Javët e Hapura për studentët virtualisht ose në institucion, panaiet e punës dhe studimit, përpunojnë materiale sqaruese, fletushka informuese, broshura, prospekte, reklamim në media etj.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-58. CIT Prospectus 22-23.pdf</i>  <a href="https://cit.edu.al/cit-broschures/">https://cit.edu.al/cit-broschures/</a>  <a href="https://cit.edu.al/open-week-at-cit">https://cit.edu.al/open-week-at-cit</a>  <a href="https://cit.edu.al/europe-week-fair/">https://cit.edu.al/europe-week-fair/</a>  <a href="https://cit.edu.al/education-fair-14th-edition-dont-miss-it/">https://cit.edu.al/education-fair-14th-edition-dont-miss-it/</a>  <a href="https://cit.edu.al/work-and-study-fair-2023/">https://cit.edu.al/work-and-study-fair-2023/</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Institucioni bazohet në vendimet e Senatit Akademik për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve, si dhe udhëzimin n Bordit të Administrimit për "Zbatimin e Tarifave të Studimit", ku shpjegohen kriteret, procedurat dhe politikat e zbatimit të tarifave dhe bursave të studimit për secilën kategori, nga të cilat përfitojnë edhe kandidatët nga kategoritë si: statusi i jetimit, personave me aftësi të kufizuara, si dhe komuniteti rom e ballkano-egjiptian. Institucioni ka nënëshkruar një marrëveshje me shoqatën "Roma Veritas Albania", ku në zbatim të kësaj marrëveshjeje ofron bursa studimi, trajnime dhe mundësi praktikë për stafin e organizatës.</p> <p>Institucioni ka vendosur një politikë kundër diskriminimit në lidhje me dallimet fetare, etnike dhe racore, e cila zotohet nëpërmjet Kodit të Etikës, neni 4. Studentët dhe stafi prej vitesh kanë ngritur "Klubin e Bamirësisë" (Charity Club), në funksion edhe të këtij qëllimi.</p>

	<p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf.</i>  <i>Vendim i Senatit Akademik Nr.1/1, datë 12.01.2021 për "Miratimin e Kritereve të Pranimit për pranimet e ciklit të dytë në KU IKT 2022-2023".</i>  <i>Vendim i Bordit Administrativ Nr.3, datë 10.05.2021, pikat 2 dhe 3.</i>  <a href="https://cit.edu.al/student/">https://cit.edu.al/student/</a>.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Bazuar në vendimet e Senatit Akademik për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve, parashikohet edhe regjistrimi i kandidatëve nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, si dhe trojet shqiptare Medvegje, Bujanovc dhe Preshevë. Përveç këtyre kategorive, institucioni pranon edhe kandidatë të huaj që duan të regjistrohen në programet e studimit që ai ofron në Fakultetin e Ekonomisë. Kriteret që aplikohen për regjistrimin e kandidatëve të huaj përcaktohen në rregulloren e programit të studimit dhe në rregulloren e sekretarisë mësimore, cikli i dytë. Gjithashtu, të dhëna mbi kërkesat dhe kriteret e regjistrimit për të gjithë kandidatët për student si brenda vendit edhe ata ndërkombëtarë janë publikuar edhe në prospektin e institucionit në variantet online e të printuar (faqet 42 dhe 43), në sesionin për studentët ndërkombëtarë.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-58. CIT Prospectus 22-23.pdf</i>  <a href="https://cit.edu.al/cit-broschures/">https://cit.edu.al/cit-broschures/</a>  <a href="https://cit.edu.al/admissions-3/">https://cit.edu.al/admissions-3/</a></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Institucioni harton politika mbështetëse ndihmëse me bursa për shtresat në nevojë, të cilat mbulojnë këto kategori studentësh: studentët e shkëlqyer, studentët me arritje të veçanta, studentët që kanë realizuar diplomat më të mira, shtresat në nevojë, studentët nga trojet shqiptare jashtë Shqipërisë.</p> <p>Institucioni ka nënshkruar një marrëveshje me Bankën Credins për t'u ardhur në ndihmë studentëve me mundësi të ulëta financiare që të financojnë studimet e tyre me kredi me zero përqind interes.</p> <p>Institucioni ndjek edhe disa politika mbështetëse që janë në favor të studentëve që frekuentojnë studimet në një nga programet e institucionit, të cilat janë: sigurimi i literaturës mësimore falas; sigurimi i marrëveshjeve të shëndetit; mbështetja e aktiviteteve sociale, kulturore e sportive të Qeverisë Studentore; trajnimi i studentëve në fusha të ndryshme; sigurimi i kartës së studentit; akordimi i çmimeve për studentët që fitojnë në kompeticione.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-28. Marrëveshjeve me biznesin, sipermarrjet dhe institucione te tjera 2016 - 2022.pdf.</i>  <i>Tabelat përmbledhëse RVB</i></p>

	<i>Vendim i Bordit Administrativ Nr.3, datë 10.05.2021, pikat 2 dhe 3.</i>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura të cilat mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve, nga hyrja në dalje dhe të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe Statutin dhe rregulloret e institucionit. Të gjitha rregulloret printohen në formatin për përdorim të përgjithshëm dhe vendosen në bibliotekë nga ku studentët mund të njihen me to dhe të marrin informacionin që u intereson atyre. Një pjesë e këtyre dokumenteve dhe rregulloreve gjenden të publikuara në faqen e web-it të institucionit. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Institucioni harton politika të ndihmës / bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</i></p> <p><i>Rregullorja e institucionit dhe e programit të studimit, përmbajnë në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikën e trajtimit të studentëve që nga regjistrimi e deri në përfundim të studimeve, apo transferimit të tyre, gjë që garanton qartësisht politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit të studimit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Institucioni informon studentët për të pasur një mbarëvajtje sa më të mirë të proceseve akademike dhe administrative në institucion, nëpërmjet Guidës së Studentit (pika 2.7 jep informacion mbi progresin akademik dhe pika 2.10 jep informacion mbi diplomimin), ku jepet informacion i detajuar për përparimin akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit në një tjetër.</p> <p>Kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin janë të përcaktuara edhe në dokumentet: Statuti, Rregullorja Institucionale, Rregullorja e Programit të Studimit, Rregullorja e Sekretarisë Mësimore për ciklin e dytë, Libri i Rregulloreve Institucionale.</p> <p>Në fillimin e vitit akademik, përpara fillimit të procesit mësimor,</p>

	<p>Fakulteti i Ekonomisë shpall në ambiente publike orarin mësimor për të gjitha degët dhe ciklet e studimit, në të cilin janë të përcaktuara qartë: kodi dhe emërtimi i lëndës, ngarkesa e lëndës, dita, ora, salla dhe pedagogu i lëndës për semestrin përkatës. Për çdo kurs hartohet programi mësimor (syllabusi), i cili u prezantohet studentëve nga pedagogu përkatës i lëndës në fillim të kursit. Studentët njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformave online të institucionit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/12/Final-Student-Guide-2019-2020.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një sërë rregulloresh për kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme të studentëve. Studentët informohen që para fillimit të vitit akademik për këto kritere dhe procedura. Dokumenti kryesor për zbatimin e këtyre procedurave është Rregullorja për ciklin e dytë të studimeve në përputhje me legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë.</p> <p>Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta, vetëm në fillim të vitit akademik. Studenti i cili dëshiron të transferojë studimet në KU IKT, informohet për të gjitha procedurat, kriteret që ndiqen në rastin e transferimit të studimeve. Në rastet kur studenti kërkon transferim të krediteve, procesi i njohjes dhe vlerësimit të programit të studimit bëhet nga UK IKT (si njësi pritëse) në nivel Fakulteti. Procesi i vlerësimit të kurrikulës dhe njohjes së lëndëve bëhet nga Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit të Kurrikulës i Departamentit përkatës.</p> <p>Nga takimet e GVJ me drejtuesin e Departamentit Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni dhe me Sekretarinë Mësimore u konstatua se nuk ka patur transferime në këtë program studimi.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-15. Rregullore e Sekretarise cikli i dyte 2022-2023 shqip.pdf</i>  <i>DVV-96. Guida e Studentit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve, të përmendura në Guiden e Studentit, pikat 2.4, 2.5, 2.6.</p> <p>Referuar organizimeve informuese institucionale (Java e Orientimit dhe informacionet online në faqen e web-it të institucionit), nëpërmjet Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës studentët kanë mundësi të informohen lidhur me programin e studimit, jetën studentore në institucion, mjediset e mësimdhënies, mënyrën e vlerësimit, sistemin e menaxhimit etj.</p> <p>Gjithashtu, stafi akademik në javën e parë të mësimimit i informon studentët në mënyrë të detajuar mbi procedurat e vlerësimit të dijeve,</p>



	<p>komponentët e vlerësimit, detyrat, format e testimit të njohurive, aftësitë që përfitojnë në përfundim të ndjekjes së lëndës etj.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-96. Guida e Studentit.pdf</i>  <i>DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale shqip.pdf</i>  <i>DVV-21. programet e lendeve 2022 - 2023.pdf</i>  <a href="https://cit.edu.al/orientation-and-integration-week-at-cit/">https://cit.edu.al/orientation-and-integration-week-at-cit/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, me drejtuesin e Departamentit Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, si dhe me studentët, u konstatua se institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit (bazuar në Rregulloren për Punimin e Diplomës), në takimet që njësitë bazë bashkë me koordinatorët zhvillojnë gjatë vitit. Gjithashtu, në Javën e Orientimit në fillim të çdo semestri studentëve të vitit të dytë Master u jepen prej drejtuesve të institucionit informacione të detajuara lidhur me diplomimin.</p> <p>Në takimet me studentët, ata njihen me formularin që duhet të plotësojnë për të aplikuar për zgjedhjen e temës së diplomës dhe caktimin e pedagogut udhëheqës, atyre u shpërndahen tematikat e sugjeruara për t'u zgjedhur prej tyre për diplomim ose pranonen edhe sugjerimet e studentëve për temën e diplomës që ata duan të realizojnë. Paralelisht, Manuali i Punimit të Diplomes dhe Rregullorja për Punimin e Diplomës u dërgohen edhe me email nga Sekretaria e Fakultetit ose nga drejtuesi i Departamentit.</p> <p>Punimet e temave të diplomës së studentëve kontrollohen në sistemin e plagjaturës për origjinalitetin e tyre, për të cilën studentët janë informuar nëpërmjet Guidës së Studentit pika 2.10.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-10. Libri i Rregulloreve Institucionale eng.pdf</i>  <i>DVV-16. Manuali i Punimit të Tezes se Diplomes shqip.pdf</i>  <i>DVV-96. Guida e Studentit.pdf</i>  <a href="https://cit.edu.al/orientation-and-integration-week-at-cit/">https://cit.edu.al/orientation-and-integration-week-at-cit/</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni vizitohet në mënyrë të vazhdueshme nga palët e interesuara, të cilat njihen drejtpërdrejt me aktivitetin studentor të institucionit, stafin akademik, infrastrukturën etj. Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Zyra e Marketingut dhe Zyra e Pranimeve, në bashkëpunim ndërmjet tyre zhvillojnë takime informuese në të gjithë Shqipërinë, organizojnë Javët e Hapura, panairë pune, shpërndajnë materiale informuese si: fletushka, broshura, prospekte, realizojnë reklamime në media dhe rrjete sociale.</p> <p><b>Evidenca:</b></p>

	<p>DVV-75. Katalogu i veprimtarive 2019 - 2022 eng.pdf  DVV-75. Katalogu i Veprimtarive 2020-2022 shqip.pdf  DVV-76. Katalogu i veprimtarive 2022 - 2023 eng.pdf  DVV-76. Katalogu i Veprimtarive 2022-2023 shqip.pdf  <a href="https://cit.edu.al/open-week-at-cit/">https://cit.edu.al/open-week-at-cit/</a>  <a href="https://cit.edu.al/europe-week-fair/">https://cit.edu.al/europe-week-fair/</a>  <a href="https://cit.edu.al/education-fair-14th-edition-dont-miss-it/">https://cit.edu.al/education-fair-14th-edition-dont-miss-it/</a>  Prospectus publikuar në faqen wweb: <a href="https://cit.edu.al/cit-broschures/">https://cit.edu.al/cit-broschures/</a></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konstaton se institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit. Informacioni është i detajuar në syllabusin e të gjitha moduleve të programit të studimit. Stafi, gjithashtu, informon studentët në javën e parë të fillimit të mësimit.</p> <p>GVJ nga takimi me studentët konstaton se ata u shprehën se ishin në dijeni të kriterëve dhe procedurave për mbylljen e studimeve të tyre nëpërmjet mbrojtjes së një punimi diplome. Diplomimi bëhet bazuar në përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome, i cili është produkt krijues dhe me origjinalitet i studentit, produkt që mund të ketë karakter teorik ose empirik.</p> <p>Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, si strukturë mbështetëse e këtij institucioni, bashkëpunon me Zyrën e Marketingut duke organizuar veprimtari të hapura informuese me palët e interesuara.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Nga takimi që GVJ pati me studentët, me drejtuesin e Departamentit Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni dhe me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, rezultoi se studentët informohen vazhdimisht lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit, komunikimeve me Zyrën e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, komunikimeve të ndryshme me stafin akademik, fletëpalosjeve, reklamimeve në media, faqes zyrtare të internetit të institucionit, broshurave në formë Prospekti etj.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <a href="https://cit.edu.al/master-of-science-in-business-information-">https://cit.edu.al/master-of-science-in-business-information-</a></p>

	<p><a href="#">technology/ ]</a>  <a href="https://cit.edu.al/cit-broschures/">https://cit.edu.al/cit-broschures/ ]</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Institucioni nëpërmjet web-it zyrtar të tij vë në dispozicion të studentëve informacione të ndryshme, ndër të tjerat edhe informacione mbi programin e studimit sipas cikleve të studimit, përshkrimin e këtij programi, strukturën akademike sipas viteve akademike, kreditet, lëndët sipas semestrave, praktikat mësimore, diplomimin dhe mundësitë e punësimit. Këto informacione pasqyrohen edhe në Prospect dhe në Rregulloren e Programit të Studimit, të cilat gjenden edhe në Bibliotekën e institucionit.</p> <p>Në fillim të semestrit pedagogu bën publik informacionin mbi modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, informacion ky që pasqyrohet edhe në syllabusin e lëndës. Për çdo informacion studentët mund të kontaktojnë direkt ose përmes e-mail me pedagogët, me Sekretarinë Mësimore, me Drejtuesit e departamenteve, me koordinatoren etj.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <a href="https://cit.edu.al/master-of-science-in-business-information-technology/">https://cit.edu.al/master-of-science-in-business-information-technology/ ]</a>  <a href="https://cit.edu.al/cit-broschures/">https://cit.edu.al/cit-broschures/ ]</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka lidhur shumë marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe kompani, nëpërmjet të cilave u mundëson studentëve praktikat mësimore, internship-et , si dhe oferta punësimi që vijnë prej këtyre kompanive.</p> <p>Institucioni i informon studentët për të gjitha këto nëpërmjet broshurave, Prospect-it online e të printuar, me email, si dhe nëpërmjet Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës e cila bashkëpunon ngushtë me studentët në të gjitha aspektet profesionale dhe social-kulturore.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-59. Informim mbi mundësitë e punësimit dhe zhvillimit të praktikave mësimore në kompani të ndryshme</i>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/BIT_MASTER.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2021/10/BIT_MASTER.pdf ]</a>  <a href="https://cit.edu.al/facilities-and-map">https://cit.edu.al/facilities-and-map</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët njoftohen rregullisht për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor dhe përditësimet përkatëse, nëpërmjet takimeve të rregullta me strukturat drejtuese dhe koordinorët e programeve, email-it, qasjes në web-in zyrtar të institucionit në kategorinë “Jeta Studentore”, si dhe akseset që u jepen atyre periodikisht për qasje nga email i tyre në Sistemin e Menaxhimit të Institucionit (UMS).</p> <p><b>Evidenca:</b></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p><a href="https://cit.edu.al/facilities-and-map">https://cit.edu.al/facilities-and-map</a> ]</p> <p>Informacioni për programet e studimit është publik dhe mund të aksesohet prej kujtdo në çdo moment në faqen e internetit, nga çdo pajisje dhe nga çdo vend i mundshëm.</p> <p>Studentët e programit të studimit aksesojnë sistemin UMS përmes aksesit që ata kanë në emailin e tyre dhe mund të marrin informacion për ecurinë në programin e studimit në çdo kohë. Qasja është elektronike dhe studenti mund ta përdorë sistemin nga të gjitha formatet elektronike, qofshin ato smartphone, tablet, PC etj., mjafton që studenti të ketë akses në adresën e tij elektronike të mundësuar nga institucioni.</p> <p>Institucioni administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetet mësimore të studentëve përmes sistemeve: UMS (Sistemi i Menaxhimit të Institucionit), Google Drive, Google Classroom.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV – RVB, Tabelat përmbledhëse, Aneksi Nr.2, tabela 14 “Platforma dhe sisteme të teknologjisë së informacionit në shërbim të institucionit”</i>  <a href="https://cit.edu.al/academics-2/">https://cit.edu.al/academics-2/</a>  <a href="https://cit.edu.al/master-of-science-in-business-information-technology/">https://cit.edu.al/master-of-science-in-business-information-technology/</a></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ, nga takimi që pati me studentët, me drejtuesin e Departamentit Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni dhe me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, konstaton se ata u shprehën se informohen lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimeve, komunikimeve me Zyrën e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, komunikimeve të ndryshme me stafin akademik, fletëpalosjeve, medias, faqes zyrtare të internetit të institucionit, broshurave në formë Prospekti etj.</i></p> <p><i>GVJ, nga takimet që pati me derjtuesit e fakultetit dhe të departamentit, konstaton se institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion / udhëzues sikurse është Rregullorja e Programit të Studimit, lidhur me programet e studimit, lëndët dhe përmbajtjen e tyre, syllabuset e lëndëve, nëpërmjet takimeve me stafin akademik dhe ndihmës, si dhe nëpërmjet informacioneve të publikuara në web-in e institucionit.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se KU IKT bashkëpunon ngushtë me industrinë, bizneset dhe kompanitë e ndryshme, me të cilat ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi, partnership në kuadër të kërkimit shkencor, realizimit të projekteve të përbashkëta me fokus kryesor shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik. Bazuar në këto marrëveshje bashkëpunimi realizohen praktikat mësimore, internship-et dhe më tej edhe punësimi i studentëve.</i></p> <p><i>GVJ, nga takimet që pati me drejtues të institucionit, Përgjegjës in e</i></p>

	<p><i>Departamentit etj., konstaton se studentët e këtij programi studimi informohen në mënyra të ndryshme e të shumta për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, nëpërmjet stafit akademik, sekretarisë, Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, web-it të institucionit, email-it, materialeve të printuara që gjenden rregullisht në bibliotekë etj.</i></p> <p><i>GVJ, në takimin që pati me studentët, konstaton se ata u shperën që informacioni në lidhje me programin e studimit, komunikimi me pedagogët, njoftimet e ndryshme në nivel universiteti / fakulteti / departamenti dhe çdo lloj informacioni institucional bëhet edhe nëpërmjet email-adresës së tyre personale në CIT, web-it të institucionit dhe rrjeteve sociale. Të gjitha këto metoda janë lehtësisht të aksesueshme edhe në distancë nga studentët.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e proflin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Aktualisht, programi i studimit nuk ka studentë të diplomuar, meqenëse ky program studimi është në proces akreditimi, disponohen vetëm statistika të regjistrimit të studentëve sipas viteve akademike që ata ndjekin.</p> <p>Por, institucioni disponon, përpunon dhe prodhon statistika mbi numrin e studentëve të diplomuar në programet e tjera të studimit që janë akredituar. Statistikat mblidhen prej Sekretarisë së Fakultetit dhe departamenteve pas çdo sezoni diplomimi dhe u vihen në dispozicion strukturave drejtuese dhe koordinatorit të programit të studimit.</p> <p>Të dhënat statistikore mblidhen dhe përpunohen prej zyrave përkatëse dhe përfshihen në këto dokumente: Raportet Vjetore të KU IKT për MASR, Raportin e CIRD Ekonomi, raportimet e ndryshme për regjistrimet dhe diplomimet në MAS, hedhjen e numrit të studentëve në sistemin online të ASCAL (AMS), raporteve të ndryshme të prodhura prej sistemit UMS, si dhe në raportet e ndryshme të akreditimeve për programet që kalojnë këtë proces.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-30 Raporti Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022 shqip.pdf</i>  <i>DVV- 31. Raporti CIRD Ekonomi 2021-2022.pdf</i>  <i>DVV- 83 Evidenca të raporteve të prodhuara pres sistemit UMS</i>  <i>DVV – RVB, Tabelat përmbledhëse</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni disponon të gjitha statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni në Biznes”, tërheqet nga programi dhe largimet para përfundimit të programit (aktualisht nuk ka tërheqje e as largime nga programi për asnjë nga vitet akademike), apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit. Ato përfshihen në raporte të ndryshme, si dhe deklarohen në MASR apo ASCAL (regjistrimet). Këto informacione menaxhohen nga Sekretaria Mësimore, të cilat ruhen në formë elektronike dhe në formë të shkruar në regjistrin përkatës sipas mënyrës së përcaktuar në Statutin e institucionit.</p> <p><i>DVV- 83 Evidenca të raporteve të prodhuara pres sistemit UMS</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” disponon, ruan dhe menaxhon të dhënat statistikore akademike përmes sistemit UMS, informacione të cilat janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Sistemi UMS funksionon i ndarë në katër kategori:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Studentët, të cilët shohin vetëm të dhënat e tyre lidhur me lëndët, frekuentimin, kalueshmërinë etj.</li> <li>✓ Sekretaritë, të cilat mund të menaxhojnë raportimin e të dhënave për përgatitjen e raporteve lidhur me studentët (frekuentimin, kalueshmërinë, provimet etj.).</li> <li>✓ Staf i akademik, i cili menaxhon profilin e lëndëve dhe hedh notat, frekuentimin, provimet dhe riprovimet e studentëve.</li> </ul> <p><i>DVV- 83 Evidenca të raporteve të prodhuara pres sistemit UMS</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Të dhënat për ndjekjen dhe gjurmimin e studentëve gjenden pranë Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës dhe në Zyrën e NJSBC. Kryesekretaria dhe dekanët apo përgjegjësit e departamenteve kanë zhvilluar kontrole të herëpas’herëshme pranë zyrave të sekretarive mësimore ku kanë vëzhguar nga afër procedurat përkatëse. E njëjta procedurë është ndjekur edhe për sistemin UMS. Të dhënat mbi studentët dërgohen në MASR përmes raporteve institucionale vjetore, si edhe raportimeve të ndryshme statistikore sipas formateve zyrtare.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit</p>	<p>Për çdo vit akademik strukturat përgjegjëse mbledhin dhe përpunojnë informacione, mbi bazën e të cilave prodhojnë raporte lidhur me cilësinë në hyrje të studentëve dhe atë në dalje, si dhe punësimin e tyre në profil apo jashtë profili. Këto të dhëna përfshihen në raportet që përgatit njësia bazë, sekretaria dhe fakulteti për strukturat drejtuese. Ato i vihen në dispozicion edhe njësive të tjera si NJSBC, Komiteteve të Kurrikulave, Njësive të Kërkimit Shkencor CIRD, të cilat më pas i</p>

të këtyre treguesve.	<p>analizojnë dhe konkludojnë duke dhënë sugjerimet përkatëse. Në KU IKT të dhënat e nxjerra prej Departamentit Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, mblidhen prej Qendrës CIRD Ekonomi, e cila i përpunon edhe për njësitë e tjera dhe më pas harton raportin vjetor për të gjithë fakultetin.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- 31. Raporti CIRD Ekonomi 2021-2022.pdf</i>  <i>DVV- 83 Evidenca të raporteve të prodhuara pres sistemit UMS</i>  <i>DVV- 78 Shiko në shtojcë: Fakulteti i Ekonomisë – Komiteti i Kurrikulave: Studim i tregut të punës dhe vlerësimi i programeve të studimit Fakulteti i Ekonomisë – shtator 2021.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstatoi se Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin si sekretaritet mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</i></p> <p><i>GVJ konstatoi se Departamenti Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni analizon dhe harton një raport analitik për realizimin e objektivave formuese të programit të studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni në Biznes” dhe rezultateve të pritshme, të të nxënit dhe aftësimit profesional, me qëllim për të identifikuar nevojat për përmirësime në të ardhmen. Gjurmimi i punësimit të studentëve bëhet periodikisht nga Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, e cila disponon databaza për rreth 600 studentë.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 dhe Statutit të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” parashikohet përfshirja dhe angazhimi i studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese të institucionit.</p> <p>Nga takimi i GVJ me studentët, ata u shprehën se janë në dijeni që përfaqësohen në struktura si:</p> <p>Senati Akademik, i cili ka në përbërjen e vet tre përfaqësues të studentëve.</p> <p>Këshilli i Fakultetit, i cili ka në përbërjen e vet përfaqësues të studentëve.</p>

	<p>Këshilli i Etikës, i cili ka në përbërjen e vet një student që rekomandohet nga Këshilli i Studentëve.</p> <p>NjsBC, e cila ka në përbërjen e vet një student përfaqësues nga Këshilli i Studentëve.</p> <p>Komiteti Permanent për Programet dhe Kurrikulat, i cili ka në përbërjen e vet një përfaqësues të studentëve.</p> <p>Komiteti i Bursave, i cili ka në përbërjen e vet përfaqësues të studentëve.</p> <p>Qeveria Studentore, e cila realizon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese.</p> <p>Në vendimin e Senatit Akademik Nr.7, datë 24.09.2021, pika 15 gjenden komitetet dhe komisionet institucionale, në të cilat studentët përfaqësohen pothuajse në secilin prej tyre. Gjithashtu, studentët e angazhuar në komisione apo komitete të ndryshme janë përfshirë edhe në të dhënat e raportuara në fund të çdo viti për MASR.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-10 Libri i Rregulloreve Institucionale, faqet 12, 21, 24, 26, 33.</i>  <i>DVV-30 Raporti Institucional Vjetor i KU IKT per vitin akademik 2021-2022 shqip.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Sipas legjislacionit në fuqi dhe Statutit të institucionit, neni 99, në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” studentët përfaqësohen në të gjitha instancat institucionale, ata përbëjnë 25% të numrit të anëtarëve të Senatit Akademik.</p> <p>Zyra e Rektorit, Zv./Rektorit dhe NJSBC organizojnë takime të herëpashërshme me Qeverinë Studentore për të diskutuar dhe ndarë mendime rreth veprimtarive, aktiviteteve, ndryshimeve në institucion dhe për të ardhmen e institucionit, njësisë kryesore, atyre bazë etj. Opinionet dhe mendimet e dhëna prej tyre janë shumë të rëndësishme dhe ato marrin vlerë duke mos cënuar organet e tjera vendimmarrëse në KU IKT.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-1.1 Statuti i KU IKT, neni 99, Qeveria Studentore</i>  <a href="https://cit.edu.al/student/">https://cit.edu.al/student/</a>  <a href="https://cit.edu.al/student-government-meeting/">https://cit.edu.al/student-government-meeting/</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, nëpërmjet NjsBC, organizon pyetësorë për studentët për të bërë vlerësimin e çdo lënde dhe çdo pedagogu për lëndët përkatëse, vlerësimin e programit të studimit dhe vlerësimin e institucionit. Në këtë proces anketimi, studentët janë të lirë të shprehin mendimin dhe opinionin e tyre në programin google form dhe mbeten anonim. Rezultatet e pyetësorit merren në konsideratë dhe konstituojnë në përmirësimin e mësimdhënies.</p>



	<p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-17 Manuali i Stafit Akademik, Komiteti i Kurrikulës, faqet 31 dhe 32</i>  <i>DVV-78 Komiteti Permanent për Programet dhe Kurrikulat, faqet 33-35.</i>  <i>DVV-10 Libri i Rregulloreve Institucionale, Organizimi i NjSBC, faqet 26 dhe 27.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët kanë të drejtë të kërkojnë barazi në vlerësimin e dijeve. Atyre u mundësohet shprehja e lirë e mendimit të tyre mbi ndershmërinë e vlerësimit të tyre. Studenti ka të drejtë të kërkojë rivlerësim dhe të ankimojë vlerësimin, procedurë që përcaktohet në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore për Ciklin e Dytë të Studimeve.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-10 Libri i Rregulloreve Institucionale, Mi Vlerësimin e Studentit, faqet 53-56.</i>  <i>DVV-15 Rregullore e Sekretarisë Mësimore Cikli i Dytë, pikat 5 dhe 6, Kërkesa për rivlerësim dhe ankimimet e ndryshme, faqet 6 dhe 7</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ, nga takimi që pati me studentët, konstatoi se ata u shprehën se janë në dijeni që përfaqësohen në struktura si: Senati Akademik, Këshilli i Fakultetit, Këshilli i Etikës, NjSBC, Komiteti Permanent për Programet dhe Kurrikulat, Komiteti i Bursave, Këshilli i Studentëve. Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 dhe Statutit të Kolegjit Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" parashikohet përfshirja dhe angazhimi i studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese të institucionit. Gjithashtu ata u shprehën se u mundësohet të japin mendimin e tyre mbi ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve. Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është një proces transparent, i cili shprehet në rregulloret e brendëshme sikurse dhe në syllabusin e secilës lëndë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi V.6</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përherëshme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me</p>	<p><i>GVJ, nga takimi që pati me përfaqësues të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës dhe të Sekretarisë Mësimore, konstatoi se informimi i studentëve është i vazhdueshëm. Procedurat e ndjekura prej këstyre zyrave në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve</i></p>

<p>parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>janë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të vetë institucionit. Në funksion të shërbimit ndaj studentëve janë edhe instancat e tjera të institucionit.</p> <p>Për informimin e studentëve shërben Zyra e Pranimeve, e cila ndjek të gjitha procedurat përkatëse për informimin e kandidatëve për studentë mbi programet e studimit, tarifat, bursat, kriteret, dokumantacionin e regjistrimit, mundësitë e punësimit pas diplomimit, praktikat mësimore, mobilitetet etj.</p> <p>Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës është vazhdimisht në shërbim të studentëve duke ofruar mbështetjen e saj ndaj studentëve në çdo drejtim.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-96 Guida e Studentit</i>  <i>DVV-10 Libri i Rregulloreve Institucionale, Tutorati dhe Këshillimi Akademik, faqet 57 dhe 58</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit (kriteri 1 i sipërpërmendur).</p> <p>Në mbështetje të tutoratit është hartuar rregullorja përkatëse “Tutoriat dhe Këshillimi Akademik”. Mbi këtë rregullore mbështetet si stafi akademik ashtu edhe Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-96 Guida e Studentit</i>  <i>DVV-10 Libri i Rregulloreve Institucionale, Tutorati dhe Këshillimi Akademik, faqet 57 dhe 58</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Prej shumë vitesh në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” funksionon Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës. Studentëve u jepet informacion i plotë mbi çdo gjë që ka të bëjë me licensimit të programeve, mundësitë e karrierës dhe punësimit, akreditimin e institucionit dhe programeve të studimit, marrëveshjet e bashkëpunimit, njohjen e krediteve etj. Po ashtu, zyra mban lidhje të ngushta me Qeverinë Studentore dhe bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve të ndryshme të propozuara prej studentëve. Gjithashtu, në Javën e Orientimit, zyra bashkëbisedon me studentët e viteve të para për t'u prezantuar atyre institucionin, programet, faqen e internetit, mobilitetet, klubet studentore, stafin dhe zyrat administrative dhe akademike, mundësitë e punësimit në institucion si dhe jashtë tij etj.</p> <p><a href="https://cit.edu.al/student/">https://cit.edu.al/student/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna</p>	<p>Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës në bashkëpunim me struktura të tjera institucionale si sekretaritë mësimore, NjSBC, Zyrën e</p>

<p>mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Marketingut etj., ndjek aktivitetet e zhvilluara prej studentëve dhe njëkohësisht pas përfundimit të studimeve prej tyre, ndjek edhe ecurinë e punësimit dhe zhvillimit të tyre të karrierës. Zyra përgatit të dhëna statistikore dhe i prezanton ato për analiza të mëtejshme.</p> <p>Aktualisht kjo ndodh me ALUMNI të programeve të tjera të studimit në KU IKT dhe nga Departamenti Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni për programet e studimit Bachelor, sepse këtë vit diplomohen studentët e parë të programit të studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni në Biznes”. Deri më sot kjo zyrë ka ndjekur ecurinë e mbi 600 studentëve të diplomuar në programet e tjera të akredituara, për të cilat janë mbledhur të dhëna të detajuara.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <a href="https://cit.edu.al/alumni/">https://cit.edu.al/alumni/</a>  <a href="https://cit.edu.al/gala-event-celebrating-class-of-2021/">https://cit.edu.al/gala-event-celebrating-class-of-2021/</a>  DVV-81 Strategjia e Angazhimit të ALUMNI  DVV-20 Gjurmimi i studentëve ALUMNI prej institucionit</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ, nga takimi që pati me përfaqësues të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës dhe të Sekretarisë Mësimore, konstatoi se informimi i studentëve është i vazhdueshëm. Procedurat e ndjekura prej këstyre zyrave në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve janë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të vetë institucionit. Në funksion të shërbimit ndaj studentëve janë edhe instancat e tjera të institucionit.</i></p> <p><i>Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit (kriteri 1 i sipërpërmendur).</i></p> <p><i>GVJ konstatoi se Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës e ngritur në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është strukturë përgjegjëse që siguron të dhëna për studentët pas diplomimit, si dhe mban kontakte me studentët e diplomuar. Aktualisht kjo ndodh me ALUMNI të programeve të tjera të studimit në KU IKT dhe nga Departamenti Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni për programet e studimit Bachelor, sepse këtë vit diplomohen studentët e parë të programit të studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni në Biznes”. Deri më sot kjo zyrë ka ndjekur ecurinë e mbi 600 studentëve të diplomuar në programet e tjera të akredituara, për të cilat janë mbledhur të dhëna të detajuara.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Nga takimi që GVJ pati me pedagogët dhe drejtuesin e departamentit, konstatoi se në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” zhvillimi i procesit mësimor bazohet në strategjitë e mësimdhënies, në programin e lëndës dhe në vlerësimin e studentit, të cilat përmblihen në Librin e Rregulloreve Institucionale.</p> <p>Ndërtimi i kurrikulave bëhet duke ndërthurrur eksperiencat ndërkombëtare kryesisht me bazë kanadeze, bazuar në studimin e tregut, si dhe me pejsëmarrjen e stafit akademik dhe të studentëve.</p> <p>Metodologjia e mësimdhënies përshtatet sipas formimit të studentëve. Në fillim të vitit akademik studentët e rinj testohen paraprakisht për të parë nivelin real të njohurive të tyre dhe në bazë të rezultateve të testimit përcaktohet edhe metodologjia e mësimdhënies për secilën kategori ku pedagogët punojnë më shumë me studentët që kanë nevojë të plotësojnë njohuritë. Gjithashtu, mësimi ndërthuret shumë edhe me praktikë në laboratorët e universitetit por edhe në institucionet e tjera bashkëpunuese.</p> <p>Institucioni përdor platformat: Google Classroom, Google Drive dhe Google Meet në proceset e veta administrative institucionale dhe akademike, duke përfshirë teknika dhe mjete moderne në fushën e mësimdhënies.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-10 Libri i Rregulloreve Institucionale, Kreu III faqet 53-56; Strategjitë e Mësimdhënies në IKT faqet 44 dhe 50; Hartimi i Programit të Lëndës faqe 39</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Nga takimi që GVJ pati me NjSBC konstatoi se kjo njësi harton dhe shpërndan periodikisht pyetësorë për çdo semestër për vlerësimin e stafit në të gjitha drejtimet. Pyetësorët janë përgatitur në mënyrë të tillë që të masin drejt dhe saktë perceptimin e studentëve, si një element kyç informacioni për të gjitha strukturat drejtuese e menaxhuese në njësinë kryesore dhe atë bazë.</p> <p>Në mbështetje të funksionimit sa më mirë të NjSBC janë hartuar dokumentat: “Organizimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”, “Manuali i Sigurimit të Cilësisë” dhe “Politikat dhe</p>

	<p>Procedurat e Vetëvlerësimit”. Bazuar në këto dokumenta, institucioni përdor burime të ndryshme për monitorimin dhe vlerësimin e lëndëve, programeve dhe mësimdhënies, duke përfshirë vlerësimet nga studentët dhe palët e interesuara. Në këtë proces përfshihen: monitorimi dhe rishikimi i programit të lëndës; vlerësimi i programit të lëndës; vlerësimi i literaturës dhe mjeteve teknike; vlerësimi i mësimdhënies dhe stafit akademik.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-10 Libri i Rregulloreve Institucionale</i>  <i>DVV-14 Manuali i Sigurimit të Cilësisë (QAU Handbook).</i>  <a href="https://ccit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/QAU-Handbook.pdf/">https://ccit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/QAU-Handbook.pdf/</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Sikurse e theksuam edhe më sipër, nga takimi që GVJ pati me NjSBC konstatoi se vlerësimi i programeve të studimit kryhet periodikisht çdo fundsemestri në formatin Google Forms nëpërmjet pyetësorëve të plotësuar nga studentët, ku vlerësohet programi i lëndës dhe pedagogu i lëndës. Studentët kanë përfaqësuesin e tyre në NjSBC dhe për rrjedhojë studentët angazhohen gjatë të gjithë procesit që nga hartimi i pyetësorit e deri tek përpunimi i të dhënave. Rezultatet në formë raporti u dërgohen Rektorit, Senatit Akademik dhe Dekanëve.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV- 4 Model pyetësori për vlerësimin e lëndës dhe pedagogut</i>  <i>DVV-90 Procesverbal takimesh të NjSBC</i>  <a href="https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2/">https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Të gjitha të dhënat e mbledhura në formë raporti e vlerësimi për programet dhe ato të mbledhura prej pyetësorëve, u dorëzohen autoriteteve drejtuese të institucionit.</p> <p>Në protokollin e institucionit gjenden shkresat me raportet dhe analizat e vlerësimeve dërguar titullarëve të institucionit. Rezultatet e vlerësimeve të pyetësorëve përpunohen prej njëjësive përkatëse dhe në fund përpilohet një raport (me tabela, shifra e të dhëna) i cili i dorëzohet Rektorit dhe dekanëve të fakulteteve respektive. Ky raport publikohet në web-in zyrtar të institucionit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uolpads/2022/01/Questionnaires-report.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uolpads/2022/01/Questionnaires-report.pdf</a> ]  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Survey.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Survey.pdf</a> ]  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/06/questionnaires-Report-2021-2022-Fall.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/06/questionnaires-Report-2021-2022-Fall.pdf</a> ]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit</p>	<p>Institucioni vlerëson dhe motivon arritjet e personelit të tij akademik duke u njohur kontributin dhe duke e bërë të dukshëm për të gjithë, duke shpërndarë certifikata dhe vlerësime të ndryshme. Bazuar mbi të</p>

<p>personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>gjitha vlerësimet, kontributin dhe ecurinë e proceseve akademike dhe administrative, institucioni ka vlerësuar për kontribute personalitete të ndryshme të stafit akademik të spikatura në fushën e mësimdhënies, menaxhimit dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Nëpërmjet këtyre, institucioni ka vlerësuar arritjet, performancën akademiko-shkencore, pedagogjike dhe menaxheriale në disa raste të stafit akademik, si dhe i ka promovuar si shembuj të praktikave të mira, që nxisin personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies dhe sidomos të brezit të ri të lektorëve që kanë më pak përvojë akademike.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga takimi që GVJ pati me pedagogët dhe drejtuesin e departamentit, konstatoi se në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" zhvillimi i procesit mësimor bazohet në strategjitë e mësimdhënies, në programin e lëndës dhe në vlerësimin e studentit, të cilat përmbliken në Librin e Rregulloreve Institucionale.</i></p> <p><i>Nga takimi që GVJ pati me NjSBC konstatoi se kjo njësi harton dhe shpërndan periodikisht pyetësorë për çdo semestër për vlerësimin e stafit në të gjitha drejtimet. Institucioni përdor burime të ndryshme për monitorimin dhe vlerësimin e lëndëve, programeve dhe mësimdhënies, duke përfshirë vlerësimet nga studentët dhe palët e interesuara, nëpërmjet monitorimit dhe rishikimit të programit të lëndës; vlerësimin të programit të lëndës; vlerësimin të literaturës dhe mjeteve teknike; vlerësimin të mësimdhënies dhe stafit akademik.</i></p> <p><i>GVJ konstatoi se institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</i></p> <p><i>GVJ konstatoi se institucioni synon që të jetë transparent dhe të informojë studentët, stafin dhe të gjitha palët e interesuara mbi ecurinë e procesit mësimor në institucion, ashtu si dhe të publikojë vlerësimin e studentëve për këtë proces. Të dhënat përmbliken në formë raporti dhe publikohen në web-in zyrtar të institucionit.</i></p> <p><i>GVJ konstatoi se Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" vlerëson dhe motivon arritjet e personelit të tij akademik duke u njohur kontributin dhe duke u shpërndarë certifikata dhe vlerësime të ndryshme. Nëpërmjet kësaj institucioni promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>

**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion të GVJ evidentohen se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Në Statutin e KU IKT janë përshkruar strukturat dhe parimet e funksionimit të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</li> <li>✓ Bazuar në Ligjin Nr.80/2015 “Për Arimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” ka ngritur strukturën Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC).</li> <li>✓ Në Statutin e KU IKT pasqyrohen ngritja e NjSBC dhe kompetencat e kësaj njësie.</li> <li>✓ Në Statutin e KU IKT përshkruhen kompetencat e Komisioneve të Sigurimit të Cilësisë së Brendshme për çdo departament, si dhe Komisionet e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional, ku përmbahen procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të këtyre komisioneve, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.</li> </ul> <p>Në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi, në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë, institucioni ka miratuar politika, rregullore, manuale dhe procedurat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Rregullore mbi Organizimin e NjSBC.</li> <li>✓ Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit.</li> <li>✓ Politikat dhe procedurat e vetëvlerësimit.</li> <li>✓ Manuali i Sigurimit të Cilësisë së Institucionit (QAU Handbook)</li> </ul> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-1.1 Statuti i KU IKT 2019, nenet 28-29.</i>  <i>DVV-10 Libri i Rregulloreve Institucionale, Kreu I faqet 26-27, Kreu II faqet 28-32, Kreu VII faqet 147-148.</i>  <i>DVV- 14 Manuali i Sigurimit të Cilësisë (QAU Handbook).</i>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/QAU-Handbook.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/QAU-Handbook.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të</p>	<p>Nga takimi që GVJ pati me NjSBC evidentoi se kjo njësi është ngritur dhe funksionon prej vitit 2013 dhe përbëhet prej pesë anëtarësh ku njëri prej tyre është student. Përbërja e anëtarëve është me eksperiencë në këtë drejtim. Gjatë këtyre viteve KU IKT ka ndjekur një strategji institucionale lidhur me sigurimin e cilësisë në institucion, ku dokumenti kryesor për mbarëvajtjen e punës së kësaj njësie është Manuali i NjSBC. Në vitin 2020 institucioni ka angazhuar ekspertë të</p>

jashtëm.	<p>jashtëm, të cilët në bashkëpunim me Komisionin e Kurrikulave kanë vlerësuar programet e studimit në KU IKT.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV –RVB Aneksi Nr.1, tabela nr.24.</i>  <i>DVV-10 Libri i Rregulloreve Institucionale, Kreu I faqet 26-27, Kreu II faqet 27-32, Kreu VII faqet 147-148.</i>  <i>DVV-14 Manuali i Sigurimit të Cilësisë (QAU Handbook).</i>  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/QAU-Handbook.pdf">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/QAU-Handbook.pdf</a>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Instrumentat kryesore të vlerësimit të jashtëm për sigurimin e cilësisë në KU IKT janë Akreditimi Institucional dhe Akreditimi i Programeve të Studimit, si detyrim ligjor për institucionin përcaktuar në Ligjin Nr.80/2015 për Arsimin e Lartë, neni 104.</p> <p>UK IKT është institucion i akredituar për pesë vite akademike nga ASCAL dhe QAA prej marsit të vitit 2023. Fakultetet ofrojnë programe të akredituara sipas përcaktimeve dhe afateve ligjore në fuqi. Gjithashtu, KU IKT përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për sigurimin e cilësisë në institucion, si dhe për të ndjekur ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët etj., si edhe për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <a href="https://ascal.a/sq/akreditimi/institucione-te-akredituara/">https://ascal.a/sq/akreditimi/institucione-te-akredituara/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>NjSBC është njësi kryesore që merret me monitorimin dhe matjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit. Veprimtaria e kësaj njësie mbështetet në dokumentat e saj strategjike, të cilat kryesisht janë: “Rregullorja mbi Organizimin e NjSBC”, “Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit”, “Politikat dhe procedurat e vlerësimit periodik të programeve të studimit nga Fakulteti / Departamenti dhe të stafit akademik e programit të lëndës për çdo semestër”, “Raportet Vjetore CIRD Ekonomi me analizat përkatëse (mbi mësimdhënien, kërkimin shkencor, angazhimin e stafit akademik, literaturës etj)”, si dhe “Manuali i Sigurimit të Cilësisë së Institucionit (QAU Handbook)”.</p> <p>Veçanërisht për kërkimin shkencor, prej rregulloreve, politikave dhe formateve përmendim: “Librin e Rregulloreve Institucionale (Kreu II – Kërkimi, Zhvillimi dhe Kreativiteti, Politika dhe Udhëzime të Brendëshme)”, si dhe “Politikat e Publikimit dhe Vizibilitetit të Kërkimit Shkencor”, të cilat zbatohen nëpërmjet formateve: formë aplikimi për pjesëmarrje në konferencë dhe formë aplikimi për financim për publikim në revistë shkencore.</p> <p>Institucioni ka promovuar stafin akademik duke vlerësuar arritjet e tyre</p>



	<p>akademike referuar mësimeve, kërkimit shkencor dhe menaxhimit, nëpërmjet akordimit të çmimeve vlerësuese për disa pedagogë e drejtues në vite, si dhe nëpërmjet ndihmës financiare për punët e tyre shkencore.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-10 Libri i Rregulloreve Institucionale, Kreu II, Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, faqet 28-32.</i>  <i>DVV-33 Vlerësimi i programit të studimit MSc në Teknologji Informacioni në Biznes nga studentët.</i>  <i>DVV-31 Raporti CIRD Ekonomi 2021-2022, faqet 16, 36, 37.</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</i></p> <p><i>GVJ bazuar në dokumentacionin të vënë në dispozicion nga institucioni konstaton se institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësime dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara edhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të	Nga takimi që GVJ pati me Drejtuesin e Departamentit, NjSBC, pedagogët dhe studentët, u evidentua se në KU IKT disa nga mekanizmat që përdoren për shqyrtimin, miratimin dhe mikqyrjen e vazhdueshme programit të studimit janë: “Manuali i Sigurimit të

<p>programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Cilësisë (QAU Handbook)” dhe “Rregullorja mbi procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit”. Mbi bazën e tyre përgatiten raporte vjetore të veprimtarisë institucionale që përmbajnë analizën e procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor në të gjithë komponentët e tij të vlerësimit; çdo fundsemestri përgatiten pyetësorë drejtuar studentëve për cilësinë e mësimdhënies në çdo lëndë, ku sipas rezultateve hartohet dhe zbatohet një plan masash për përmirësimin e mëtejshëm të programit; zbatohen procedura për ndryshime të diktuar nga aktualiteti dhe tregu i punës, bazuar në ndryshime Ligj, në VKM, në Urdhëra apo Udhëzime të MASR duke ndjekur procedura standarde dhe të dokumentuara që u vunë në sistem në dispozicion nga institucioni.</p> <p>Strukturat e posaçme për monitorimin dhe mbështetjen e programit të studimit në nivel institucional janë: Komisionet e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Përgjegjësit e grup-lëndëve që përgjigjen për syllabuset dhe literaturën, Zyra e Kurrikulave që përgjigjet për kurrikulat.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-14 Manuali i Sigurimit të Cilësisë (QAU Handbook).</i>  <i>DVV-10 Libri i Rregulloreve Institucionale, Kreu II, Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, faqet 28-32.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Nga dokumentacionet që institucioni vuri në dispozicion të GVJ u evidentua se raportet e vlerësimit të programeve të studimit të zhvilluara nga Fakulteti dhe departamenti në bashkëpunim me Komisionin e Kurrikulave dhe NjSBC përmbajnë të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me përputhshmërinë e programit me objektivat e institucionit dhe ato të njësisë kryesore, të dhëna krahasuese, analitike etj., si dhe konkluzione mbi të cilat njësia bazë dhe ajo kryesore diskutojnë dhe marrin vendime për ecurinë e programit. Këto vlerësime zhvillohen në mënyrë periodike një herë në dy ose tre vjet për secilin program. Këto raporte u drejtohen strukturave drejtuese ose organeve kolegjiale në institucion dhe u vihen në dispozicion edhe studentëve.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-8 Vlerësimi i programit të studimit MSc në Teknologji Informacioni në Biznes nga Fakulteti dhe Departamenti – janar 2023.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të</p>	<p>Nga takimi i GVJ me palët u konfirmua se metodat e drejtpërdrejta të përdorura në procesin e vlerësimit përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Takimet e autoriteteve drejtuese me studentët.</li> <li>✓ Takimet e autoriteteve drejtuese me qeverinë studentore.</li> <li>✓ Takimet e përgjegjësve të departamenteve me studentët e programeve të studimit për praktikat mësimore dhe diplomat.</li> </ul>

<p>didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Takimet me studentët ALUMNI në institucion apo vizita në vendet e tyre të punës.</li> <li>✓ Vëzhgime në auditor për metodat dhe pedagogjinë e mësimdhënies së stafit akademik apo angazhimin e studentëve.</li> <li>✓ Vlerësimet e testeve dhe ecuria gjatë një viti akademik e studentëve të një programi.</li> <li>✓ Kalueshmëria.</li> <li>✓ Frekuentimi.</li> <li>✓ Ngelje</li> </ul> <p><b>Evidenca:</b>  <a href="https://cit.edu.al/student-government-meeting/">https://cit.edu.al/student-government-meeting/</a>  <a href="https://cit.edu.al/diploma-thesis-preparation-informative-session/">https://cit.edu.al/diploma-thesis-preparation-informative-session/</a>  <a href="https://cit.edu.al/how-to-handle-scientific-research-open-lecture/">https://cit.edu.al/how-to-handle-scientific-research-open-lecture/</a>  <a href="https://cit.edu.al/cit.edu.al/gala-event-celebrating-class-of-2021/">https://cit.edu.al/cit.edu.al/gala-event-celebrating-class-of-2021/</a>  <a href="https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-cit-in-tirana-albania-paid-an-academic-visit-to-credins-invest/">https://cit.edu.al/canadian-institute-of-technology-cit-in-tirana-albania-paid-an-academic-visit-to-credins-invest/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Nga takimin që GVJ pati me palët, në nivel institucional, kërkesa për ndryshime në kurrikulën e programit të studimit fillimisht propozohet nga Departamenti Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, shqyrtohet në Dekanat dhe më pas kalon për miratim në Senatin Akademik të KU IKT, pasi është konsultuar më parë me Zyrën e Kurrikulave e cila monitoron cilësinë e zbatimit të kurrikulës dhe raporton në Rektorat mbi rezultatet e monitorimit.</p> <p>KU IKT përdor metoda e instrumenta të tërthorta vlerësimi si: pyetësorë e anketime me studentët aktualë, me studentët e diplomuar (alumni), me personelin akademik, me personelin akademik ndihmës dhe me personelin administrativ, raporte vjetore, raporte vlerësimi programi, studime tregu për programin e studimit, raporte vlerësimi nga strukturat drejtuese, vetëvlerësimi i stafit akademik, RVB dhe RVJ për proceset e akreditimit të programeve, gjurmimi i studentëve dhe mbledhja e të dhënave për punësimin e tyre në profil ose jo, takimet me ALUMNI gjatë trajnimeve në institucion ose atje ku punojnë. Rezultatet e tyre u vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit dhe atyre të fakulteteve.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <a href="https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2/">https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2/</a>  DVV-7 Studimi i Tregut për programin MSc në Teknologji Informacioni në Biznes, Janar 2023  DVV-34 Vlerësimi i stafit akademik prej strukturave përgjegjëse e drejtuese  DVV-38 Raportet e Vetëvlerësimit të stafit akademik, 2020-2021.  DVV-20 Gjurmimi i studentëve prej institucionit.  <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Survey.pdf/">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/Survey.pdf/</a></p>

<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, ku evidenton arritjet dhe dobësitë, duke bërë motivimin e më të mirëve por edhe duke hartuar planin e masave për përmirësim, të gjitha në shërbim edhe të akreditimit të tij. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</i></p> <p><i>GVJ, nga dokumentacionet që institucioni vuri në dispozicion, konstaton se raportet e vlerësimit të programeve të studimit të zhvilluara nga Fakultetit dhe departamenti në bashkëpunim me Komisionin e Kurrikulave dhe NjSBC përmbajnë të gjitha të dhënat krahasuese dhe analitike që kanë të bëjnë me përputhshmërinë e programit me objektivat e institucionit dhe ato të njësisë kryesore, si dhe konkluzione mbi të cilat njësia bazë dhe ajo kryesore marrin vendime për ecurinë e programit. Këto raporte u drejtohen strukturave drejtuese ose organeve kolegjiale në institucion dhe u vihen në dispozicion edhe studentëve.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Standardi VI.4</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>  <b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  Nga materialet e vendosura në dispozicion të GVJ dhe nga takimi me drejtuesit e KU IKT dhe NjSBC rezultojnë se përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm realizohet si ndërthurje e plotitike bashkëpunuese të institucionit me palët e treta që janë ekspertët e jashtëm, bizneset, sipërmarrjet etj, por edhe me studentët që konsiderohen një element i rëndësishëm në këtë proces. Sikurse është theksuar edhe më sipër, përfshirja e studentëve është në të gjitha instancat: Senatit Akademik, Këshillat e Fakulteteve, NjSBC, Këshillin e Etikës, Komitetin Permanent për Programet dhe Kurrikulat, Komitetin Permanent për Kërkimin Shkencor, Projektet dhe Aplikimin e Novacionit, Komitetin e Bursave etj, sipas kompetencave të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e KU IKT dhe në Planet Strategjike të institucionit.  <b>Evidenca:</b> <i>DVV-75,76 Katalogët e veprimtarive 2020-2023</i> <i>DVV-1.1 Statuti i KU IKT, neni 28 dhe tabela 24 në Aneks nr.1.</i> <i>Komitetet dhe komisionet e publikuara në faqen e internetit.</i>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p><a href="https://cit.edu.al/organization-2/">https://cit.edu.al/organization-2/</a></p> <p>Në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” përgjegjësitë e detyrat konkrete për njësitë e strukturat e angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara në dokumentet bazë: “Organizimi i NjsBC”, “Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit”, “Politikat dhe procedurat e vetëvlerësimit” dhe “Manuali i NjsBC”.</p> <p>Përgjegjësitë dhe detyrat konkrete në funksion të garantimit dhe ruajtjes së sigurimit të brendshëm të cilësisë së programit të studimit nga çdo anëtar dhe strukturë janë: Departamenti, Koordinator i programit, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Sekretaria Mësimore, stafi akademik. Po kështu komunikimet dhe bashkëpunimet e vazhdueshme me studentët bëjnë që të gjitha palët të marrin pjesë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit dhe përshtatjes së tij me zhvillimet më të fundit të tregut.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-10 Libri i Rregulloreve Institucionale, Kreu II faqet 26-32, Kreu VIII faqet 147-148.</i>  <i>DVV-14 Manuali i Sigurimit të Cilësisë (QAU Handbook).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademi e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Sipas dokumentave të vëna në dispozicion të GVJ dhe takimit që patëm me Drejtuesin e Departamentit dhe NjsBC u evidentua se Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ngrihet në nivel institucional dhe rregullon veprimtarinë lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e aktorëve të angazhuar në këto procese.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>DVV-8 Vlerësimi i programit të studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni në Biznes” nga Fakulteti dhe Departamenti – Janar 2023.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në Kolegjin Universitar “Teknologji Informacioni në Biznes” përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit ka respektuar gjithnjë integritetin akademik dhe ka shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p>Në të gjitha proceset e vlerësimit si ato të zhvilluara për programet e studimit, për vlerësimin e stafit akademik, për vlerësimin e programeve të studimit ashtu edhe ato për vlerësimin e tregut të punës, bashkëpunimi ka rezultuar pozitiv dhe ka patur frymë të mirë bashkëpunimi, duke dhënë një produktivitet të pasur me vlerësime, raporte ctj.</p> <p><b>Evidenca:</b>  <i>Përbërja e komisioneve: <a href="https://cit.edu.al/organization-2/">https://cit.edu.al/organization-2/</a>.</i>  <i>DVV-1.1 Statuti i KU IKT, neni 14, pikat 3-4 për vendimmarrjen e Senatit Akademik; neni 18 vendimmarrja në Rektorat, pika 4; neni 26</i></p>

	<p><i>vendimmarrja në Këshillin e Fakultetit, pika 4; neni 33 për vendimmarrjen e Bordit të Administrimit.</i></p> <p><i>DVV-33 Vlerësimi i programit të studimit Master i Shkencave në Teknologji Informacioni në Biznes nga studentët.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacion, GVJ evidentoi se në procesin e vlerësimit, Fakulteti i Ekonomisë ka përfshirë edhe aktorë apo bashkëpunëtorë të jashtëm, në nivel eksperti. Tryeza dhe takime të ndryshme janë zhvilluar me biznese dhe sipërmanje në mënyrë që të vlerësohet qëndrueshmëria e programit, metodat më të avancuara manaxheriale, përshtatja e njohurive me tregun e punës etj.</p> <p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>DVV-8 Vlerësimi i programit të studimit Master i Shkencave në Teknologji Informacioni në Biznes nga Departamenti – Janar 2023.</i></p> <p><i>DVV-75,76 Katalogët e veprimtarive 2020-2023.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se, nga materialet e vendosura në dispozicion të saj dhe nga takimi me drejtuesit dhe NjSBC, realizohet përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit, bazuar në Statutin dhe Rregulloren e KU IKT dhe në Planet Strategjike të institucionit.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” janë të përcaktuar qartë njësitë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni në Biznes”.</i></p> <p><i>GVJ sipas dokumentave të vëna në dispozicion dhe takimit që patëm me Drejtuesin e Departamentit dhe NjSBC, konstaton se u evidentua se në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni në Biznes” janë përfshirë të gjithë aktorët kryesorë në rang njësie bazë dhe kryesore, grup i cili përbëhet nga personel akademik, personel administrativ, ekspertë të jashtëm dhe studentë (të cilët janë cituar në (RVB)).</i></p> <p><i>GVJ konstaton se KU IKT përfshin aktorë të brendshëm në vlerësimin e programit, stafin që lidhet direkt me programin e studimit Master i Shkencave “Teknologji Informacioni në Biznes”, sikurse edhe studentët në strukturën e NjSBC-së, duke shmangur gjithashtu diskriminimin apo pabarazinë ndërmjet tyre.</i></p> <p><i>Bazuar në dokumentacion, GVJ konstaton se në KU IKT pjesë aktive e procesit të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm janë stafit akademik, studentët, bashkëpunëtorët dhe ekspertët e jashtëm në bashkëpunim me strukturën e NjSBC-së.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>

<b>Standardi VI.5</b> <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Nga takimi që GVJ pati me palët u evidentua se në Kolegjin Universitar “Instituti Knadez i Teknologjisë”, politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit, nëpërmjet postimit në web-in zyrtar të institucionit <a href="https://cit.edu.al/">https://cit.edu.al/</a> , nëpërmjet komunikimit shkresor me të gjitha njësitë kryesore e me njësinë bazë, si dhe nëpërmjet manualëve e raporteve përmbledhëse periodikë. Dokumenti kryesor i transparencës është Manuali i Sigurimit të Cilësisë.  <b>Evidenca:</b> <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/OAU-Handbook.pdf/">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/01/OAU-Handbook.pdf/</a> <a href="https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/06/Questionnaires-Report-2021-2022-Fall.pdf/">https://cit.edu.al/wp-content/uploads/2022/06/Questionnaires-Report-2021-2022-Fall.pdf/</a>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga takimi që GVJ pati me NjSBC dhe Zyrën e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës u informua që KU IKT publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit sipas parashikimit në Rregulloren e institucionit dhe konform legjislacionit në fuqi. Kështu, për sa i përket pyetësorëve të realizuar me studentët për pedagogët dhe programin e studimit, rezultatet e vlerësimit u vihen në dispozicion individualisht secilit pedagog të vlerësuar, Komisionit për vlerësim, Përgjegjësit të Departamentit, Dekanit të Fakultetit përkatës dhe Rektorit. Rezultatet e programit të studimit publikohen në faqen e web-it zyrtar të institucionit.  <b>Evidenca:</b> <a href="https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2/">https://cit.edu.al/quality-assurance-unit-2/</a>
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Bazuar në RVB dhe në takimin që GVJ pati me përfaqësues të NjSBC, evidentoi se në rast të pasqyrimit të mangësive sipas rezultatit të vlerësimeve, synohet shqyrtimi i tyre dhe marrja e masave për përmirësim nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve të vazhdueshme në aspektin didaktik dhe të kërkimit shkencor. Në RVB theksobet se KU IKT organizon një plan masash që adreson përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara nga pyetësorët e plotësuar nga studentët për çdo pedagog duke dhënë indikatorë të perceptimit të performancës nga studentët. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion u evidentua se lidhur me këtë program studimi nuk kishte mangësi të reflektuara në rezultatet e pyetësorëve, për rrjedhojë edhe nuk u është dashur të hartojnë ndonjë plan masash konkrete në lidhje me këtë.

	<p><b>Evidenca:</b></p> <p><i>DVV-35 Vlerësimi i stafit akademik prej studentëve.</i></p> <p><i>DVV-33 Vlerësimi i programit të studimit Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni në Biznes" nga studentët.</i></p> <p><i>DVV-8 Vlerësimi i programit të studimit Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni në Biznes" nga Fakulteti dhe Departamenti – Janar 2023.</i></p> <p><i>DVV-69, Raport drejtuar Rektorit dhe Dekanëve për Pyetëtorin mbi punësimin e studentëve 02.02.2021, në të cilin bëhet edhe analiza e të dhënave dhe jepen konkluzionet përkatëse.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga takimet që GVJ pati me palët në institucion dhe nga dokumentacioni shtesë (Vlerësimi i programeve të studimit Bsc dhe MSc të Fakultetit Ekonomik, Nr.21 Prot, datë 21.03.2023) u evidensua se KU IKT vazhdimisht synon eektivitetin e veprimtarive në kuadër të përmirësimit të cilësisë në tërësi dhe të cilësisë së këtij programi studimi në veçanti.</p> <p>Në ndihmë dhe në funksion të kësaj, në KU IKT janë ngritur strukturat përkatëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucional, të cilat janë: NjSBC dhe Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Kurrikulave, Koordinatorin e programit të studimit, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës.</p> <p>Këto struktura bashkëpunojnë ngushtë me aktorët e tjerë në KU IKT, sikurse janë Drejtuesi i Departamentit dhe Përgjegjësi i grup-lëndëve të cilët përgjigjen drejtpërdrejt për respektimin e standardeve të planeve mësimore, syllabuseve të lëndëve dhe të gjithë dokumentacionit respektiv për këtë program studimi, në funksion të përmirësimit të cilësisë së stafit akademik në drejtim të metodave të mësimdhënies dhe të infrastrukturës laboratorike të cilën e kanë pasuruar me kalimin e viteve. Të gjithë këto elementë i nënshtrohen vlerësimeve periodike nga studentët dhe nga njësia bazë e këtij programi studimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentat e vëna në dispozicion dhe nga takimet që GVJ pati me palët përkatëse në institucion, evidentoi se NjSBC organizon takime dhe veprimtari periodike, në prani të strukturave drejtuese (Rektor, Dekan, Administrator, Përgjegjës Departamenti), për ndërgjegjësimin e personelit akademik dhe studentëve për sigurimin e cilësisë në nivel institucional dhe për programet e studimit.</p> <p>Në këto takime është diskutuar mbi proceset e vlerësimit të programeve të studimit, vlerësimin e programit të lëndës dhe mbi rregulloret që standrdizojnë sigurimin e cilësisë në KU IKT.</p> <p>Gjithashtu, zakonisht çdo fillim-viti akademik NjSBC ka zhvilluar trajnime me stafin e ri akademik por edhe me të vjetrin, për t'i njohur ata me procedurat dhe hapat që ndërmerren me qëllim sigurimin e cilësisë, organizimin e programit mësimor, realizimin e programit të lëndës, si dhe aspekte të tjera të proceseve e veprimtarisë akademike.</p>



	<p><b>Evidenca:</b>  <a href="https://cit.edu.al/student-government-meeting/">https://cit.edu.al/student-government-meeting/</a>  <a href="https://cit.edu.al/students-senators-and-cit-representatives-meeting/">https://cit.edu.al/students-senators-and-cit-representatives-meeting/</a>  <a href="https://cit.edu.al/cit.edu.al/welcome-meeting-with-cit-students-government/">https://cit.edu.al/cit.edu.al/welcome-meeting-with-cit-students-government/</a>  <a href="https://cit.edu.al/quality-assurance-meeting/">https://cit.edu.al/quality-assurance-meeting/</a>  <a href="https://cit.edu.al/welcoming-the-new-academic-staff-canadian-institute-of-technology/">https://cit.edu.al/welcoming-the-new-academic-staff-canadian-institute-of-technology/</a>  <a href="https://cit.edu.al/wwelcoming-and-training-the-new-academic-staff-at-cit/">https://cit.edu.al/wwelcoming-and-training-the-new-academic-staff-at-cit/</a>  <a href="https://cit.edu.al/welcoming-the-new-academic-staff-at-cit/">https://cit.edu.al/welcoming-the-new-academic-staff-at-cit/</a></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ nga takimet që pati me palët konstatoi se në KU IKT politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</i></p> <p><i>GVJ konstatoi se KU IKT publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Rezultatet e vlerësimit shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara, por që në rastin e këtij programi studimi nuk janë reflektuar mangësi.</i></p> <p><i>GVJ konstatoi se KU IKT vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në  
“Teknologji Informacioni në Biznes” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji  
Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. KU IKT ka vënë në dispozicion të Departamentit Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni, të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e këtij programi studimi, si dhe u mundëson studentëve mjedise mbështetëse për mësimnxënien dhe miqësore në aspektin e integritit social të tyre. **(Standarti IV.2)**
2. Institucioni për këtë program studimi disponohet literaturë në gjuhën angleze, e përditësuar që mundësohet në sajë të marrëveshjes së institucionit me McGrawHill Education. Gjithashtu mundëson bibliotekën online të aksesueshme falas për studentët dhe stafin akademik, ofruar nga një prej kompanive më të njohura në botë. Biblioteka ka një larmi prej 65 mijë tituj në gjuhën angleze. KU IKT ka bibliotekë fizike me mbi 5 mijë tituj në gjuhën angleze. **(Standarti IV.3)**
3. KU IKT ka ndërtuar strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, të cilat fillojnë nga organet drejtuese, Fakultetet, Departamentet, NjsBC, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe komisione të tjera mbështetëse në funksion të menaxhimit të qëndrueshëm të këtij programi studimi por edhe të menaxhimit në nivel institucional. **(Standarti VI.1)**
4. KU IKT është në institucion i qëndrueshëm me staf të qëndrueshëm. Ky program studimi realizohet nëpërmjet stafit akademik ndërkombëtar me eksperiencë ndërkombëtare në mësimdhënie dhe stafit akademik kombëtar me kualifikime ndërkombëtare. **(Standarti IV.1)**
5. Mësimdhënia në anglisht u mundëson studentëve të këtij programi studimi një treg të synuar ndërkombëtar dhe fusha interdisiplinare e këtij programi studimi u mundëson studentëve një treg pune më të gjerë. **(Standarti II.7)**
6. Përputhshmëria e programeve dhe syllabuseve në masën mbi 50% me programet e universiteteve kanadeze simotra, u lehtëson studentëve procedurën e njohjes së diplomës së fituar në KU IKT për këtë program studimi. **(Standarti II.4)**
7. KU IKT mundëson praktika dhe internshipe të sigurta për studentët, bazuar në marrëveshjet që ky institucion ka me kompanitë e mëdha në vend. **(Standarti I.3)**
8. KU IKT ofron mundësi burse për studentët më të mirë prej maksimumi 75% të tarifës së studimit, duke vazhduar me nënkategoritë e tjera prej 50%, 30% dhe 25% të tarifës së studimit. **(Standarti V.I)**
9. KU IKT praktikon “derën e hapur” me studentët, duke u dhënë zgjidhje të shpejtë problemeve të tyre. **(Standarti V.6)**



10. KU IKT mat nivelin e përgatitjes së studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive të tyre, duke rritur në këtë mënyrë objektivitetin dhe transparencën e vlerësimit, por njëkohësisht edhe duke motivuar studentët për rezultate gjithnjë e më të mira. (Standartin III.3).

#### **Pika të dobta**

1. Burimi kryesor i financimit të programit të studimit janë të ardhurat e siguruara nga tarifa e shkollimit që paguajnë studentët. (Standarti IV.5 Kriteri 3)
2. Institucioni të angazhojë në zhvillimin e procesit mësimor personel akademik me formim specifik në funksion të programit të studimit. (Standarti I.2 Konkluzionet)

#### **Rekomandime**

1. GVJ rekomandon që institucioni duhet të shtojë gamën e burimeve financiare të veta pasi nuk mund t'ia lëri peshën më të madhe të të ardhurave vetëm fee-ve të studentëve. (Standarti IV.5 Kriteri 3)
2. Rekomandohet që zhvillimin i procesit mësimor të kryhet me personel akademik me formim specifik në funksion të programit të studimit. (Standarti I.2 Konkluzionet)
3. IKT dokumenton raporte të përvitshme financiare në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti, por duheshin të detajuara dhe për programin specifik të studimit MSc në Teknologji Informacioni ne Biznes. (Standarti IV.5 kriteri 2)
4. Sugjerohet që të caktohet me vendim një fond i caktuar për financimin e botimeve të pedagogëve për çdo vit akademik, pra duhet theksuar që duhet më shumë ndihmë financiare dhe angazhim praktik, real dhe promovim nga IAL për stafin akademik për botime të ndryshme në revista prestigjioze shkencore të huaja dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore. (Standarti IV.5 kriteri 2)
5. Megjithëse IAL IKT ka bërë përpjekje të konsiderueshme për shtimin e literaturës në bibliotekë, përsëri ka vend për përmirësimin dhe shtimin e titujve të librave në bibliotekë në literaturën fizike në gjuhën shqipe për të mbështetur nevojat e programit. Sugjerohet shtimi i hapësirës /posteve /vendeve dhe kompjuterave /laptopëve në bibliotekë për t'i shërbyer sa më mirë studentëve në burimet fizike. (Standarti IV.3 Konkluzionet)

**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Science on "Information Technology in Business" provided by the Higher Education Institution Universit College "Canadian Institute of Technology"**

#### **Strengths and affirmations**



1. University College “Canadian Institute of Technology” has made available to the Business Administration and Information Technology Department, all the necessary infrastructure for the realization of this study program, as well as providing students with supportive learning environments and friendly in terms of their social integration. **(Standard IV.2)**
2. The institution for this study program has available literature in the English language, updated which is made possible thanks to the agreement of the institution with McGrawHill Education. It also enables the online library accessible for free to students and academic staff, provided by one of the most popular companies in the world. The library has a variety of 65 thousand titles in the English language. KU IKT has a physical library with over 5,000 titles in English. **(Standard IV.3)**
3. UC CIT has built the structures responsible for quality assurance, which start from the governing bodies, Faculties, Departments, NJSBC, Internal Quality Assurance Commission, as well as other supporting commissions in function of the sustainable management of this study program but also of management at the institutional level. **(Standard VI.1)**
4. UC CIT is a stable institution with stable staff. This study program is realized through international academic staff with international experience in teaching and national academic staff with international qualifications. **(Standard IV.1)**
5. Teaching in English language allows students on this study program an international target market and the interdisciplinary field of this study program provides students a wider job market. **(Standard II.7)**
6. The compatibility of the programs and syllabuses to the extent of over 50% with the programs of the homologous Canadian universities, facilitates the procedure for students to recognize the diploma obtained at UC CIT for this study program. **(Standard II.4)**
7. UC CIT enables safe practices and internships for students, based on the agreements that this institution has with big companies in the country. **(Standard I.3)**
8. UC CIT offers scholarship opportunities to the best students of a maximum of 75% of the tuition fee, continuing with other sub-categories of 50%, 30% and 25% of the tuition fee. **(Standard V.I)**
9. UC CIT practices “the open door” with students, giving quick solutions to their problems. **(Standard V.6)**
10. UC CIT measures the level of students' preparation through the continuous control of their knowledge, thus increasing the objectivity and transparency of the evaluation, at the same time motivating students for better and better results. **(Standard III.3).**

## Weaknesses

1. The main source of funding for the study program is the income provided by the tuition fees paid by the students. **(Standard IV.5 Criteria 3)**
2. The institution should engage in the development of the learning process academic personnel with specific training in function of the study program. **(Standard I.2 Conclusions)**

### **Recommendation**

1. GVI recommends that the institution should increase the range of its financial resources since it cannot leave the largest share of income to student fees alone. **(Standard IV.5 Criteria 3)**
2. It is recommended that the development of the learning process be carried out by academic personnel with specific training in function of the study program. **(Standard I.2 Conclusions)**
3. HEI ICT documents annual financial reports at the institutional, faculty and department level, but detailed ones were also needed for the specific MSc study program in Information Technology in Business. **(Standard IV.5 Criteria 2)**
4. It is suggested that a certain fund for the financing of lecturers' publications be set by decision for each academic year, so it should be emphasized that more financial aid and practical, real commitment and promotion from HEIs are needed for the academic staff for various publications in journals prestigious foreign scientific and participation in scientific conferences. **(Standard IV.5 Criteria 2)**
5. Although HEI ICT has made considerable efforts to increase the literature in library, there is still room for improvement and addition of book titles in the library to physical literature in the Albanian language to support the needs of the program. It is suggested to increase the space/posts/places and computers/laptops in the library to better serve the students in physical resources. **(Standard IV.3 Conclusions)**



**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË</b>				<b>X</b>
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				<b>X</b>
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>